

Maj 2012  
Numri: 50  
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - [www.revistaetika.com](http://www.revistaetika.com)

Shqipëri: 150 Lek  
Kosovë: 1 Euro  
Maqedoni: 60 Den

# ETIKA



**ÇFARË BREZI  
PO RRISIM  
ÇFARË TË  
ARDHME PO NDËRTOJMË**







# Editorial

Muslimani synon që fëmija i tij të formohet me një personalitet, që të arrijë të bëhet një pasardhës i mbarë për të dhe, për këtë gjë, ai nuk kursen gjithçka që ka.

Brenda gjithçkasë përfshihet edhe shteti.

Por mund të ndodhë që në periudha të caktuara, shteti të mos punojë në mënyrë paralele me këtë ndjeshmëri të nënshtetasve të tij.

Madje, ai mund të parashikojë që ta shndërrojë laicizmin, që e pranon si parim të tijin, në një distancë mes Islamit dhe brezave të rinj.

Qoftë ky laicizëm një boshllëk vlerash, qoftë një manivelë për të formuar njeriun sipas prirjeve pozitiviste.

Ky ka qenë debati që është zhvilluar deri më sot dhe ky debat u bë duke e konsideruar popullin palë kundër-shtare.

Në të vërtetë, në këtë kohë kriza e rinisë apo, më në përgjithësi, shpërbërja e shoqërisë, si rezultat i boshllëkut të vlerave apo i abstraktimit nga feja, ekspozohen me gjithë tragjedinë e tyre nëpër faqet e gazetave apo nëpër lajmet televizive.

Kërkesa e shoqërisë ndaj shtetit për formimin e një brezi më të shëndoshë, sa vjen e rritet.

Duke ditur se formimi i personalitetit fillon që në mitrën e nënës, atëherë është e papranueshme që fëmijët tanë, të cilët e kryejnë arsimimin e detyruar brenda formatit që ka përcaktuar shteti, gati në të gjithë fazat e zhvillimit të tyre të privohen nga "**vlerat pozitive**".

Për këtë arsye, kërkesa drejtuar shtetit që të tregojë kujdes se mos rinia edukohet me vlera negative, duhet të jetë vazhdimisht aktuale nga ana e shoqërisë.

Shteti duhet të pajisë rininë me vlera pozitive të niveleve më të avancuara dhe të vazhdojë të punojë që ta shndërrojë shoqërinë në përcjellësin e vlerave shpirtërore tek brezat e rinj.

Është e qartë se ndjeshmëria dhe përgjegjësia e vërtetë në lidhje me "**brezin e ri**" bie mbi prindërit.

Amaneti u është lënë prindërve.

Prindërit janë të detyruar të dallojnë gjilpërën e busullës nga kibleja.

Në qoftë se tek fëmijët duhet gatuar një zemër e mirë, atëherë pyetja bazë që duhet bërë është: a kanë prindërit e fëmijës një zemër të mirë?

Pyetja bazë është: A është shtëpia që duhet konsideruar si një shkollë në vete për fëmijën, një mjet ideal i arsimimit dhe edukimit të tij?




# Do të lexoni:




- Ahmet Tashgetiren / 4** Cilin brez të rinjsh?
- Doç. dr. Ajnur Uraler / 7** Namazi me xhemat
- Ma. Muhidin Ahmeti / 8** Të rinjtë dhe edukimi i tyre në shikimin e Pejgamberit të Zotit (a.s.)
- Edison Çeraj / 12** Hasan Tahsini mes Lindjes dhe Perëndimit
- Husejn Kerim Exhe / 15** Rinia ideale
- Nuredin Nazarko / 20** Gjenerata që po rritet
- Gëzim Puka / 22** Trishtimi shqiptar në vargjet e një poeti
- Skender Drini / 25** Mëshira ose një ese gjysmë e përgjumur
- Vehap S. Kola / 26** Arsimi që tregtojmë
- Soc. Raimonda Draçini / 28** Demokratizimi i marrëdhënieve në shkollë
- Imam Muhamed Sytari / 30** E shkuara dhe e sotmja në atmosferën e 5 - vjetorit të xhamisë së re të Parrucës

Ahmet Tashgetiren



4

Husejn Kerim Exhe



15

Soc. Raimonda Draçini



28

Viti: VI | Numri: 50 | Maj 2012

Drejtor & Kryeredaktor:

Alban Kali

albankali@yahoo.com

+355 67 20 86767

Redaktor:

Zija Vukaj

Korrektore:

Ma. Irida Hoti

Përkthyesit:

Albert Halili / Artur Tagani

Fatmir Sulaj / Ilir Hoxha

Dizajn-Grafik:

Bledar Xama

Për artikuj:

e-mail: revistaetika@progresibotime.com

e-mail: kosova@progresibotime.com

e-mail: maqedoni@progresibotime.com



# May 2012

40

*Osman Nuri Topbash*



46

*Altin Torba*



68

*Enciklopedi Islame*



Rinia është begatia  
më e çmueshme e një kombi

Fotoja e Muajit

Një ajet - Një hadith

Ndjekja e Profetit (a.s.)  
me dashuri dhe bindje

21 teknika për komandimin  
e bashkëbisedimit

"...marrë frymë ajrin e atdheut"

E ardhmja e brezit të ri!?

Rrugët e afrimit me Allahun

Evolucionet e Botës Shqenxore

Punimet enciklopedike  
në literaturën islame

Ndikimi i filozofisë islame  
në filozofinë perëndimore

Përgjegjësia mjekësore

Xhehenemi

Shfrytëzoheni rininë,  
para se të vijë pleqëria

10 zakonet që dëmtojnë trurin

Prodhoet domatja e zezë

Risite e abetares kombëtare

**32/ Nexhat Spahiu**

**36 /**

**38-39 /**

**40 / Osman Nuri Topbash**

**46 / Altin Torba**

**50 / Xhahid Bushati**

**52 / Nexhat Ibrahim**

**54 / Prof. dr. Mehmet Demirxhi**

**56 / Zani i s'kaluemes**

**58 / Ma. Ermal Nurja**

**60 / Ma. Artur Tagani**

**64 / Ma. sci. Flamur Sofiu**

**68 / Enciklopedi Islame**

**70 / Imam Naim Drijaj**

**72 / Shëndet**

**73 / Teknologji**

**74 / Aktualitet**

**PROGRESI**  
BOTIME  
www.progresibotime.com

**Adresa:**

**L: Vasil Shanto / Rr: Çajupi**

**Shkodër / Albania**

**Tel: +355 22 254 634**

**Fax: +355 22 254 633**

**Zyra e përfaqësimit Maqedoni**

Rr. Stiv Naumov / nr. 9 / lokal 25

Shkup / Maqedoni

+389 71 956 271

**Zyra e përfaqësimit Kosovë:**

Rr. Ardian Zurnaxhiu / pn. Ralin

Prizren / Kosovë

Tel: +381 29 222 795

Fax: +381 29 222 797

+377 4411 98 48

**Çmimi:**

**Shqipëri: 150 Lekë**

**Abonim (një vjetor): 1500 Lekë**

**Kosovë: 1 Euro**

**Abonim (një vjetor): 10 Euro**

**Maqedoni: 60 DEN**

**Abonim (një vjetor): 720 DEN**

**Europë: 2 Euro**

**Abonim (një vjetor): 24 Euro**



# Cilin

## ..BREZ TE RINJSH?



Ahmet Jashgetiren

**N** Njerëzimi sot po përjeton një "problem të brezit të ri".

Çdo prind sot po përjeton problemin "fëmijët".

Çfarë profili do të përftoja, në qoftë se do të përpiqesha që mes këtyre rreshtave të për-vijoja profilin e "të riut" nga një çift prindërisht, që nuk kanë fare përpikmëri të natyrës fetare, të shprehnin një karakteristikë?

A dëshironi një të ri që përdor lëndë narkotike?

Një të ri që ka prirje të dhunshme?

Që i vë stërkëmbësin një të verbëri që has në rrugë, sa për lojë dhe shaka?

Që i vjedh çantën një të moshuare?

Që merr vetëm minuse në jetën arsimore dhe atë edukative?

Që thotë gënjeshtër?

Që luan kumar?

Që navigon nëpër faqe pornoje në internet?

Që vret të dashurën?

Që bën qitje me macet e rrugës?

Që ngacmon seksualisht shoqet në klasë?

Që bën çeta ngatërresash?

Me pak fjalë, a do të dëshironit që të kishit një fëmijë që ka vese, të cilat të gjithë njerëzit i cilësojnë për "negative"?

Apo që fëmija juaj të bjerë në "**gropën e gjërave negative**", si përfundim i edukimit që realizohet në

shkollë, në rrugë apo nëpërmjet mjeteve të informacionit?

Jam i sigurt se nuk do të dëshironit që fëmija juaj të kishte këto vese.

Të gjithë prindërve në botë, po t'ua bëja këto pyetje, përgjigja që do të merrja prej tyre nuk do të ishte e ndryshme.

Pra afërsisht, njëqind për qind e prindërve, që mund të cilësohen si prindër të vërtetë apo të paktën, ata që shqetësohen për edukimin e fëmijëve të tyre, nuk do të dëshironin një fëmijë me këtë format.

Menjëherë pas këtij konstatimi, mund të bëjmë këtë pyetje:

Cilat përkufizime klishe qenë bërë për këtë "fëmijë negativ"?

Ose, e thënë më ndryshe, cilat janë përkufizimet klishe për një të ri që nuk ka karakteristika negative, por veçori që shoqëria i pranon si "vlera pozitive"?

E di se debati do të na shpjerë tek e drejta dhe autoriteti që ka shteti për të edukuar këtë apo atë lloj rinie?

Në mënyrë të veçantë pyetja "**A mundet shteti të edukojë një rini fetare?**", bën që të shpërthejë qameti. Lëre pastaj, nëse shteti në fjalë ka përvetësuar parimin e laicizmit..., të cilin e kupton si krijimi i një distance ndërmjet fesë dhe shtetit...

A është shteti i zhveshur nga vlerat?

Pyetja e parë që të vjen ndërmend apo që duhet bërë, është:



**“A është një shtet laik steril, me fjalë të tjera, i izoluar totalisht nga çdo lloj burimi vlerash, siç janë feja dhe filozofia?”**

Në të vërtetë, çdo shtet ka përherë një **“kornizë nje-rëzore”** minimale. Kjo vlen si për shtetin laik, ashtu edhe për atë demokratik. Le ta quajmë këtë kornizë humane me emrin **“vlerat universale”**. Marrëveshja për të drejtat e fëmijëve, marrëveshja për të drejtat e grave, marrëveshja për të drejtat e njeriut, marrëveshjet e arritura me qëllim mbrojtjen e natyrës dhe ambientit, marrëveshjet për mbrojtjen e të drejtave të kafshëve, janë shndërruar në vlera universale.

Pyetja që duhet të bëjmë, është:

Kush e përcakton nëse një vlerë është universale apo jo dhe a abstragohet ajo vlerë totalisht nga feja?

Laicizmi dhe demokracia nuk e shndërrojnë shtetin në një terren steril, pasi kjo është e pamundur. Madje, vetëm vlerat e personalitetit të një mësuesi apo ato të aktorëve politikë përpara shoqërisë, kanë efekt në edukimin e personalitetit të një fëmije.

Për këtë arsye, të preten-dosh se shteti nuk duhet të ketë asnjë lloj efekti në edukimin e personalitetit të një fëmije, është po aq e pakuptimtë, sa është e pakuptimtë të kërkojë të pamundurën.

Vetëm se këtu, ndoshta mund të shtrohet pyetja: A është e drejtë që shteti të ndikojë në formimin kokë e krye të një individi, aq më shumë që në një shoqëri, që përbëhet nga kultura dhe besime të ndryshme, ndërhyrja e shtetit do të pranohej si ndikim i një feje të caktuar mbi shoqërinë?

Kjo pyetje mund të marrë përgjigje në dy mënyra:

**E para:** Në këtë epokë që jetojmë, krijimi i një monopoli të tillë të formimit të nënshtetasve, është e pamundur, sepse fenomeni i telekomunikacionit është futur deri në palcë të shoqërisë, aq sa është e pamundur që individin ta mbyllim brenda një inkubatori apo brenda një terreni steril të izoluar nga çdo lloj ndikimi të jashtëm.

**E dyta:** Ndërmarrjet për formimin e individit kokë e këmbë nga ana e shtetit, në përgjithësi krijojnë reagime të ashpra. Për shembull, një praktikë e tillë me bosht laicizmin pozitivist, që u zbatua në Turqi gjatë periudhës së Republikës, nuk qe e suksesshme, me gjithë presionet e mëdha që bëri mbi qytetarët. Një situatë e ngjashme, por në një format tjetër, nuk ka pasur sukses as në Iran. Kur shkova në Iran në vitin 1994, pata bërë këtë pyetje: “Kaluan 15 vjet, që kur shpërtheu revolucioni islam. A keni arritur të formoni një brez që ka përvetësuar idealet e revolucionit islam në Iran?... Përgjigjja nuk qe pozitive.

**ÇFARË PRET NJË BESIMTAR NGA SHTETI?**

E vërteta është se njeriu ynë, veçanërisht ai fetar, shqetësohet për të ardhmen e fëmijëve të tij. Pyetja: **“Si do vejë halli i këtyre fëmijëve?”**, është halli i përbashkët i shumë prindërve. Shumë prindër ankohen për ndikimin negativ të shkollës, rrugës, internetit dhe televizionit mbi fëmijët dhe frika se **“do të na dalin fëmijët duarsh”**, ua shtrëngon zemrat përherë e më shumë si një darë.

E vërteta është se njerëzit e presin zgjidhjen e këtij problemi nga shteti dhe më shumë nga klasa politike e shtetit, e cila mendohet se ka të njëjtin shqetësim për rininë që formohet. Njerëzit mendojnë se shteti është përgjegjës që të mundësojë edukimin me vlera kombëtare dhe shpirtërore të të rinjve dhe të zhvillojë mjetet që të ruajë shëndetin psikik të tyre, të paktën në kuadrin e kushtetutës dhe të ligjit themelor të Ministrisë së Arsimit.

Natyrisht që nënshtetasit fetarë kanë dëshirë që rinia që formohet, të formohet mes të tjerash edhe me bazat e mësimave dhe edukatës islame.

Që prej poetit Mehmet Akif Ersoj dhe deri më sot, pikësynimi i **“brezit të Asimit”** ka mbetur gjallë në mendjet e njerëzve, simboli i të riut që nuk lejonte të shkelej nderi. Mehmet Akif Ersoji qe i vetëdijshëm për erozionin e individit, që po përjetonte shoqëria, prandaj edhe poezia e tij **“brezi i Asimit”** qe një hop për rrugëdalje.



*Laicizmi dhe demokracia nuk e shndërrojnë shtetin në një terren steril, pasi kjo është e pamundur. Madje, vetëm vlerat e personalitetit të një mësuesi apo ato të aktorëve politikë përpara shoqërisë, kanë efekt në edukimin e personalitetit të një fëmije.*



Poeti tjetër Nexhip Fazëll, synonte ndërtimin e "një rinie që e kishte përvetësuar ideologjinë islame".

Ky është fenomeni të cilin prindërit fetarë, që e konsiderojnë fëmijën si **një amanet të Zotit**, e shohin si fushën e përbashkët të përgjegjësisë.

**"Edukimi i një fëmije, tek i cili nuk ka ndikim shejtani"** as në zemrën, në sytë, veshët dhe në mendjen e tij, ka qenë dhe do të jetë fusha e provimit kryesor të çdo prindi mysliman.

## A ËSHTË LAICIZMI NJË BOSHLLËK VLERASH?

Myslimani synon që fëmija i tij të formohet me një personalitet, që të arrijë të bëhet një pasardhës i mbarë për të dhe, për këtë gjë, ai nuk kursen gjithçka që ka.

Brenda gjithçkasë përfshihet edhe shteti.

Por mund të ndodhë që në periudha të caktuara, shteti të mos punojë në mënyrë paralele me këtë ndjeshmëri të nënshtetasve të tij.

Madje, ai mund të parashikojë që ta shndërronjë laicizmin, që e pranon si parim të tijin, në një distancë mes Islamit dhe brezave të rinj.

Qoftë ky laicizëm një boshllëk vlerash, qoftë një manivelë për të formuar njeriun sipas prirjeve pozitive.

Ky ka qenë debati që është zhvilluar deri më sot dhe ky debat u bë duke e konsideruar popullin palë kundërshtarë.

Në të vërtetë, në këtë kohë kriza e rinisë apo, më në përgjithësi, shpërbërja e shoqërisë, si rezultat i boshllëkut të vlerave apo i abstraktimit nga feja, ekspozohen me gjithë tragjedinë e tyre nëpër faqet e gazetave apo nëpër lajmet televizive.

Kërkesa e shoqërisë ndaj shtetit për formimin e një brezi më të shëndoshë, sa vjen e rritet.

Në një shtet, siç është rasti i Turqisë, që ka 10 milion fëmijë dhe të rinj në procesin e edukimit dhe arsimit, përgjigjja e dhënë pyetjes në emër të shtetit se **"për cilën cilësi të njeriut"**, është e barasvlershme me pyetjen se "Cila do të jetë e ardhmja e Turqisë?"

Duke ditur se formimi i personalitetit fillon që në mitrën e nënës, atëherë është e papranueshme që fëmijët tanë, të cilët e kryejnë arsimimin e detyruar brenda formatit që ka përcaktuar shteti, gati në të gjithë fazat

e zhvillimit të tyre të privohen nga **"vlerat pozitive"**.

Për këtë arsye, kërkesa drejtuar shtetit që të tregojë kujdes se mos rinia edukohet me vlera negative, duhet të jetë vazhdimisht aktuale nga ana e shoqërisë.

Së dyti, shteti duhet të pajisë rininë me vlera pozitive të niveleve më të avancuara dhe të vazhdojë të punojë që ta shndërronjë shoqërinë në përcjellësin e vlerave shpirtërore tek brezat e rinj.

Së treti, është e qartë se ndjeshmëria dhe përgjegjësia e vërtetë në lidhje me **"brezin e ri"** bie mbi prindërit.

Amaneti u është lënë prindërve.

Prindërit janë të detyruar të dallojnë gjilpërën e busullës nga kibleja.

Në qoftë se tek fëmijët duhet gatuar një zemër e mirë, atëherë pyetja bazë që duhet bërë është: a kanë prindërit e fëmijës një zemër të mirë?

Pyetja bazë është: A është shtëpia që duhet konsideruar si një shkollë në vete për fëmijën, një mjet ideal i arsimit dhe edukimit të tij?

## CILIN BREZ TË RINJSH?

Natyrisht dhe sigurisht që brezin e të rinjve që krijon islami.

Ashtu sikurse kallinjtë e grurit me kokrra, që i falin gëzim zemrës së bujku, ashtu edhe rinia që do të formohet, duhet të gëzojë shpirtërisht prindërit e tyre, rinia që nuk është e huaj me bukurinë e saj, kur qëndron përkrah Musabit, rinia me të cilën Allahu është i kënaqur, rinia së cilës i dërguari i Allahut kishte kënaqësi kur ia ledhatonte flokët...

Rinia që është e pajisur me virtytet e humanizmit, e mbushur plot mëshirë dhe që ka kuptuar qëllimin e jetës.

Rinia që do të mjekojë me eliksirin që mban me vete, plagët e njeriut të këtij shekulli.

Një frymëmarrje e re. Një shpirt i ri. Një hop i ri.

Brez islam është ëndrra e bekuar që dëshirojmë të shohim si shoqëri, madje edhe si njerëzim.

Zemrat tona duhet të thërrasin emrin e kësaj rinie, edhe nëse vullneti politik nuk dëshiron që të zihet në gojë, edhe në qoftë se shteti laik nuk e përfshin këtë mision, edhe në qoftë se vatrat e pushtetit në botë nuk i përgjigjen etjes që ka njerëzimi.

Allahu dhuron rininë dhe vlerat që e bëjnë njeriun, njeri... Kushdo qoftë, me çfarë të drejte mund të pengojë që këto dy bukuri të takohen me njëra-tjetrën?



*Brezi islam  
është ëndrra e bekuar  
që dëshirojmë  
të shohim si shoqëri,  
madje edhe  
si njerëzim.*



# Namazi me xhemat

Doç. Dr. Ajnur Uraler

Faja islame i jep rëndësi të madhe bashkimit e unitetit të besimtarëve. Për këtë arsye, një sërë adhurimesh kryhen bashkërisht nga besimtarët dhe namazi është një nga këto adhurime. Kryerja e namazit me xhemat është një nga veçoritë kryesore të besimtarëve. Në shumë ajete dhe hadithe profetike u kërkohet me ngulm besimtarëve që t'i përgjigjen ezanit, duke shkuar në xhami për ta kryer bashkërisht namazin.

**Faleni namazin, jepeni zeqatin dhe përkuluni në ruku, bashkë me ata që përkulen (në namaz).** (Bekare, 43)

Kurse Pejgamberi (a.s.), urdhëron që dy vetë e sipër të kryejnë namazin me xhemat. (Buhari, ezan, 49.). Kjo urdhëresë fetare është zbatuar me rigorozitetin më të madh nga Profeti (a.s.). Nga praktika profetike mësojmë se Pejgamberi (a.s.), i ka kryer të gjitha namazet obligative në xhami me besimtarët.

Hadithet e shumta profetike, që flasin për rëndësinë e namazit me xhemat, dhe ndërtimi i xhamisë, me të arritur në Medinë nga ana e Pejgamberit (a.s.), janë tregues të rëndësisë së namazit me xhemat. Shumë hadithe profetike përgëzojnë besimtarët, të cilët kryejnë namazin me xhemat, për shpërblimet e shumta dhe të çmuara që do të përfitojnë në ditën e gjykimit. Madje, një nga shtatë grupet që do të merren nën mbrojtjen e Allahut në ditën ku nuk ka mbrojtje tjetër, janë ata që falin namazin me xhemat. Pejgamberi (a.s.), duke dashur të tregojë vlerën e namazit kolektiv, në krahasim me namazin individual, thotë:

*"Namazi kolektiv është njëzet e pesë herë më i vlefshëm se namazi individual. Nëse dikush merr abdest në mënyrë të plotë dhe nisët për në xhami me synimin e vetëm për të kryer namazin, për çdo hap që hedh Allahu e lartëson nga një gradë e i fshin nga një mëkat dhe, për sa kohë qëndron në xhami, engjëjt i luten Allahut për falje dhe mëshirë në emër të tij."* (Buhari, Salat, 87)

Është ky shkaku që sahabët tregonin kujdes të veçantë për të kryer namazin me xhemat; madje edhe gratë, kur gjenin mundësi, e kryenin namazin me xhemat. Nga tradita profetike mësojmë se Pejgamberi (a.s.), ka treguar një interes të veçantë për namazin, qoftë ky individual apo kolektiv.

**"Kur thërrisni për namaz, ata tallen dhe luajnë, sepse janë njerëz që nuk kuptojnë."** (El-Maide, 58)

Pra, siç kuptohet lehtësisht nga ajeti kuranor, mosvlerësimi, përbuzja dhe cinizmi ndaj namazit, janë qëndrime dhe sjellje të jobesimtarëve. Pejgamberi (a.s.), shpreh në shumë hadithe edhe rëndësinë e disiplinimit të veprimeve brenda namazit, si rregullimi dhe drejtimi i rreshtave. Urdhëresat për t'u veshur hijshëm dhe për të përdorur aroma të këndshme, kur shkojmë në xhami, është si pasojë e rëndësisë së jashtëzakonshme të namazit me xhemat.

Megjithëse sëmundja është arsye për të mos shkuar në xhami, Pejgamberi (a.s.) dhe sahabët edhe kur ishin sëmurë, bënëin përpjekje për të falur namazin me xhemat. Pejgamberi (a.s.), nuk e ka konsideruar punën në kohën e namazit, justifikim për të mos shkuar në xhami. Sa thirrej ezani, Ai linte çdo lloj pune dhe shkonte në xhami.

Megjithëse kishte një jetë të mbushur me aktivitete, Pejgamberi (a.s.), i kryente namazet obligative gjithmonë me xhemat. Nga praktika profetike nxjerrim konkluzionin se, përveç sëmundjes dhe rrezikut për jetën, asnjë arsye tjetër nuk shërben si justifikim për të mos falur namazin me xhemat. Kushtet e vështira nuk janë konsideruar pengesë për mosfajlen e namazit me xhemat. Myslimanët e sotëm duhet të jenë në komunikim të vazhdueshëm me njëri-tjetrin.

Namazi është shumëdimensional dhe më i rëndësishmi është dimensionin shoqëror. Në xhami, me xhemat mysli-manët futen në opinion. Namazi kolektiv është një tubim i besimtarëve për lutje të përbashkët, por edhe për takime të drejtpërdrejta personale. Nga kjo pikëpamje, namazi është në opozitë të theksuar me individualitetin negativ. Namazi është nga faktorët më të rëndësishëm të bashkimit dhe unitetit të mysli-manëve, kudo që ndodhen.

Namazi është shprehja më e përsosur e asaj që quajmë unitet bipolar i islamit. Distancimi nga namazi me xhemat bëhet shkak i përçarjes së mysli-manëve. Zgjidhja e problemeve sociale, të cilat nuk ka mundur t'i zgjidhë asnjë sistem, fillon me namazin me xhemat. I vetmi institucion, që i shërben më së miri qëllimit të bashkimit, është xhamia, sepse është vendi i përbashkët i të gjithë mysli-manëve ku mblidhen besimtarët. Xhamia është si shkollë e përditshme, e cila ushqen bashkim, barazi dhe vullnet të mirë.





*Ma. Muhidin Ahmeti*

## TË RINJTË DHE EDUKIMI I TYRE NË SHIKIMIN E PEJGAMBERIT TË ZOTIT (A.S.)

### HYRJE

Njeriu i ri është personifikim i freskisë dhe i fuqisë si dhe parashenjë e fitores dhe suksesit. Prej tij shkëlqen drita e shkathtësisë dhe e aftësisë e në fushën e punës bëhen evidente krijimtaria dhe mprehtësia. Historia ka shënuar një prani dhe pjesëmarrje masive të rinisë me rastin e rikonstituimit të qeverisjes së Pejgamberit (a.s.), duke kryer funksione dhe detyra përgjegjëse, sikurse janë ato administrative, mbrojtëse, gjyqësore dhe kulturore. Resulullahu (a.s.), është këshilluar dhe konsultuar me ta, gjë që vetvetiu flet për efektin e dëlirësisë dhe aftësisë së rinisë, për cilësitë e rëndësishme, të cilët Pejgamberi (a.s.), i ka pasur gjithnjë parasysh me rastin e ndonjë detyre.

Vështrimi i Pejgamberit (a.s.), mbi rininë ka qenë i shoqëruar me respekt ndaj identitetit (personalitetit) të tyre, ndaj ndjenjave, kërkesave të vërteta dhe me kujdesin ndaj zemrave të pastra e të sinqerta i ka udhëzuar edhe të tjerët ta bëjnë një gjë të tillë:

*“Ju këshilloj që të silleni mirë dhe me nder ndaj rinisë, sepse ata janë zemërbutë. Allahu më ka dërguar mua me fenë e vërtetë. Të rinjtë më kanë përkrahur e të moshuarit kanë punuar kundër meje.”*

Historia islame tregon se ata që e kanë përkrahur me gjithë zemër Pejgamberin (a.s.), në ditët e para të Islamit, kanë qenë djemtë e rinj. Gjeneratat e moshuara i janë kundërvënë dhe e kanë kundërshtuar, duke thurur komplete kundër tij dhe myslimanëve të parë.

Ebu Bekri dhe Abdurrahman ibn Aafi ishin tre vjet më të rinj se Pejgamberi (a.s.), kur e pranuan Islamit. Zejd ibën Harithi dhe Osman ibn Afvani, ishin njëzet vjeç, kur e pranuan Islamit. Omer ibn el-Hatabi, njëzet e gjashtë vjeç, Xhafer ibn Ebi talibi dhe Suhejb, tetmbëdhjetë vjeç, Ali ibn Ebi Talibi dhe Zubejr ibn Avvami, tetë vjeç.

### PEJGAMBERI (A.S.), MBI EDUKIMIN E RINISË

Edukimi i fëmijëve në frymën e Islamit është çështje themelore e familjes, farefisit, xhematit dhe umetit islam. Ndër funksionet më të rëndësishme të Muhamedit (a.s.), është që të jetë shembull fetar dhe moral për gjininë një-rëzore, deri në ditën e Gjykimit:

**“Vërtet, ti je në shkallën më të lartë të moralit!”** (Kalem, 4)

Këtë e vërteton edhe Pejgamberi (a.s.), në hadithin vijues:



*"Jam dërguar që t'i përkryej vlerat morale."* (Ebi Dunja dhe Hakimi)

Për edukimin e vet, Pejgamberi (a.s.), thotë: *"Më ka edukuar Krijuesi dhe Ai më ka dhënë edukatën më të mirë"*. (HZP, 53)

Muhamedi (a.s.), tregon në një hadith se si e ka edukuar nëna e vet Sulejmanin (a.s.): *"Biri im! Mos fli shumë natën, sepse gjumi i tepërt e bën të varfër njeriun në ditën e Gjykimit"*. (Bejhakiu nga Xhabiri - HZP, 1140)

Çfarë vlere ka edukimi i dy vajzave? Pejgamberi (a.s.), ka thënë:

*"Myslimani, i cili i edukon dy vajza (ua bën të mundur arsimin fetar dhe profan, si dhe i aftëson për jetë të pavarur) dhe sillet mirë me to, do të shpërblehet me xhenet"*. (HZP, 1455)

Në një rast tjetër, Pejgamberi (a.s.), thotë:

*"Më i dashuri rob tek Allhu është ai që ka edukatën më të mirë"*. (HZP, 36)

Që njeriu të jetë i dobishëm, në kuptimin islam dhe i gjallë në mënyrën islame edhe pas vdekjes fiziko-biologjike, sipas hadithit është rruga në vijim:

*"Kur njeriu vdes, veprat e tij ndërpriten, përveç në tre raste: sadakaja e vazhdueshme, dituria, nga e cila përfitojnë njerëzit dhe fëmija i mirë, i cili lutet për të"*. (Muslimi, HZP, 349)

Pejgamberi (a.s.), i këshillon mysliimanët në ç'drejtim duhet t'i edukojnë fëmijët e tyre:

*"Edukoni fëmijët tuaj me këto tri cilësi: ta duan Pejgamberin, ta duan familjen e tij dhe të mësojnë në Kuranin. Me të vërtetë, bartësit e Kuranit (hafizët) do të jenë në hijen e Allahut - me Pejgamberët dhe të zgjedhurit e Tij - atë ditë, kur nuk do të ketë hije tjetër përveç hijes (mbrojtjes) së Allahut"*. (HZP, 54)

Çfarë rëndësie dhe peshe ka edukimi, këtë e ilustrojnë më së miri fjalët vijuese të Pejgamberit (a.s.):

*"Më mirë është që dikush prej jush të edukojë fëmijën e vet (në frymën islame), sesa t'u ndajë çdo ditë të varfërve nga gjysmë sa'ji (në vlerën e sadeaktul fitrit)"*. (HZP, 1284)

Se çfarë pasojash dhe vështirësish u sjell prindërve të vet fëmija i paedukuar, dëshmon hadithi në vijim:

*"Nuk e ke armik njeriun që e vret në luftë dhe arrin famë*

*(bëhesh veteran), ose të vret ai ty dhe ti bëhesh shehid dhe meriton Xhenetin. Armik i vërtetë është fëmija yt (i paedukuar) që ka dalë nga kurrizi yt. Pastaj, armik është edhe malli yt, të cilin e ke fituar me duart e tua (e ai të është bërë preokupimi i vetëm)"*. (HZP, 1359)

Se cila është vlere më e madhe, margaritari më i shtrenjtë dhe stolia më e bukur, të cilën prindërit mund t'ua lënë fëmijëve të tyre, përgjigjet Pejgamberi (a.s.):

*"Edukata e mirë është trashëgimia më e çmueshme, të cilën prindi mund t'ia lërë fëmijës së vet"*. (HZP, 1463)



*"Më mirë është që dikush prej jush të edukojë fëmijën e vet (në frymën islame), sesa t'u ndajë çdo ditë të varfërve nga gjysmë sa'ji (në vlerën e sadeaktul fitrit)"*.

Nga djaloshi dhe vajza e edukuar nuk ka dobi vetëm ai vetë dhe ajo, prindërit e tyre, farefisi, fqinjët, por edhe njerëzit në përgjithësi:

*"Kush rrjedh nga një familje e mirë dhe fisnike, lindet dhe edukohet në një familje të ndershme, prania e tij në shoqëri do të jetë e pëlqyeshme dhe e dëshiruar"*. (HZP, 1718)

Një nga çështjet në edukimin e fëmijëve, që duhet mësuar që në rininë më të hershme, sapo të fillojnë të dinë për veten, është përshëndetja islame:

*"Biri im - i tha Alejhisselami Enesit (r.a.), kur të hysh në shtëpinë tënde, jep selam, sepse ai do të jetë bereqet - do të të sjellë mirësi ty dhe familjes sate"*. (HZP, 1949)

Duke iu drejtuar një djali të ri dhe duke e udhëzuar në bazat e edukimit, karakterit dhe mbrojtjes në të dyja botët, Pejgamberi (a.s.), thekson:

*"O djalosh, ruaju (bindju) Allahut dhe përmbaju asaj që të ka urdhëruar, se edhe Ai ty do të të ruajë. Dëgjoje Allahun dhe zbatoji dispozitat e Tij, se gjithmonë do ta kesh pranë vetes si mbrojtës. Nëse ke nevojë për diçka, kërkoje atë prej Allahut. E, ndërkaq, nëse ke nevojë për ndihmë, edhe atëherë drejtoju Allahut të Lartësuar"*. (Tirmidhiu nga Ibni Abbasi, HZP, 1954)

Hadithi i cituar udhëzon në dy qëndrime themelore të drejta në jetë: Të robëruarit vetëm Allahut (xh.sh.) dhe të kërkuarit e ndihmës vetëm prej Tij. Kështu fitohet pavarësia në jetë dhe evitohet poshtërimi para njerëzve. Janë epshet e forta, instinktët dhe pasioni ato që e rrezikojnë dhe e dëmtojnë më së shumti edukimin e të rinjve. Një djali të ri, që e frenon veten në emër të Allahut, i rritet vlere dhe i shtohen virtytet:

*"Allahu i Madhërishëm lartëson dhe shton vlerën e atij të riu, i cili i frenon pasionet e veta dhe nuk jepet pas tyre". (HZP, 509)*

Njeriu nuk mund t'i zhdukë asnjëherë pasionet, por mund t'i kontrollojë ato dhe përmes rrugës së sheriatit, të kanalizojë edhe martesën e vlefshme. Duke përshkruar rininë më të mirë, Pejgamberi (a.s.), thotë:

*"Rinia më e mirë është ajo që i ngjan pleqërisë (d.m.th., kur i riu me sjelljen e tij, edukatën dhe veprat e mira, ndjek shembullin e një plaku shembullor); ndërsa pleqëria më e keqe, është ajo pleqëri që i ngjan rinisë (do të thotë, kur plaku imiton të riun në veshje dhe në sjellje). (HZP, 825)*

Duke përmendur vijat karakteristike dhe integruese unike të njeriut, Pejgamberi (a.s.), pohon:

*"Fisnikëria dhe zemërgjerësia e njeriut janë feja e tij, njerëzshmëria - mendja e tij, ndërsa origjina - edukata (moral) i tij." (HZP, 1164)*

Besimtarët e vërtetë edukohen prej fëmijërisë, deri në moshën e rinisë me ndihmën e fesë dhe të etikës e, jobsimtarët, idhujtarët dhe kafshët në mungesë lirie, stërviten gjatë tërë jetës. Edukimi është brengë e mundimshme dhe pasiguri në liri, ndërsa stërvitja arrihet brenda natës. Që të hiqet edukimi e të imponohet stërvitja, njerëzit më parë duhet t'i "çlironi" nga feja, etika, ndërgjegjja dhe liria dhe t'i ktheni nga kultura në civilizim. Ja si e këshilloi Pejgamberi (a.s.), djalin e H. Omerit, Abdullahun (r.a.):

*"Biri im! Jeto në këtë botë, sikur të jesh i huaj ose udhëtar. Ndërsa vetë Ibni Omeri, duke këshilluar të tjerët, e kishte bërë zakon t'u thoshte: Kur të ngrysesh, mos prit mëngjesin e kur të zgjohesh, mos prit mbrëmjen. Derisa je i shëndoshë, përgatitu për sëmundje e gjatë jetës, përgatitu për vdekje." (HZP, 1205)*

Në pikëpamje të edukimit të fëmijëve dhe përvetësimit të shprehive dhe veprimeve islame, është me rëndësi të shohim si sillej vetë Pejgamberi (a.s.):

*"Alejhisselami shërbehej me dorën e djathtë në të ngrënë dhe në të pirë, madje edhe kur merrte abdest ose kur vishej, si dhe kur jepte dhe merrte diçka. Kurse me të majtën, në raste të tjera." (HZP, 1263)*

Një metodë e rëndësishme, që Pejgamberi (a.s.), e thekson në edukimin e të rinjve, është edhe metoda e stimulimit dhe udhëzimit të tyre në besim të fuqishëm dhe sjellje të mirë. Në hadithin autentik, të cilin e transmeton Buhariu dhe Myslimi, Pejgamberi (a.s.), përmend "shtatë kategori njerëzish, të cilët Allahu (xh.sh.), do t'i vendosë nën hijen e Vet në ditën e Gjykimit, kur nuk do të ketë hije tjetër përveç hijes së Tij." Njëri prej tyre, si kategori e veçantë, është edhe "një djalë i ri, që është rritur i nënshtruar ndaj Allahut."

### **NË VEND TË PËRMBYLLJES**

Përmbajtje e rëndësishme e edukimit është etika (moral), përmes funksionimit integrues të vijave karakteristike të njeriut. Edukimi është etika e implementuar dhe

ndërgjegjja e njeriut në veprim dhe aksion. Fuqinë më të madhe dhe bazën, edukimit ia jep vetëdija dhe bindja ndaj Zotit, sikur jemi duke e parë; ndonëse ne nuk e shohim, Ai na sheh ne. Në themele të pandryshueshme të edukimit bën pjesë Besimi në Zotin Një të Vetëm, devocioni, nënshtrimi, robërimi vetëm Atij dhe bindja e padiskutueshme ndaj vullnetit të Tij, në formën e ligjit fetar. Nuk duhet asnjëherë në jetë të shprehim elemente të dyshimit dhe mosbesimit karshi Krijuesit dhe as të identifikojmë dikë me Allahun (xh.sh.). Nuk duhet kurrë të gënjejmë dhe të dëshmojmë rrejshëm. Nuk duhet të vjedhim, uzurpojmë, plaçkitim pasurinë e huaj.

Kurrë nuk duhet të hedhim fall, të bëjmë magji, të luajmë kumar, të profetizojmë, të konsumojmë pije alkoolike dhe drogë. Është i ndaluar përgojimi, përqeshja, sharja, ofendimi i njerëzve dhe dhënia e pseudonimeve të këqija. Në gjynahe të mëdha bën pjesë edhe z i n a l l ë k u (prostitucioni), xhelozia, dhuna, përçarja, mendjemadhësia, zilia, dashuria e sëmurë ndaj dynjallëkut dhe privilegjeve, narcizmi dhe vendosja e njeriut në qendër të botës. Rrezikimi i jetës së të tjerëve, besimit, pasurisë, nderit dhe dinjitetit, bën pjesë në gjynahet e pafalshme. Fëmijët duhen edukuar që të mos bëjnë dhe të mos lejojnë t'u bëhet dhunë prej askujt. Është me rëndësi të besojnë dhe të dinë që Allahu është burimi dhe Ai i jep nafakën çdokujt e, për fenë, secili njeri duhet të kujdeset individualisht brenda lirisë njerëzore.

Se sa rëndësi i ka kushtuar Pejgamberi (a.s.), edukimit të gjeneratave të reja, mund të shihet edhe nga thëniet e tij vijuese:

*"O djalosh, ruaje Allahun dhe përmbaju asaj që të ka urdhëruar, se edhe Ai do të të ruajë ty. Dëgjoje Allahun dhe zbatoji dispozitat e Tij, se gjithmonë do ta kesh pranë vetes*





si mbrojtës. Nëse ke nevojë për diçka, kërkoje atë prej Allahut. E, ndërkaq, nëse ke nevojë për ndihmë edhe atëherë drejtoju Allahut të Lartësuar. Dije se, sikur të mblidheshin gjithë njerëzit të të ndihmojnë në diçka, nuk mund të të ndihmojnë, përveçse në atë që të ka caktuar Allahu. Po ashtu, sikur të mblidheshin të gjithë të të bëjnë ndonjë dëm, nuk mund të të dëmtojnë, përveçse çka të ka caktuar Allahu. Lapsat janë ngritur dhe ngjyra është tharë.” (Tirmidhiu, cituar sipas: Sh.Kurdiç, vep. cit.)

*“Shfrytëzoni pesë gjëra, para pesë të tjerave. Jetën para vdekjes, shëndetin para sëmundjes, kohën e lirë para se të zihesh me diçka, rininë para pleqërisë dhe pasurinë para varfërisë.” (Bejhakiu, HZP, 397)*

Fjalët e ëmbla të Pejgamberit të Allahut (a.s.), janë ilaçi më i mirë për zemrat e lodhura, të cilat kërkojnë udhërrëfim dhe udhëzim të përkryer.

Zemrat lodhen si trupat. Për këtë arsye, që të evitoni lodhjen nga zemrat tuaja, kërkonit urtësi tepër të rralla.

Me të vërtetë, këshillat, rekomandimet dhe udhëzimet e Pejgamberit të Allahut, janë si një pranverë që e lidh njeriun e ri me bërthamën e lumturisë, ndërsa mundësitë dhe progresin e tij i paraqet dhe i shpalos në dritën e fesë.

Nga fjalët e të urtit bëhesh i fuqishëm. Thuaji ashtu si i ke dëgjuar prej tij.

Këshilla e Pejgamberit (a.s.), është kritika e jetës që është shumë e shkurtër. I lumi ai, që në rini e ka njohur vlerën e Pejgamberit (a.s.) dhe i ka dëgjuar këshillat e tij të vlefshme dhe pastaj i ka zbatuar praktikisht në jetën e tij.

Pejgamberi ynë (a.s.), na mëson të jemi prej atyre të cilët prijnë në të mirë dhe e shfrytëzojnë të mirën që zotërojnë.

Një gjë, për të cilën na paralajmëron Pejgamberi ynë,

është ajo pjesa e hadithit, në të cilin thotë që ta shfrytëzojmë rininë para pleqërisë. Sa i madh është numri i atyre njerëzve të moshuar, të cilët pendohen për shkak të rinisë së shkatërruar dhe bredhjeve në vitet, në të cilat më së shumti, mund të fitohen vlerat në rrugën e Islamit. Sa është numri i atyre, të cilët rininë e kanë kaluar në lajthitjen dhe shpresën se do t'i pranojnë dispozitat e Islamit, kur të vijnë vitet e pleqërisë e ato vite asnjëherë nuk erdhën, sepse i ndërpreu vdekja?

Të rinjtë kanë qenë dhe mbeten bartësit më të mëdhenj të ideve dhe projekteve progresive dhe revolucionare. Ata kanë qenë shtylla kryesore edhe në paqe edhe në luftë. Rinia është ajo, e cila, pa kalkulime i është kundërvënë agresorit. Mirëpo, si është sot gjendja e rinisë sonë? Ata që nuk preokupohen për gjendjen e rinisë, do të bëhen viktimë e tyre.

Në fillimin e Islamit, si dhe në historinë e mëvonshme, rinia ka qenë fuqia kryesore e Muhamedi (a.s.), i ka kush-tuar asaj vëmendje të veçantë. Ai mburrej me sahabët e tij të rinj dhe i caktonte në krye të ushtrisë, sikurse është rasti i Ali ibn Ebi Talibit, Usame ibn Zejdi, Abdullah ibn Abbasi, Abdullah ibn Omeri, Abdullah ibn Amri etj. Në kohën e Pejgamberit (a.s.), rinia shquhej për të mirë në çdo fushë të jetës njerëzore. Ata bënë gara në çdo gjë që është e mirë. Në çfarë bëjmë gara ne sot dhe cili është qëllimi ynë?

Gjatë historisë, me ndihmën e Allahut, rinia ka qenë fuqia e umetit, shtylla e ngritjes së tij, burimi i nderit, besnikërisë dhe shpresës për të ardhmen. Një rini, e cila nuk është zhytur në gjynah dhe e njëj të vërtetën, gjithmonë ka fuqi shtesë që t'u rezistojë shumë sprovave dhe të tregojë fuqi të madhe në udhëheqjen e umetit. Armiqtë e Islamit e dinë ç'do të thotë të kesh rini të fuqishme, të edukuar, të arsimuar dhe me perspektivë, andaj edhe investojnë mjete dhe përpjekje kolosale në largimin e saj nga vlerat islame, duke i shpënë në botën e materializmit dhe boshësisë.

Pamja e jashtme e rinisë është disfatiste. Ka së tepërmi djem, të cilët u përngjajnë vajzave dhe anasjelltas. Vathet që mbajnë djemtë në veshë, mund të konsiderohen gati normale, kur e kemi parasysh se ato i mbajnë edhe në vetulla, hundë, ballë apo stomak. Shenja të çoroditjeve të tilla, deri vonë nuk ka pasur në këtë tokë shqiptare. Nganjëherë është e vështirë të dallosh mashkullin prej femrës, sepse edhe njëra palë edhe tjetra vishen gati në mënyrë identike. Pejgamberi (a.s.), na paralajmëron për mallkimin që është paraparë për ata, të cilët imitojnë të tjerët:

*“Allahu i ka mallkuar meshkujt, të cilët imitojnë femrat dhe i ka mallkuar femrat, të cilat imitojnë meshkujt.” (HZP, 1297)*

**P.S. :** Artikulli është shkëputur nga libri: “Sfidat e rinisë bashkëkohore në kohën e globalizmit”, Wels - Austri, 2008.



Edison Çeraj

# HASAN TAHSINI

## mes Lindjes dhe Perëndimit

*Një model se si njësohet hoxha me intelektualin dhe anasjelltas*

Hasan Tahsini (Hasan Osman Rushiti) lindi në fshatin Ninat të Konispolit, më 7 prill të vitit 1811. Osman efendiu, i ati i Tahsinit, ishte njeri i arsimuar, me kulturë të gjerë; njohës i mirë i filozofisë dhe i letërsisë islame. Ai ishte një mësues i nderuar dhe i kërkuar. Mësimet e para të birit ia dha në medresenë më të mirë të zonës, në atë të fshatit Pandalejmon dhe më pas, në medresenë e Mustafa Pashë Bushatlliu në Shkodër (1822-1830). Shkollën qytetëse dhe atë fetare e vazhdoi në Janinë dhe më pas, vazhdoi e përfundoi me sukses studimet në Medresenë "Fatih", një ndër më të njohurat e Stambollit. Përveç vlerësimit "shkëlqyeshëm" që mori në këtë shkollë, atij iu atribua edhe epiteti *tahsin* prej dijetarit të njohur, mësuesit të tij, Mustafa efendi Vidini, që në gjuhën shqipe përkthehet si *i nderuar, i fisnikëruar* etj. Pikërisht kjo fjalë, me kalimin e kohës u shndërrua në mbiemrin e tij.

Në vitin 1857, me dekret të Sulltanit, së bashku me disa dijetarë të tjerë të zotë të kohës së tij, dërgohet në Paris, në Universitetin me emër të Sorbonës, për të studiuar në fakultetin e shkencave të natyrës dhe më pas në atë të shkencave shoqërore.

Sipas Dervish Himës, Hasan Tahsini, "...për 16 vjet shërbeu si imam në ambasadën osmane në Paris. Gjatë kësaj kohe ai studioi me seriozitet të madh shkencat dhe filozofinë e Perëndimit."

Hasan Tahsini dinte bashkë me shqipen 11 gjuhë. Tri gjuhë të Lindjes: arabisht, persisht dhe osmanisht; gre-

qishten e re, greqishten e vjetër dhe latinishten i përvetësoi në Sorbonë; frëngjishten dhe italishten dhe, sipas të dhënave më të fundit, mendohet të ketë ditur edhe anglishten e gjermanishten. Dëshmia më e mirë për këtë janë veprat *Shkrimet e popujve* dhe *Alfabeti* origjinal i tij për gjuhën shqipe.

Në vitin 1869 kthehet në Stamboll dhe emërohet rektor i Universitetit, inaugurimi i të cilit u bë në fillim të vitit 1870. Por, në fund të po këtij viti e shkarkojnë, ngaqë ai paraqiti në universitet disa kumtesa publike nga fushat e astronomisë e të filozofisë, në të cilat flitej mbi "hapësirën e botës së madhe" dhe mbi "botën e vogël", siç e quante ai veprimtarinë psikike të njeriut, gjë që shkaktoi reagime te krerët fetarë të Stambollit. Më vonë jep mësim në një shkollë private. Biografët pohojnë se shtëpia e tij në Stamboll u shndërrua në një universitet të mirëfilltë, ku zhvillonte leksione mbi shkencat e natyrës, psikologjinë, filozofinë, mbi historinë, letërsinë etj.<sup>1</sup>

Në historinë e kulturës shqiptare të Rilindjes sonë Kombëtare, Hasan Tahsini ka hyrë si një nga figurat më të shquara të shekullit XIX, kurse në historinë e shkencës turke, si më i larti ndër të lartët dhe, në historinë e arsimit të lartë të Turqisë, si rektori i parë i Universitetit të Stambollit, si ligjëruesi i parë në shkencat sociale e ato natyrore.

1. Kondi, S. *Ylli i çamërisë - Hasan Tahsini*, Tiranë, 1998.



Tahsini punoi për alfabetin shqip dhe synonte që të ishte i ndryshëm nga alfabetet e gjuhëve të tjera, që të përfaqësonte kështu karakteret dhe tiparet e identitetit kulturor shqiptar, në mënyrë që të tregonte edhe karakteristikat e këtij populli. Pra, ai punonte për një alfabet i cili të ishte organik dhe në përputhje me gjendjen dhe specifikat e atyre që do t'u ofrohej. Tahsini qe mësues i Abdylit, Naimit e Samiut, Vaso Pashës, Jani Vretos, Ismail Qemalit e Daniel Oparakut.

Ai ka qenë mësues shtëpie i historianit zyrtar të famshëm osman, Hajrullah Efendi, i ati i dramaturgut dhe poetit me famë osmane, Abdulhak Hamit. Në *Enciklopedinë turke*, Hasan Tahsini cilësohet si njeriu që futi dijet e reja të Perëndimit në Perandorinë Osmane, pra edhe në Ballkan e në Shqipëri. Ai ndërroi jetë më 4 korrik 1881. Trupi i tij u vendos në varrezat e lagjes Eren Qoj në Ysqydar, në të njëjtat varreza ku do të varroseshin edhe tre vëllezërit Frashëri.<sup>2</sup>

Bashkëkohësit dhe biografët e jetës së Hasan Tahsinit tregojnë se ai jetonte në një dhomë të thjeshtë. Muret dhe tavani i saj ishin të mbuluara me figura dhe formula fizike, matematike, kimike, gjeologjike, astronomike dhe kalendare kohore. Të gjitha këto pasqyronin angazhimin e tij intelektual. Çdo pjesë, fragment apo send në dhomën e tij të studimit, provonte një prirje intelektuale ose një dëshirë të themeltë për t'i çuar dijet në origjinë, përmes harmonizimit ndërmjet tyre. Përballë shtratit mbante një makinë që prodhonte energji elektrike, në dritare kishte një tejçyrë me të cilën vëzhgonte qiellin, tek këmbët e krevatit mbante një grimcavëzhgues (mikroskop), në krahun e majtë të krevatit gjendej një instrument prej dërrase për matjen e lartësive. Dhomën e pastronte vetë, duke treguar një kujdes të imët për instrumentet, hartat dhe librat.

Vishej thjesht, me pantallona e xhakete kadifeje; në kokë mbante një feste me sarak, mbi krahët hidhte një xhybe, të cilën e mbante në dorë kur kalonte urën e Galata-së apo kur shëtiste në Bejollgu. Sarekun e lidhte për bel. Nuk harxhonte shumë kohë për të gatuar dhe shpeshherë ushqehet me bukë e djathë. Jeta e tij ngjason

me atë të filozofëve dhe dijetarëve të mëdhenj të të gjithë kohëve që jetonin thjesht, urrenin luksin, thelloheshin në studime e shkujdeseshin për veten dhe familjet e tyre. (B. Telegrafi)

Siç e shohim, Hasan Tahsini jetoi, studioi dhe punoi në Lindje dhe në Perëndim. Njohu mirë gjuhët, kulturat dhe arritjet e popujve lindorë e perëndimorë. Për evropianët thoshte: "Ata janë më të përparuar se ne, por ende kanë shumë të meta dhe shumë nevoja". Për popujt

myslimanë thoshte: "Duhet të arsimohen, por edhe përvoja e botës perëndimore duhet njohur. Mendimi islam duhet bashkuar me praktikën perëndimore. Reforma e shoqërisë islame është e mundshme, para së gjithash, me përtëritje të themeltë dhe me ngulmimin e arsimit islam. Lëvizja dhe kultura islame nuk mund ekzistojnë pa ide. Ideja islame duhet të kalojë te masat. Populli duhet t'i njohë, por edhe t'i praktikojnë parimet islame."

Në fjalinë e fundit Tahsini na ndërmend parimin e njohur islam, që "dija i paraprin veprës", mosnjohja e të cilit e shpie njeriun në shpërfilljen e dijes dhe për pasojë edhe te tjetërsimi apo asgjësimi i veprës ose në veprime përherë e më të çorientuara.

Studimet dhe pikëpamjet e tij filozofike u përqendruan në problemin themelor e parësor të filozofisë, mbi ekzistencën, duke mbrojtur idenë se qenia fillestare dhe e domosdoshme, por pa fillim dhe qenia e fundit, por pa mbarim është Zoti, prej të Cilit burojnë dy entitete. Së pari, realiteti ideal i pasqyruar në botën e padukshme të ideve dhe, së dyti, në materie dhe shtrirje. Në analizën e raportit Zot-Botë-Ekzistencë, ai mbron përfundimin se Zoti është Qenia e domosdoshme, ndërsa çdo gjë tjetër është e krijuar dhe ka një fillim dhe një fund, se Zoti është intelekt dhe jo njohje perceptuese, por që njeh gjithçka; se Qenia dhe Ekzistenca e Zotit dallon në mënyrë cilësore nga qenia e botës, duke iu kundërvënë kështu filozofëve panteistë, që e barazonin/njësonin Zotin me natyrën, si dhe filozofëve materialistë, që mohonin ekzistencën e tij.

Si gjithë deistët pararendës, Tahsini pranonte se Zoti e ka krijuar botën dhe e drejton atë nëpërmjet ligjeve të krijuara prej Tij, dhe prania e Zotit vazhdon. Se e gjithë natyra, shoqëria dhe mendja njerëzore zhvillohet sipas



*Tahsini na ndërmend parimin e njohur islam, që "dija i paraprin veprës", mosnjohja e të cilit e shpie njeriun në shpërfilljen e dijes dhe për pasojë edhe te tjetërsimi apo asgjësimi i veprës ose në veprime përherë e më të çorientuara.*

2. Bica, L. *Revista Pedagogjike*, nr 2., fq. 119, 1983.

këtyre ligjeve. Duke qëndruar në këto pozita, ai ishte përjashtues ndaj çdo paragjykimi dhe besëtytnie. Në rastin e një eklipsi të hënës, kur njerëzit filluan të qëllonin hënën me armë, Tahsini u tha: "E keni të kotë që qëlloni hënën, nuk shkojnë plumbat deri atje, asaj i ka dalë në mes dheu." Ai ishte kundër besëtytnive: "Injoranca i quan shkencën dhe teknikën magji dhe kërkon të mohojë ligjet e Krijuesit. (B. Telegrafi)

Hasan Tahsini është i pari shqiptar që bëri studime të mirëfillta në psikologji. Mendimet e tij në këtë fushë, i publikoi në librin *Ilmi-ruh (Dija mbi shpirtin)*. Në këtë libër ai ndalet në këto çështje thelbësore:

- Në objektin e psikologjisë dhe lidhjet që ka ajo me filozofinë, logjikën dhe kuptimet për shpirtin.

- Mbi njohuritë thelbësore për proceset e ndryshme psikike.

- Shpjegime mbi bazat materiale e fiziologjike, ku bëhen përpjekje që, duke u nisur nga këto baza, të analizohet ndërtimi dhe funksionimi i sistemit nervor-qendror apo periferik dhe trurit të kafkës. Këtu hidhet edhe ideja e ekzistencës në tru të depove apo frytësive të caktuara.

- Njohuri mbi gjuhën dhe lidhjet e saj me të folurin dhe të menduarit.

Ai shpreh pikëpamjen se logjika është shkencë e parimeve të veçanta, të cilat na ndihmojnë të mos biem në gabime gjatë procesit të të menduarit.

Ai shkruan: "Logjika është shkencë dhe art; shqyrton parimet edhe ligjësitë e të menduarit si shkencë, sepse ajo i jep shtysën dhe e drejton mendimin tonë kah zbulimi dhe kërkimi i së vërtetës". Psikologjia është "shkencë e rëndësishme, që flet për shpirtin dhe fuqinë e tij e natyrën e këtyre fuqive, se psikologjia është shkencë mbi praktikën e njeriut dhe veçanërisht mbi fuqinë arsyetuese". Ai shënjon dallimin midis psikologjisë dhe shkencave të tjera, sepse tek psikologjia "objekti i studimit dhe mjetet për përvetësimin e saj përputhen". Lidhur me këtë problem, ai thekson: "Në qoftë se besojmë në ekzistencën e forcës së proceseve psikike, që i japin shkak lindjes së fenomeneve shpirtërore, kjo ndodh ngaqë ne ndiejmë dhe kuptojmë pasojat që shkaktojnë ato në shpirtin tonë, që arrihet nëpërmjet vetëdijes. Meqenëse çdo pasojë ka një shkak, është e natyrshe që fenomenet dhe mbresat tona shpirtërore duhet t'i shpjegojmë pikërisht nëpërmjet këtyre fuqive".

Lidhur me raportin midis psikologjisë dhe filozofisë, Hasan Tahsini i trajton dijet psikologjike si rezultat apo arritje përfundimtare, që vijnë nga hulumtimet në fushën filozofike: "Ja pra, kur filluan dijetarët të merren me hulum-

timet filozofike, lindi psikologjia." Për të, psikologjia dhe filozofia nuk janë një, por si psikologjia, ashtu dhe logjika janë degë e të njëjtit trung, që është filozofia; psikologjia, nga pikëpamja e lindjes së saj është një nga arritjet e vonshme të filozofisë dhe nuk duhet të na shkojë në mendje se asaj nuk i duhet dhënë përparësi mbi shkencat e tjera. (B. Telegrafi)

Për të kuptuar rolin e psikologjisë, duhet të konceptojmë qartë njeriun si qenie e arsyeshme me intelekt dhe aftësi tepër të zhvilluara njohëse, që i krijojnë mundësi të njohë realitetin, duke hyrë në brendësi të sendeve dhe dukurive dhe të zbulojë lidhjet e raportet që ekzistojnë midis tyre e të përvetësojë dukuritë që i duhen. "Mirëpo kjo qenie njerëzore, është ashtu siç thotë Aristoteli, një tërësi e përbërë nga organe dhe elemente materiale e shpirtërore apo, siç kanë thënë disa dijetarë, një shpirt abstrakt, i cili vihet në veprim e në lëvizje nëpërmjet organesh materiale?" Në lidhje me këtë çështje, ai shpreh qëndrimin e tij dualist se shpirti e trupi janë dy substanca të pavarura nga njëra-tjetra; domethënë, mbështet qëndrimin e Descartes-it.

Duke folur për "fuqitë" e të menduarit dhe të proceseve psikike, ai hedh idenë se mbas tyre qëndrojnë forcat mbinatyrore.

"Në skajin fundor të shkaqeve e të ligjeve të natyrës, kërkohet një shkak i parë, në rrethin e krijesave; një qendër pjellore zanafillëse, ku të mbarojë rrezja e krijimit, një qendër nga e cila buron koha dhe hapësira dhe gjithçka që shtrihet në to dhe drejt së cilës këto kthehen e rrjedhin në vazhdimësi. Lavdëruar qoftë Zoti, që është krijuesi më i mirë".

Këto ishin vetëm disa pjesëza nga jeta dhe veprimtaria e gjerë intelektuale e Hasan Tahsinit, aq sa për të krijuar një profil paraqitës.

Ai mbetet nga ato figura që vetëm sa janë "gërvishtur", siç ka ndodhur edhe me të tjerë dijetarë, të cilët kanë qenë të vetëdijshëm për ndarjet kallpe të dijeve në dije fetare dhe jofetare. Pra, ndryshe nga pjesa më e madhe e hoxhallarëve sot, për Tahsinin nuk kishte asnjë ndarje terroresh midis hoxhës dhe intelektualit dhe, mbi të gjitha, këtë ai e dëshmoi me jetën dhe angazhimin e tij. Për njerëz të tillë ka pasur vetëm një standard në këtë rrugetim: hulumtimi në disa dije njëherësh dhe harmonizimi i të vërtetave të nxjerra gjatë këtij procesi.

Ndër të tjera, ka shkruar edhe këto fjalë: "Zoti është shpirtmadh dhe i do e i ndihmon ata që ndihmojnë vetëveten".

*Hasan Tahsini është i pari shqiptar që bëri studime të mirëfillta në psikologji. Mendimet e tij në këtë fushë, i publikoi në librin Ilmi-ruh (Dija mbi shpirtin).*



# RINIA ideale

Husejn Kerim Exhe

## RINIA NË KURAN

Në Kuran, fjala "فِئَة" el-Feta, së bashku me format e saj, kalon në dhjetë ajete. "el-Feta" do të thotë, "djalë i ri, djalosh". Arabët e kanë zakon që në të shumtën e rasteve, djemtë të cilët punojnë si shërbyes, t'i thërrasin me fjalën "feta / djalosh".<sup>1</sup>

Profeti ynë (a.s.), ka thënë: "Shërbyesit tuaj mos i thërrisni me fjalët "skllav apo skllave", por me fjalët "djalosh apo i ri" (fetaje, fetajeti)" (Buhari, Ilim/44, Enbija/27. Muslim, Fedail/170. Tirmidhi, Tefsir/18. Darimi, F. Kur'an/24.)

Sigurisht që midis fjalëve *skllav*, *shërbyes* etj. dhe fjalëve *vëlla*, *djalosh* ose *thirrjes* me emër, Ahmed, Hasan etj., ka ndryshim të madh. Me fjalët e para nënkuptohet poshtërim dhe mendjemadhësi. Ndërsa me fjalët e tjera, tregohet modesti dhe nderim për krijesën e Allahut. Kjo, sepse Allahu e ka krijuar njeriun me nder dhe i ka dhënë shumë vlerë. (Shih. El-Isra, 70.)

Edhe në kohët e vjetra, nxënësit që shkonin për të marrë mësim prej ndonjë dijetari, thirrreshin me fjalën "feta". Por kjo fjalë ka edhe kuptimin *skllav* apo *skllave*. Këtë kuptim e gjejmë në Kuran, në suren Jusuf, 30 dhe suren en-Nisa 25.

## UDHËTIMI I MUSAIT (A.S.), ME NJË DJALË TË RI

Kurani Kerim na e tregon kështu këtë ngjarje:

1. IbënMandhur, Lisanu'l-Arab, 11/127-128. Isfehani, el-Mufredat s: 560

*(Kujto) kur Musai i tha djaloshit që e shoqëronte: "Nuk do të pushoj së ecuri, derisa të arrij në vendin ku takohen dy detet, edhe nëse do të më duhet të udhëtoj për shumë kohë." Dhe, kur arritën në vendin, ku bashkoheshin dy detet, ata e harruan peshkun e tyre dhe ai rrëshqiti në det, duke e hapur atë si tunel. Kur kaluan më tej, Musai i tha shoqëruesit të vet: "Na jep drekën tonë, sepse jemi lodhur nga ky udhëtimi ynë". Ai u përgjigj: "Shiko! Kur ndaluam tek ai shkëmbi, unë e harrova peshkun. Vetëm djalli më bëri ta harroj e nuk ta thashë se peshku mori rrugën nga deti në mënyrë të habitshme!" (Musai) tha: "Kjo është ajo që po kërkojmë". Andaj u kthyen nëpër gjurmët e veta." (el-Kehf, 60-64.)*

Koha dhe vendi ku udhëtoi Musai (a.s.), nuk dihet. Por është e qartë se këtu kemi një mesazh, një mësim ose një të vërtetë të fshehur. Këtu flitet edhe për besnikërinë e djaloshit që shoqëronte Musain (a.s.), edhe për fillimin e udhëtimit misterioz të Musait (a.s.). Pas këtij momenti, Musai (a.s.), do të bëjë një udhëtim interesant me dikë, që në popull njihet si Hidri, të cilit Allahu Teala i ka dhënë dije dhe urtësi.

Ubej b. Ka'b, transmeton se Profeti (a.s.), ka thënë: "Musai (a.s.), u ngrit në këmbë për të folur me popullin e tij. Populli e pyeti se kush është më i ditur prej njerëzve dhe ai u përgjigj, duke thënë: "Unë!". Për shkak se Musai (a.s.), nuk ia la Allahut këtë dije, Allahu e qortoi dhe i tha: "Një robi Im që ndodhet në vendin ku bashkohen dy dete, është më i ditur se ti." Musai (a.s.), pyet: "O Zoti im, si mund të takohem me të."

Allahu i thotë: "Merr me vete një peshk dhe fute në një çantë. Aty ku peshku do të humbë, aty e gjen edhe robin tim." (Buhari, Ilim/44 no: 122, Tefsir/18 no: 4726. MuslimFedail/170 no: 6163. Tirmizi, Tefsir/18 no: 3179.)

Siç tregohet edhe në një hadith tjetër, Musai (a.s.), e porositi djaloshin që ta njoftonte, kur peshku të ndahej prej tyre. Mirëpo, peshku filloi të përpëlitej kur ata ishin duke fjetur. Djali po ngurronte ta zgjonte Musain (a.s.) dhe peshku mori rrugën e tij për në det. Të nesërmen, kur Musai (a.s.), kërkoi torbën e ushqimeve, djaloshi e njoftoi për punën e peshkut. Atë moment, Musai (a.s.), e kuptoi se ai që po kërkonin, ndodhej në atë vend ku peshku u zhyt në det. (Buhari, Tefsir/18 no: 4726.)

Megjithëse në disa burime thuhet se djaloshi ishte Jushabin Nun, një prej nipërve të Jusufit (a.s.), apo djali i motrës së Musait (a.s.), ajo që ka rëndësi, nuk është identiteti i tij, por roli dhe puna e tij, që simbolizon besnikërinë.

Burimet thonë se ky djalosh i ka shërbyer Musait (a.s.), për shumë vite me radhë dhe ka mësuar shumë gjëra prej tij. Gjithashtu, shtojnë se pas vdekjes së Musait (a.s.), ky djalosh është bërë profeti dhe prijësi izraelitëve. Nëse informacioni që vjen prej këtyre burimeve është i vërtetë, kjo gradë i është dhënë, sepse ai ka qenë ndjekës dhe nxënësi i Musait (a.s.). Gjithashtu edhe si rezultat i bindjes dhe besnikërisë ndaj tij.

Mbase kur Musai (a.s.), i ka thënë, "eja të shkojmë", ai nuk ka kundërshtuar aspak. Nuk ka pyetur, "Ku është vendi në të cilin bashkohen dy dete dhe pse po shkojmë?". Madje, kur Musai (a.s.), ka thënë: "Nëse është nevoja, do të shkoj edhe më larg", ai nuk u ankua e të thoshte, "unë nuk vij", sepse ai ishte më se i sigurt se Musai (a.s.), po vepronte me vullnetin e Allahut Teala. Ai iu bind fjalëve të Musait (a.s.), duke marrë me vete torbën me ushqime dhe duke dalë për udhë me të.

Mbase ai e kishte kuptuar urtësinë, synimin dhe fundin e bukur të këtij udhëtimi, sepse njeriu që po ndiqte nuk ishte një njeri çfarëdo, por një profet, të cilit i kishte ardhur shpallje prej Allahut. Ai nuk ishte një aventurier, që vraponte pas aventurave, as një zbulues që dilte për zbulime dhe as një gjuetar thesare, që kishte dalë për të kërkuar thesare, por ishte një profet i lartë, i cili ishte dërguar për t'i ftuar njerëzit në rrugën e drejtë.

Këtu është e mundur të gjejmë sinqeritetin e besimit të një të riu, pastërtinë, bindjen dhe mundin e tij në rrugë

të Allahut. Duke u nisur nga kuptimi i fjalës "feta", pra, merrni kuptimin që dëshironi, i ri, trim, djalosh ose edhe shërbëtor, ndihmës dhe skllav. Në fund të fundit, të gjitha ato kuptime tregojnë edhe për rëndësinë e detyrës së tij, por edhe për sinqeritetin e tij në çuarjen në vend të asaj detyre.

Ai ishte feta, trim dhe i guximshëm. Me këtë shembull, u thuhet të rinjve tanë sot: Edhe ju bëhuni udhëtarë të rrugës së vërtetë. Edhe ju ndiqni rrugën e Profetit, që me shpallje i ftonte njerëzit në rrugën e drejtë. Edhe ju merrni përgjegjësi dhe përmbushini më së miri. Edhe ju bëhuni seriozë në punë, realistë në pretendime dhe të sinqertë në adhurimet tuaja. Ndërsa në shpresat tuaja, mbështetuni gjithmonë tek Allahu i Madhëruar.

## RINIA IDEALE

Kurani Kerim na jep shumë shembuj me të rinj dhe na tregon shumë skena të jetës së tyre, prej të cilave duhet të marrim mësim. Një nga këta, është edhe njëri nga bijtë e Ademit (a.s.), i pafajshmi i parë, që vritet nga një tjetër prej bijve të Ademit (a.s.).

### NJË PREJ BIJVE TË ADEMIT (A.S.)

Dy prej bijve të Ademit (a.s.), me qëllim që të afroreshin më tepër me Allahun, i kushtuan Atij nga një kurban. Mirëpo, vetëm kurban i njërit prej tyre u pranua, ndërsa i tjetrit u refuzua. Për këtë arsye, ai të cilit nuk i ishte pranuar kurban, papritur dhe pa asnjë arsye, i thotë tjetrit: "Patjetër që unë do të të vras ty". Ndërsa përgjigja e atij, të cilit i ishte pranuar kurban, ishte përgjigja e një besimtari të vërtetë dhe të sinqertë:

**"...Allahu pranon vetëm prej të devotshmit. Nëse ti ngre dorë të më vrasësh mua, unë nuk do ta ngre dorën që të të vras, sepse, në të vërtetë, unë i frikësohem Allahut, Zotit të gjithësisë."** (el-Maide, 27-28.)

Në këtë ndodhi, ndihet shumë ndikimi serioz dhe i rezikshëm i iblisit mbi dobësitë dhe ambiciet e njeriut. Kjo ngjarje, e cila ndodhi midis dy djemve të Ademit (a.s.), është fillimi i luftës midis dy poleve të kundërta dhe dy zgjedhjeve të kundërta, e cila është zvarritur dhe ka ardhur deri në ditët tona.

Këto dy pole të kundërta, janë ata që pranojnë dhe duan të jetojnë me parimet e Allahut, të cilat i dërgoi me anë të profetëve të Tij dhe ata që me mashtrimin e iblisit, mendimin e tyre e pranojnë si më të drejtin dhe duan të jetojnë siç ua ka ënda.





Këto dy pole të kundërta, janë ata që besojnë Allahun si Zotin e vetëm dhe që veprojnë sipas këtij besimi dhe ata që veprojnë sikur Allahu nuk ekziston fare ose ata që nuk i pëlqejnë kufijtë e hallallit dhe haramit, që ka vendosur Allahu, por guxojnë t'i vendosin vetë ata kufij. Në një farë kuptimi, kjo luftë bëhet midis atyre që mbajnë krahun e iblisit dhe atyre që mbajnë anën e Allahut.

Në këtë luftë, qëndrimi i atyre që janë në anën e Allahut, është: ftesa, udhëzimi, mëshira, afrimi, ruajtja, kujtesa, këshilla dhe puna për largimin e të tjerëve prej së keqes. Ndërsa qëndrimi i atyre që janë në anën e iblisit, është: hilja, mashtrimi, kërcënimi, mizoria, tirania, shtypja, terrori, shkelja e të drejtave, gënjeshtria, ambicia e verbër dhe abuzimi me fenë.

Një anë mundohet që të ndajë me drejtësi burimet e jetesës që ndodhen në tokë për njerëzit, të mos ia ngulin sytë pasurisë së tjetrit dhe të këshillojnë të mos jenë ziliqarë e të pangopur. Ndërsa ana tjetër i hedh pas krahëve të gjitha parimet e drejtësisë dhe përpiqet të zotërojë gjithçka, fuqinë dhe pushtetin.

Shihet qartë se djali i pafajshëm është munduar shumë të ndikojë tek vëllai i tij dhe ta bindë që të mos e bëjë atë veprim (vrasjen). Ai u mundua ta shuajë zjarrin e ambicies së tepërt dhe të zilisë që kishte pushuar shpirtin e vëllait të tij, duke i thënë: "Mos bëj kështu! Kjo gjë është në kundërshtim me devotshmërinë. Përndryshe do të marrësh përsipër edhe gjynahun tim edhe tëndin. Pastaj do të bëhesh prej mizorëve dhe do të përfundosh në Xhehenem", por nuk ia doli mbanë që ta bindte.

Në këtë shembull na prezantohen dy lloj të rinjsh. Njëri ishte dorëzuar plotësisht dhe me sinqeritet ndaj ligjeve të Allahut, që kishin ardhur me profetin e parë dhe jo dëshirave të tij. Ai i kishte pranuar parimet që kishin zbritur për bashkësinë e parë njerëzore dhe mendohej të jetonte me to, duke qëndruar larg ngatërresave, ambicies të tepërta, padrejtësisë dhe zilisë. Ndërsa tjetri, ishte një kryeneç që i kishte refuzuar këto parime, ishte bërë peng i egos së vet dhe ambicies të tij dhe ishte mashtruar me vesveset e iblisit.

Djali i pafajshëm bëri atë që i takonte dhe zgjodhi të vepronte me vetëdijen e përgjegjësisë ndaj Allahut. Ndërsa tjetri, bëri të njëjtën gjë që bëri edhe iblisi dhe derdhi gjakun e vëllait të tij. Ai nuk i njohu kufijtë e Allahut, por i kaloi ata dhe u bë prej të humburve. Më e keqja është se ky djalë i ri, ishte ai që filloi për herë të parë zakonet e keq të derdhjes së gjakut pa të drejtë që ka ardhur deri në ditët tona. Tashmë, që këtej e tutje, të gjithë vrasësit, të gjithë ambiciozët, të gjithë të pasionuarit mbas push-

titet me pa të drejtë dhe të gjithë ata, për të cilët pasuria është më e shtrenjtë se çdo gjë tjetër, do të marrin për shembull këtë djalë të ri, Kabilin.

Me këtë shembull, Kurani Kerim i bën thirrje të gjithë rinisë: "Bëhuni si djali i pafajshëm i Ademit (a.s.) dhe mos u bëni kurrë si djali i tij vrasës."

### TË RINJTË E SHPELLËS

Në Kuran, gjejmë edhe ndodhinë e të rinjve të shpellës, të cilët me guxim dhe trimëri kundërshtuan mbretin idhujtar të kohës ku jetonin dhe i kthyen shpinën fesë pagane të të parëve të tyre. Për ta, Kurani përdor fjalën "الْفِتْنَةُ /el-feta" dhe i nderon ata, duke i thirrur: "Ashab-i Kehf dhe Ashab-i Rakim". Kurani i bën ata të pavdekshëm, duke na sjellë këtë ndodhi.

Të rinjtë e shpellës, janë shembull i veçantë, i përsosur dhe interesant. Sipas disa burimeve, ata ishin princa në pallatin mbretëror. Mbase kishin baballarë të pasur, të fuqishëm dhe me autoritet. Ata do të kishin trashëguar pasurinë e baballarëve të tyre dhe do të zotëronin çdo gjë që ua kishte ënda. Mbase jetonin të zhytur në luks e rehati. Mirëpo ata, ashtu si edhe shumë udhëtarë të tjerë të së vërtetës, nuk zgjodhën anën luksoze të kësaj bote, e cila i përshtatej egos së tyre, por me anë të dritës hyjnore që lindi në zemrat e tyre, zgjodhën besimin dhe mënyrën e jetesës, e cila do t'u bënte dobi pas vdekjes dhe do t'i çonte tek Allahu. Ata e kuptuan se jeta që bënte shoqëria ku jetonin dhe feja idhujtare që ndiqnin prindërit e tyre, nuk ishin të sakta. Prandaj dhe iu dorëzuan Zotit të gjithësisë, Allahut Teala. Ata hodhën mënjanë mundësinë për të qenë të pasur e të fuqishëm dhe, duke marrë përsipër çdo lloj rreziku, deklaruan besimin e tyre tek Allahu.

Me vetëdijen se rinia e tyre dhe çdo gjë që zotëronin ishte e përkohshme dhe se një ditë çdo gjë do të merrte fund, ata u lidhën pas një fuqie, e cila është e përjetshme. Allahu Teala u kënaq me zgjedhjen e tyre të vështirë por të sinqertë dhe ua mundësoi të strehoheshin në një shpellë. Pastaj bëri që ata të flinin të fshehur në atë shpellë për 309 vjet. Me këtë, Allahu desh të tregonte edhe fuqinë e Tij, edhe se sa fitim i madh është zgjedhja e një rruge për hir të Allahut.

Ja rinia, ja të rinjtë... Shembuj të përsosur... Qëndrime që të mahnitin... Përfundime që të bëjnë t'i kesh zili...

Të flesh në shpellë 309 vjet pa vdekur dhe të jetosh përjetë në zemrat e myslimanëve si dëshmitari më i fuqishëm i së vërtetës...

Ky përfundim i shkëlqyer, është shpërblim për ta, sepse pavarësisht gjendjes në të cilën ndodheshin, ata nuk zgjo-

*Në Kuran, gjejmë edhe ndodhinë e të rinjve të shpellës, të cilët me guxim dhe trimëri kundërshtuan mbretin idhujtar të kohës ku jetonin dhe i kthyen shpinën fesë pagane të të parëve të tyre.*

“Në ditën e kijametit, kur nuk do të ketë hije tjetër përveç hijes së arshit, Allahu Teala, do të strehojë shtatë grupe njerëzish nën hijen e tij (arshit): Prijësin e drejtë. Të riun që është i devotshëm ndaj Allahut dhe bën një jetë të pastër. Myslimanin, zemra e të cilit është e lidhur me xhaminë. Njerëzit që bashkohen dhe ndahen vetëm për hir të Allahut. Njeriun që i përmbahet tundimit të ftesës morale të një gruaje me pozitë, duke i thënë: “Unë kam frikë Allahun”. Atë që jep sadaka, aq fshehtas, saqë dora e majtë nuk e di se çka dhënë e djathta. Atë që e përmend Allahun dhe derdh lot kur është në vetmi.”

”

dhën një besim dhe një mënyrë jetese të diktuar nga të tjerët, por zgjodhën të adhuronin Zotin e botëve, Allahun e Madhëruar. Ky përfundim, është shpërblimi që morën, për shkak se nuk dëgjuan zërin e egos, por të zemrës, nuk zgjodhën të përkohshmen, por të përjetshmen, nuk zgjodhën munkerin (të keqen), por ma'rufin “të mirën”.

Njëri prej shkaqeve, që këta të rinj u mbajtën për një kohë kaq të gjatë në atë shpellë, mund të jetë edhe ky: Zgjo-huni o të rinj! Sot jeni të rinj, të fortë dhe të mbushur me energji. Por kjo është e përkohshme. Ashtu si çdo gjë është e përkohshme, edhe periudha e rinisë suaj është e tillë.

Ata u vunë në gjumë për 309 vjet dhe e gjithë rinia u kaloi në atë shpellë, në një gjumë të thellë. Por besimi i tyre, guximi dhe punët e tyre të sinqerta ngelën si trashëgim dhe shembull për të gjithë brezat e mëvonshëm. Ashab-i Kehf do të qëndrojnë përpara të rinjve deri në ditën e kiametit, si shembull për zgjedhjen që duhet të bëjnë në jetë.

### PROFETI, BIRI I PROFETIT

Kurani ka bërë shembull për të gjithë rininë deri në ditën e kiametit edhe Ismailin (a.s.), që ishte në lule të rinisë.

**“Kur fëmija u rrit aq sa ta ndihmonte në punë, Ibrahim i tha: “O djali im, kam parë ëndërr se duhet të të flijoj. Çfarë mendon ti?” - I biri i tha: “O ati im, vepra ashtu siç je urdhëruar! Dashtë Allahu, unë do të jem i durueshëm!” Pasi iu nënshtruan që të dy urdhrit, (Ibrahim) e vuri (Ismailin) me ballë përtokë. Ne e thirrëm: “O Ibrahim, ti e përmbushe ëndrrën.” Vërtet, Ne kështu i shpërblejmë vepërmirët! Kjo, me të vërtetë ka qenë një sprovë e qartë!”** (es-Saffat, 102-106.)

Ismaili (a.s.), e kaloi me sukses këtë sprovë që mund të përfundonte me vdekje. E zgjati fytyrën e dorëzuar dhe u kënaq me urdhrin e Allahut. Jetën Ai ia kishte dhënë dhe Ai do t'ia merrte. Herët apo vonë, sot apo nesër... Çfarë ndryshimi kishte!? Ai e dinte shumë mirë se nuk mund t'i shpëtonte vdekjes, sado i fortë të ishte. Ai i besoi ashtu siç duhet caktimit të Allahut. Ndërsa prova e këtij besimi, ishte dhënia si dhuratë e gjësë më të shtrenjtë, jetës, për t'u afruar tek dera e të Lartmadhëruarit. Dhe ai ishte gati për këtë.

Ashtu siç e kuptojmë edhe nga ajetet, shpërblimin e këtij veprimi e mori të shumëfishtë. Allahu u dha nderin e ndërtimit të shtëpisë së parë në faqen e dheut për adhurimin e Tij, Qaben, të cilën e ndërtoi së bashku me babanë e tij. Dhe të dy, u bënë prej njerëzve që do të kujtohen për mirësi deri në ditën e kijametit. Ata kujtohen sa herë që pihet prej ujit të zemzemit ose kur bëhet fjalë për të, sepse zemzemi ishte një dhuratë për të dhe nënën e tij të nderuar. Por më e rëndësishmja ishte se Ismailit (a.s.), iu dha nderi të ishte prej gjyshërve të Profetit tonë të dashur, Muhamedit (a.s.). Ja pra, kështu shpërblehen ata që bëjnë mirësi.



Ismaili (a.s.), qëndron përpara të rinjve si një shembull i gjallë dhe i përsosur. Ashtu si edhe shumë të tjerë!

### **TË RINJTË QË MERITOJNË HIJEN E ARSHIT**

Profeti ynë (a.s.), ka thënë:

*“Në ditën e kijametit, kur nuk do të ketë hije tjetër përveç hijes së arshit, Allahu Teala, do të strehojë shtatë grupe njerëzish nën hijen e tij (arshit): Prijësin e drejtë. Të riun që është i devotshëm ndaj Allahut dhe bën një jetë të pastër. Myslimanin, zemra e të cilit është e lidhur me xhaminë. Njerëzit që bashkohen dhe ndahen vetëm për hir të Allahut. Njeriun që i përmbahet tundimit të ftesës amorale të një gruaje me pozitë, duke i thënë: “Unë kam frikë Allahun”. Atë që jep sadaka, aq fshehtas, sa që dora e majtë nuk e di se çka dhënë e djathta. Atë që e përmend Allahun dhe derdh lot kur është në vetmi.” (Buhari, Ezan/36, Zekat/16, Rikak/24. Muslim, Zekat/91. Tirmidhi, Zuhd/53; Nesai, Kudat/2.)*

Ja pra, një i ri shembullor, një i ri trim: I riu që është i devotshëm ndaj Allahut dhe që bën jetë të pastër. Ai që i kalon vitet e rinisë brenda kufijve që ka caktuar feja të cilën e beson, që e ruan veten e tij nga kundërshtimi i urdhrave të Allahut, që i bën ballë ndikimit të dëshirave, epsheve dhe pasioneve, të cilat janë të vështira për t'u frenuar dhe që kapet fort pas besimit dhe adhurimit të Allahut... Padyshim se qëndrimi i një njeriu të tillë, është rezultat i respektit dhe përgjegjësisë që ndjen ai ndaj Zotit të vet. T'u bindesh urdhrave të Allahut dhe të largohesh prej gjynaheve, të çon drejt një fitoreje të madhe. Dhe veçanërisht, nëse kjo është arritur gjatë viteve të rinisë.

I riu, zemra e të cilit është e lidhur me xhaminë, është një i ri që e do xhaminë, ndihmon në ndërtimin e xhamive, kontribuon në çdo aspekt të jetës së xhamive dhe është pjesë e xhematit të përhershëm të xhamisë.

I riu që refuzon ftesën amorale të një gruaje me pozitë, duke i thënë: “U kam frikë Allahun”, tregon një trimëri të vërtetë. Ai po vepron në kundërshtim me dëshirën e madhe të egos dhe po e refuzon këtë ftesë joshëse për egon e tij, duke thënë: “Unë kam frikë nga Allahu dhe nga kalimi i kufijve që ka vendosur Ai”.

Lum për ata që kanë një devotshmëri të tillë!..

Kurani Kerim i përgëzon me mirësi ata që kanë frikë Allahun dhe veprojnë me respekt ndaj Tij. Një nga këto përgëzime shprehet qartë edhe në këtë ajet fisnik:

**“...Atij që i frikësohet Allahut, Ai do t'ia lehtësojë çësh-**

**tjen.” (et-Talak, 4)**

Një shembull në lidhje me lehtësimin e çështjes, është edhe gjendja e këtyre personave për të cilët na tregon Profeti (a.s.):

“Një herë, tre persona kishin dalë për udhë. Kur erdhi mbrëmja, ata u futën në një shpellë për të kaluar natën. Sapo hynë në shpellë, nga mali ra një gur i madh dhe zuri hyrjen e shpellës. Të shqetësuar, filluan të mendonin për një rrugëzgjdhje. Njëri prej tyre thotë:

- Nuk kemi rrugëzgjdhje tjetër, përveçse t'i lutemi dhe t'i përgjrohemi Allahut, duke përmendur punët e mira që kemi bërë për hir të Tij.

Për këtë arsye, çdonjëri prej tyre filloi të kërkonte ndihmë prej Allahut, duke përmendur nga një punë për të cilën shpresonte se i ishte pranuar. Njëri prej tyre fillon e lutet, duke thënë:

- O Zot! Unë kisha një vajzë xhaxhai dhe e doja më shumë se të gjithë. Unë desha të kryeja marrëdhënie intime me të, por ajo nuk e pranoi propozimin tim. Më në fund, në një vit kur ra zia e bukës, vajza e xhaxhait erdhi tek unë për të kërkuar ndihmë. Unë i propozova njëqind e njëzet dinarë, nëse ajo do të kryente marrëdhënie me mua. Ajo pranoi dhe sapo u bëra gati të shkoja me të, ajo më tha:

- Ki frikë Allahun! Mos përfito prej meje në mënyrë të pamoralshme!

Megjithëse e doja më shumë se gjithçka, pasi dëgjova këto fjalë, hoqa dorë prej saj dhe nuk i mora as paratë që i dhashë. O Zoti im! Nëse e kam bërë këtë punë për të fituar kënaqësinë tënde, na shpëto prej gjendjes në të cilën ndodhemi!

Më në fund, të treve iu pranuan lutjet dhe ata shpëtuan prej shpellës. (Buhari, Ixhare, 12. ; Muslim, Dhikir, 27 no: 2743.)

Të shpresojmë që të rinjtë myslimanë të kohës sonë, të veprojnë sipas këshillave të Kuranit, të marrin shembull botëkuptimin e devotshmërisë së Profetit (a.s.) dhe të mundohen të bëhen si të rinjtë e devotshëm, për të cilët folëm më sipër.

Nuk duhet të harrojmë edhe faktin se ata që i besuan më parë Profetit (a.s.) dhe e ndihmuan atë në misionin e tij, ishin të rinjtë. Më vonë, këta të rinj u bënë figurat më të ndritura të historisë islame dhe gëzuan ndihmën e Allahut. Ata u nderuan edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër.

*Të shpresojmë që të rinjtë myslimanë të kohës sonë, të veprojnë sipas këshillave të Kuranit, të marrin shembull botëkuptimin e devotshmërisë së Profetit (a.s.) dhe të mundohen të bëhen si të rinjtë, për të cilët folëm më sipër.*



# GJENERATA që po RRITET

*Nuredin Nazarko*

Raca njerëzore nuk bën përjashtim nga ligji natyror i vazhdimësisë së llojit nëpërmjet riprodhimit. Në gjithë këtë proces jeta i lë vendin vdekjes, shuarjes së një gjenerate dhe lindjes së një gjenerate të re, e cila nuk mund t'i shmanget asaj ndaj së cilës kanë qenë të kthyer paraardhësit e saj, pra nuk mund t'i shmanget ciklit jetësor. Çdo gjeneratë e re përgatitet, që një ditë të zëvendësojë gjeneratën e vjetër, e cila dikur kishte qenë e re. Kësisoj edhe gjenerata, e cila po rritet ndër duart tona, një ditë do të jetë zëvendësuesja e së vjetrës. Çështja nuk shtrohet vetëm në rrafshin biologjik të zëvendësimit fizik të gjeneratave dhe tipareve të tyre fizike, por çështja shtrohet se si po rritet gjenerata e re? Këtu nuk ndërmendim domosdoshmërisht vetëm impaktin e kushteve sociale, edhe pse ai ka pjesën e vet në modelimin e gjeneratës së re dhe do të ishte e padrejtë nga ana jonë, në qoftë se do të mohonim impaktin e këtij elementi në gatimin e gjeneratës së re. Gjithsesi, kur shtrojmë pyetjen se si po rritet gjenerata e re, shqetësimi dhe vëmendja dashur pa dashur drejtohet tek mundësitë dhe sasia e të mirave materiale që zotëron individ. Shqetësimi dhe vëmendja jonë në këtë hapësirë, pyetjes se si po rritet gjenerata e re, e përkthen në pyetjen se mbi çfarë mendësish dhe formash të menduari, në qoftë se ka, po e orienton jetën gjenerata e re, mbi çfarë binarësh lëviz qenia njerëzore e gjeneratës së re? Kur sipërmarrim trajtimin e mendësive, mbi të cilat lëviz gjenerata e re, nuk ndërmendim të vendosim shenjën e egalitarizmit, por sipërmarrim trajtimin e tendencës ndaj domenit sundues të këtyre mendësive, tendencë që përthithet prej shumicës. Gjeneratës së re gjatë rritjes së saj do t'i duhet të kalojë nëpër dyert e institucioneve arsimore, para se ajo të përballë me problematika të

tjera të jetës. Në procesin e formimit të mendësive të saj luajnë rol të rëndësishëm masmedia, institucionet arsimore, familja, traditat dhe zakonet, madje roli i këtyre të fundit shpeshherë mbetet ngritja e flamurit të bardhë, përballë impaktit të fuqishëm të ideve që lançohen nëpërmjet masmedias, ide të cilat ftojnë në implementimin e të jetuarit i lirë, i pavarur nga asnjë autoritet, sepse vetëm kështu njeriu mund të shijojë lumturinë mbi sipërfaqen e kësaj toke. Nuk mund t'i kundërvihemi natyrës njerëzore që nuk resht së kërkuari lumturinë, por as nuk mund të mos shtrojmë pyetjen se çfarë është lumturia dhe a mund të arrihet ajo duke i çelur udhë plotësimit të utilitariteteve, pa asnjë shenjim se çfarë duhet plotësuar e çfarë jo, se cilat duhen pranuar e cilat duhen refuzuar?

Duke shkuar akoma më tej, ne sërish pyesim se kush e përcakton se çfarë e bën njeriun të lumtur dhe çfarë jo? Gjenerata e re, e ngashnjyer dhe ndezulluar nga fakti që është një gjeneratë "e lirë" dhe mund ta rregullojë jetën e saj ashtu siç ajo dëshiron, tashmë beson se nuk ka asnjë autoritet që të përcaktojë se çfarë në të vërtetë e bën atë të lumtur ose jo, përtej autoritetit vetjak. Kësisoj, gjenerata e re beson se lumturia e çdokujt varet vetëm nga vetë individ dhe është individ ai që përzgjedh se çfarë dëshirash duhet apo nuk duhet të plotësojë. Njeriu është një qenie që nuk mund t'i shmangë dëshirat dhe pasionet, sikundërse predikon budizmi, por as t'i shtypë ato njëherë e përgjithmonë, sikundërse predikonte krishtërimi. Qenia njerëzore duhet t'i plotësojë nevojat dhe dëshirat e saj, sepse nuk mund të veprojë ndryshe, por qenia njerëzore është pajisur me aftësinë për të diferencuar plotësimin e dëshirave, në përputhje me një sistem



referimi vlerash, i cili as nuk vjen nga bota njerëzore, por as nuk mund të përfundet nën peshën e dëshirave dhe pasioneve të saj. Në përpjekje për të diferencuar plotësimin e utilitetit, sipas sistemit të referimit të vlerave që sipërpërmendëm, nuk do as mend e as kalem, që njeriut i duhet të luftojë në brendësinë e vet për të disiplinuar dhe kanalizuar dëshirat dhe pasionet, sipas këtij sistemi referimi. E kjo përpjekje natyrisht që kërkon shpenzim energjish dhe mbi të gjitha durim, përndryshe drama dhe dilemat që përjeton njeriu për t'u ndjerë i vetërealizuar si qenie njerëzore, nuk do të kishin kuptim. Kjo sacrificë, në plotëkuptimin e fjalës, nuk do të merrte asnjë lloj kuptimi, në qoftë se qenia njerëzore nuk do të udhëhiqej nga një qëllim i lartë dhe fisnik, pasi çdo vepër varet kryekëput nga qëllimi për të cilin ajo jetësohet, në të kundërt do të ishte marrëzi, çmenduri që të sakrifkosh në emër të parimeve të epërme aty ku gëlon pragmatizmi dhe interesi materialistik në funksion të de-vizës *një jetë kemi* dhe asgjë nuk na ndalon ta shijojmë ashtu siç duam ne. E përse të mos veprojmë kësaj, kur fundi ynë është errësira e përhershme? E mpleksur pikërisht me këtë mendësi, gjenerata e re nuk i ka fort për zemër sflitjet dhe sakrificat për të realizuar diferencimin e plotësimin të dëshirave dhe pasioneve, madje ata të cilët veprojnë të kundërtën, mund edhe të etiketohen si kur-turisës të pandreqshëm. Gjenerata e re ndihet e mpirë apo kërkon të ndihet e tillë përballë sakrificës për diferencim, por aktive në përplotësimin e njëdimensionalitetit, sepse sakrificat marrin kuptim vetëm në qoftë se njeriu beson në realizimin e një qëllimi të lartë dhe fisnik. Por a e ka gjenerata e re këtë qëllim të lartë dhe fisnik?

Duke pasur qëllimin e saj më të lartë realizimin e lumturisë mbi sipërfaqen e tokës, gjë që nuk e konsiderojmë të pamundur, por në mënyrën e saj, gjenerata e re është një gjeneratë tek e cila zë vend vetëm toka dhe jo qielli, zë vend pavetëdija ndaj realitetit të ekzistencës, mosmeditimi mbi realitetin në të cilin jeton, shpërfillja ndaj gjithësa "i pengon" realizimin e lumturisë përmbi tokë dhe si rrjedhojë edhe mohimi i mendimit, sikundërse e përmend edhe Haidegeri. Por çfarë do të thotë të mendosh që të kuptojmë se çfarë

do të thotë të mohosh mendimin? Sipas Haidegerit, ne shtrojmë pyetjen *çdo të thotë të mendosh*, pikërisht sepse nuk mendojmë origjinën thelbësore të qenies së Qenies. (Leksione dhe Konferenca, Tiranë 2003: 113.) Kësisoj, mohimi i mendimit rrjedh në mohimin e Qenies dhe nuk mund të mohojnë atë që nuk është. Zaten, prej këtu zanafillon edhe mendësia e gjeneratës së re, përmbi të cilën përipiqet me mish e me thonj, të ndërtojë lumturinë dhe jo të banojë në të. Manifestimet e kësaj mendësie shtohen çdo ditë e më tepër. Ja si e përshkruan pena platoniane të jetuarit sipas kësaj mendësie: "Njerëzit që nuk e njohin urtinë dhe virtytin, që janë vazhdimisht në mes gostish dhe kënaqësish të këtij lloji, zbresin, me sa duket, në zonën e ulët, për t'u ngjitur më pas deri në zonën e mesit dhe tërë jetës nuk pushojnë së enduri sa te njëra, te tjetra; ata nuk e ka-

*"Njerëzit që nuk e njohin urtinë dhe virtytin, që janë vazhdimisht në mes gostish dhe kënaqësish të këtij lloji, zbresin, me sa duket, në zonën e ulët, për t'u ngjitur më pas deri në zonën e mesit dhe tërë jetës nuk pushojnë së enduri sa te njëra, te tjetra; ata nuk e kapërcejnë këtë limit;*

përcejnë këtë limit; ata nuk i kanë ngritur kurrë sytë lart dhe as i kanë drejtuar kurrë hapat e tyre drejt lartësisë së vërtetë; ata kurrë nuk kanë qenë realisht të mbushur me qenien dhe kurrë nuk kanë shijuar kënaqësi të qëndrueshme dhe të kulluara, por duke parë kurdoherë poshtë, ashtu siç bëjnë kafshët, përherë të kthyer nga toka dhe trapeza, ata shqepen me të ngrëna, fëlliqin njëri-tjetrin dhe duke u hëngër midis tyre se kush të marrë më shumë nga këto kënaqësi, turren, përplasen dhe vriten midis tyre me brirët dhe thundrat prej hekuri, vetëm për të plotësuar lakminë e tyre të pangopur dhe tërë kjo,

mbasi ata nuk përdorin ushqimet e vërteta dhe nuk e mbushin pjesën e vetes së tyre që ekziston realisht dhe që mund të ruajë ushqimet... Dhe nuk ka si ndodh ndryshe që ata nuk do të kenë veçse kënaqësi të përziera me vuajtje, fantazma të kënaqësisë së vërtetë, skica që nuk marrin ngjyrim, veçse kur i vë kënaqësitë dhe vuajtjet njëri mbi tjetrin për t'i përforcuar kësaj të dyja; që këndej rrjedhin dhe dashuritë e furishme, me të cilat ndizen njerëzit e pamend për njëri - tjetrin dhe për të cilat luftojnë midis tyre..." (Republika, Tiranë 1999: 373-374.)

Të përipiqesh të ndërtohet lumturinë, në përpjekje për të mohuar mendimin, a mund të jetë një realitet apo një fanitje, vegim, mirazh që kërcen e hidhet nga humbësit e shtjellave të humnerave të fundbotshme?



# Trishtimi shqiptar

## në vargjet e një poeti

Gëzim Puka

Kur njihesh me krijimtarinë poetike të Vilson Blloshmit, mund të të ndërmendet fjalimi i shkrimtarit Ismail Kadare, me rastin e marrjes së çmimit të madh spanjoll "Princi i Asturias". Po ju citoj disa rreshta nga ky fjalim: "Mendimi se letërsia varet nga jeta është gati i zyrtarizuar planetarisht. [...]Ka shumë dallime midis tyre, por ka një dallim kolosal që qëndron mbi gjithë të tjerat. Dallimi është ky: ndërsa në konfliktin e saj me artin bota reale qëllon që acarohet aq fort, saqë turret ta shkatërrojë artin, në asnjë rast, e përsëris, në asnjë rast letërsia dhe arti nuk e sulmojnë jetën reale, për ta dëmtuar, por, përkundrazi, luftojnë që ta bëjnë më të bukur, më të jetueshme. Ky është dallimi absolut midis tyre. Dhe në këtë rast, një dallim i tillë nuk është gjë tjetër veçse konfirmimi më sublim i pavarësisë së vërtetë të artit."<sup>1</sup>

Në shkrimin hyrës tek "Vepra letrare 1" e Vilson Blloshmit, studiuesi Sadik Bejko paraqet për lexuesin mendime të poetit, të cilat vijnë direkt nga dosja e tij hetimore. Me të drejtë Bejko shprehet: "Ato, meqë janë dhënë në hetuesi, duhet t'i marrim me rezervë, por prapë edhe kështu kanë vlerë dhe duhen bërë të njohura"<sup>2</sup>. Ky mendim përforcohet më tepër, kur lexon poezitë që na kanë mbërritur nga V. Blloshmi. Në deponimet e tij në hetuesi, poeti përpiket të justifikojë krijimtarinë e tij, sikur ajo të ishte diçka krejt personale, që nuk do të kishte asnjë takim me lexuesin. Trishtimin në krijimet e tij, ai e shpjegon si krejtësisht individual. Po përmendim disa fragmente: "...unë kam shkruar një poezi që ia kushtoj vetes sime. Aty kam shprehur mërzitjen time dhe e quaj veten jetim.[...] Në vitin 1973 kam bërë një poezi tjetër mbi veten time. Atëherë kam qenë në gjend-

je ankthi dhe kam shkruar në bllok kështu: "Një ankth i llahtarshëm, ankth gjumi. Zgjuar tmerr. Më bëhet se nuk do të vdes kurrë. Medet sikur njeriu të jetonte përjetësisht, sikur t'i ktheja së prapthi vitet e mia, por jo për të rënë sërishmi në djep por në arkivol". Në atë kohë unë punoja druvar në Stravaj, isha i lodhur, i mërzitur, më dhimbte stomaku. Siç e kam thënë, unë kam qenë pesimist dhe e kam pasur në natyrë trishtimin".<sup>3</sup>

Lexuesi dhe aq më shumë studiuesi i letërsisë, gjen tek poeti Vilson Blloshmi të dy tipat e poetëve, si poetin objektiv, ashtu edhe atë subjektiv. Në disa krijime të tij, ai e ka mënjanuar veten, për të shprehur botën e trishtë që e rrethon, duke fshirë personalitetin e tij. Në disa krijime të tjera ka prirjen për të dhënë një autoportret, për t'u rrëfyer, për të shprehur trishtimin vetjak. Por edhe në rastin e poetit subjektiv, nuk duhet e nuk mund të mos përfillim dallimin midis një pohimi me karakter autobiografik dhe përdorimit të po atij motivi në një vepër artistike. Edhe pse vargjet e Blloshmit përmbajnë elemente të padiskutueshme biografike, ato i nënshtrohen në vepër një ristrukturimi dhe transformimi, nga i cili humbasin kuptimin ngushtësisht personal dhe bëhen thjesht një material konkret njerëzor, bëhen elemente përbërëse të veprës. Vepra poetike e Blloshmit më tepër mishëron ëndrrën, sesa jetën e tij reale. Trishtimin vetjak, por edhe atë shoqëror ai e përjeton në mënyrë artistike. Sadik Bejko shprehet: "Jeta e tij dhe poezia e tij shkrihen në njëra-tjetrën. Poezia kështu ka peshën e jetës së tij, ka çmimin e kohës së tij të ekzekutuar nga tirania. Ai nuk e tradhëtoi asnjëherë: as jetën, as letërsinë e tij".<sup>4</sup>

1. Shih: "Kadare, në ditën e marrjes së çmimit "Princi i Asturias": "P - varësia e letërsisë, e vështirë.", gazeta c. com.

2. Shih: "Poeti që e pagoi me peshën e jetës artin dhe bindjet e tij" parathënie nga Sadik Bejko.

Blloshmi, Vilson: *Vepra 1*, Botimet "Almera", Tiranë, 2008, f. 50.

3. Po aty, f. 53.

4. Shih: "Poeti që e pagoi me peshën e jetës artin dhe bindjet e tij" parathënie nga Sadik Bejko.

Blloshmi, Vilson: *Vepra 1*, Botimet "Almera", Tiranë, 2008, f. 56.



Në leximin tonë poeti e përjetoi jetën e tij në mënyrë artistike. Ai e pa atë si material letrar dhe ngjarjet jetësore u shpalesën përpara tij në formën që i japin traditat dhe shprehjet letrare. Poezia e Blloshmit është ajo që është: me lot, me trishtim, me brenga. Këto autori i pohon edhe në hetuesi. Ajo që autori nuk e pohon gjatë hetimit të tij për letërsinë, por që e përligjin vargjet e tij, është se bashkë me lotët, trishtimin dhe brengat e tij, janë edhe ato të mbarë shqiptarëve. *"Artisti shpreh të vërtetën dhe, doemos, edhe të vërtetat historike e shoqërore. Veprat e artit mbesin si dokumente, sepse ato janë monumente"*<sup>5</sup>.

Desha ta ndaj me lexuesin e kësaj krijimtarie këtë lidhje mendimi, me bindjen se ligjërimi poetik tek poezia "Saharaja" e paraqet përballjen e saj me botën e njëmendësisë së trishtë diktatoriale. "Saharaja", si tekst poetik apo si art i fjalës, ka përballë kontekstin më të trishtë referencial, Shqipërinë e diktaturës komuniste apo edhe vetë metodën e realizmit socialist që funksionalizohet nga kjo diktaturë. Në librin e saj "Letërsi e painterpretuar", akademikja Floresha Dado thekson: *"Në raportin: model/modelim artistik, ekziston një nga pikat kyçe teorike mbi gjykimin e letërsisë sonë të realizmit socialist. Modelimi ka sfiduar modelin! Modeli është transformuar, jo sipas parimeve të brendshme të letërsisë, por sipas një procesi të deformuar, jashtëlogjik të modelimit. Modelimi është në shumicën e rasteve, mashtrim i modelit"*<sup>6</sup>.

Teksti poetik i Vilson Blloshmit nuk tenton të bëjë asnjë lloj modelimi të modelit dhe aq më pak të mashtrorje. Me letërsinë e tij ai kërkon të prekë sferën e lirisë. Titulli i kësaj poezie me një sens të fortë simbolik, na premtan të dhëna rreth domethënies së saj. Në qoftë se poeti nuk do ta kishte titulluar "Saharaja", nuk do të ishim në gjendje të kuptonim zërin e trishtë që vjen nga poezia. Aspektet që spikasin në tekstin e Blloshmit i përkasin si fushës së shënjeshtës (dmth të shprehjes), ashtu edhe fushës së domethënies (d.m.th. të përmbajtjes). Kjo poezi dallon për tingëllimën dhe ndjeshmërinë e saj. E shkruar në vargje, në të cilat shprehet një domethënie thelbësore objektivist e vlefshme, që është *trishtimi i jetës shqiptare*, poezia ofron shumëkuptimësi për çdo lexues që mund të "gërmojë" të tjera domethënie, sipas kulturës dhe përgjegjësisë

5. Wellek, René; Austin, Warren: *Teoria e letërsisë*, Shtëpia Botuese "Onufri", Tiranë, 2007, f. 95.

6. Dado, Floresha: *Letërsi e painterpretuar*, Shtëpia Botuese "Bota shqiptare", Tiranë, 2010, f. 127.

së tij. Me një varg të matur njëmbëdhjetërokësh, me thekse ritmike në rrokjet teke, me një strofë katërshe dhe me rimë të alternuar sipas skemës ABAB, poeti si strategji tekstuale është i mbingopur me trishtim në këtë hapësirë të mbyllur, i rënduar nga vetmia, duket sikur humbet brenda një entiteti pavetor (impersonal), të papërcaktuar, pa hapësirë e pa kohë. Ai është dikush midis të tjerëve, mjafton të vërehen format pavetore dhe përdorimi i vetës së parë të shumës; *"Thonë se dhe me natën s'shkon mirë"*, *"Por se thonë në botë është stisur"*, *"Kur ne mallkohemi mes nesh"*. Trishtimi shqiptar ka fizionominë e një peizazhi të shkretëtuar si Saharaja: *"Saharaja shkëmb e rërë e gurë"*, të një peizazhi armiqësor: *"Saharaja nuk ka miq e shokë, Saharaja nuk ka bijë, as bir. Fjalë e dashuri e njerëz s'ka"*. Poeti është i tensionuar të dëgjojë, por *"Saharaja s'ka këngë të këndojë"*, *"Saharaja s'ka as lot të qajë"*.

Në qoftë se do të procedohej me dekodifikimin e tekstit duke perifrastuar ose rindërtuar togfjalësha apo fjali me një rend tjetër sintaksor, d.m.th. duke kaluar nga defamiljarizimi i gjuhës poetike në automatizim gjuhësor, thënë ndryshe zëvendësimin e fjalëve dhe rendit të tyre poetik me fjalë të përdorimit të përditshëm, do të dilnin kuptimet e fshehura të poezisë.

*Saharaja, larg është Saharaja,  
Saharaja shkëmb e rërë e gurë  
Që ka shok veç emrin e saja  
Dhe ngaqë s'sheh ëndrra, s' sheh as drurë"*<sup>7</sup>

Shqipëria, sa pranë është trishtimi  
Trishtimi shqiptar, i madh, i pafund, i fortë  
I vetëm me vetveten shqiptari  
I pashpresë dhe pa të ardhme.

E bëmë këtë zëvendësim të fjalëve të kësaj poezie, për të vënë në dukje se të kuptuarit e kuptimit të poezisë së Blloshmit, lidhet me të dy funksionet e gjuhës së saj. Gjuha e poezisë së këtij autori, e parë në funksion simbolik, mund të jetë poezi e një kuptimësie të thellë ose siç shprehet studiuesi Bejko: *"E mbajtur në plan simbolik, po aq sa një meditim mbi botën dhe mbi jetën në tërësi, ajo mund të merret dhe si jehonë e një gjendjeje të vështirë subjektive të vetë poetit"*<sup>8</sup>.

Mendojmë se funksioni parësor i gjuhës së poezisë së Blloshmit është ai emotiv. Autori i përdor fjalët për

7. Blloshmi, Vilson: *Vepra 1*, Botimet "Almera", Tiranë, 2008, f. 85.

8. Shih: "Poeti që e pagoi me peshën e jetës artin dhe bindjet e tij" parathënie nga Sadik Bejko.

Blloshmi, Vilson: *Vepra 1*, Botimet "Almera", Tiranë, 2008, f. 60.

të krijuar apo më mirë, siç shprehet Tomas Elioti, "për të shpëtuar nga ndjenjat"<sup>9</sup>.

*"Dhe koha shkon,  
Dhe bota ikën,  
Dhe ne ecim,  
Dhe qeshim kur qan jeta,  
Dhe kur qesh varri...  
Vdesim...!"<sup>10</sup>*

Mund të themi se kjo poezi lind si nevojë për një çlirim të trishtimit dhe të brengave, qoftë të autorit, qoftë të shqiptarëve. Theksimi i referentit tematik, *trish-timi shqiptar i kohës*, si dhe aftësia që ka teksti poetik për të rikrijuar përmes tij të gjitha impulset autoriale, i bëjnë këto vargje edhe më shumë universale, pa rru-dhur aspak thelbin e tyre filozofik. Vilson Blloshmi nuk është një poet vetëm i personales. Poezia e tij e mirë i objektivizon ndjenjat, ajo është e lidhur ngushtësisht me mendimin. Lexojmë vargjet:

*"Jetën e fjalës e justifikon  
Mendimi i tiposur në të."<sup>11</sup>*

Poezitë më të ndjera të autorit janë pikërisht ato pa titull. Ndërsa lexoja njëren prej tyre m'u ndërmend një parrullë që u stereotipizua në kohën e diktaturës.

Po citojmë poezinë:

*"Dhe mua më duket se vrapoj  
Me tmerr nëpër tubin e grykës së topit!  
Pak sekonda dhe po nëpër këtë grykë  
Do të kalojë predha e llahtarshme  
Oh! Pengesat, viaskat,  
Ah! Gryka sa larg!  
Ja shpërblimi dhe pak  
Ja-ja, vrapo... ah... sss."<sup>12</sup>*

Shprehja që m'u ndërmend, ishte ajo që i hakërrehej armikut të brendshëm dhe të jashtëm:

*"Ata na kanë në grykë të pushkës, ne i kemi në grykë të topit".* Mungesa e titullit është një metaforë e fuqishme dhe pikërisht përmes mungesës, konfirmon konotacionin e saj me trishtimin e asaj pjese të shoqërisë që konsiderohej e dekluar. Gjuha poetike e Blloshmit

vihet në punë për të na dhënë të vërtetat e shtrenjta të poetit. *"E vërteta shfaqet në marrëdhëniet e njeriut me objektet e dëshiruara"*<sup>13</sup>. Shënjeshtër poetik i autorit rrëshqet mbi serinë apo mbi fushën nga është zgjedhur i shënjuari, përtej të cilit shtrihet sfera kaotike e mendimeve të poetit, por edhe realiteti shqiptar i kohës.

*"O vite që kaloni, o skotë pafundësie,  
Megjithëse ju rrëmbeni at' kohë lumturie  
Kujtimi ka për t'mbetë,  
Mendimit ku venitet, mbi të ju bëni hije  
O ditë të pavdekshme, o dliresi rinie,  
Që s' kthehi më në jetë."<sup>14</sup>*

Dëshira e poetit për liri strukturohet përmes gjuhës së tij poetike. Ajo kalon në shtegun e një ligjërimi që nuk kishte asgjë të përbashkët me metodën shkrimore të realizmit socialist. Ky ligjërim poetik është një formë madhështore e nevojës së autorit për të qenë i lirë, për të shprehur atë trishtim që ndjente ai dhe shqiptarët. Në librin *"Rrugët e ferrit"*, Visar Zhiti shkruan: *"Eshtë e pamundur të mos shtangësh para martirizimit të njerëzve të letrave, të atyre, që krijojnë dhe atyre që lexojnë, të dënueshëm njëkohësisht, që ngarkohen me atë peshë si me gurët e Sizifit minierave të burgut, ndërsa djajtë vazhdojnë t'i përndjekin shkrimet, i gjykojnë, i gjymtojnë, u hapin plagë të mëdha, shpesh pa lindur ende"*<sup>15</sup>.

Vargjet e Vilson Blloshmit janë të ngarkuar me barrën e kryqeve të rëndë të trishtimit, por paradoksalisht me bukurinë e tyre, vetëm e zbukurojnë jetën e lexuesit.

## REFERENCA

1. BLOSHMI, Vilson: *Vepra 1*, Botimet "Almera", Tiranë, 2008, 200 f.
2. DADO, Floresha: *Letërsi e painterpretuar*, Shtëpia Botuese "Bota shqiptare", Tiranë, 2010, 277 f.
3. JEFERSON, Ann; ROBY, David: *Teoria letrare moderne*, Bot. i 2-të, Shtëpia Botuese "Albas", Tiranë, 2006, 340 f.
4. KADARE, Ismail: "Pavarësia e letërsisë e vështirë", Gazeta C. com
5. TOPALLI, Tefë: Gjuhësi teksti, Shtëpia Botuese e Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Shkodër, 2011, 399 f.
6. WELLEK, René; AUSTIN, Warren: *Teoria e letërsisë*, Shtëpia Botuese "Onufri", Tiranë, 2007, 319 f.
7. ZHITI, Visar: *Rrugët e ferrit*, Shtëpia Botuese "Onufri", Tiranë, 2001, 472 f.
13. Jeferson, Ann; Roby, David: *Teoria letrare moderne*, Bot. i 2-të, Shtëpia Botuese "Albas", Tiranë, 2006, f. 221.
14. Blloshmi, Vilson: *Vepra 1*, Botimet "Almera", Tiranë, 2008, f. 77.
15. Zhiti, Visar, *Rrugët e ferrit*, Shtëpia Botuese "Onufri", Tiranë, 2001, 472 f.

9. Wellek, René; Austin, Warren: *Teoria e letërsisë*, Shtëpia Botuese "Onufri", Tiranë, 2007, f. 95

10. Blloshmi, Vilson: *Vepra 1*, Botimet "Almera", Tiranë, 2008, f. 81.

11. Blloshmi, Vilson: *Vepra 1*, Botimet "Almera", Tiranë, 2008, f. 92.

12. Po aty, f. 98.



# MËSHIRA OSE NJË ESE GJYSMË E PËRGJUMUR

*Skender Drini*

Trokitje. E hap derën. Përpara meje një vajzë. Në të dhjetën e sekondës sesi mendoj që nuk jam në gjendje ta shquaj nëse është fëmijë apo plakë. Kishte një rrënim mbi shpirt që vetëm tani, mbas kaq kohësh, arrij ta kuptoj. Kishte rrënimin e turpit. Më foli me sytë përdhe dhe unë nuk arrita ta kuptoj çfarë donte. Më në fund, ajo foli disi më shkoqur. Kërkonte lëmoshë, donte diçka, por ngaqë nuk ishte mësuar me atë punë, ishte e pamundur të merrja vesh çfarë donte. Tha që e kishte nënën e sëmurë dhe nuk shkonte në punë. Kishte punuar deri në atë kohë në një furrë buke, po tani nuk shkonte. Tha që donte diçka për vete dhe për të ëmën.

E pashë nga koka deri te këmbët. Mendova që mjerimin mund ta pikturoje në një natyrë të qetë me një xhakëtë të madhe burrash që e vesh një vajzë fëmijë. Ajo nuk ka duar, sepse janë më të gjata mëngët e xhakëtës, sesa krahët e saj. Kështu, ajo është pa krahë. Dhe të mendosh, të mendosh me një trishtim të madh që ajo po i afrohet asaj kohe, kur femra kërkon të pëlqehet...Dhe si do të pëlqehet me atë xhakëtë që i mbulon duart? I mendova këto ndërsa ajo rrinte përpara derës apo më vonë? Nuk jam në gjendje ta them, por duhet ta kem menduar më vonë. Sigurisht që duhet ta kem menduar më vonë, sepse nuk do të më falej ta mendoja aty përpara saj. Nuk do të më falej, që unë të hallakatesha nëpër labirinte romantike, ndërsa ajo dridhej nën peshën e turpit dhe të urisë. Duhet të kishte uri. Patjetër që duhet të ishte e uritur. Ndoshta edhe dy ditë pa ngrënë, ndoshta edhe më shumë. Çuditërisht, unë isha krejt i ftohtë. Pse them çuditërisht? Është e zakonshme të jesh krejt i ftohtë. Është moderne të jesh krejt i ftohtë, bashkëkohore, kapitaliste...Nuk është për t'u habitur që njeriu mund të jetë i ftohtë deri te akulli dhe nuk mund të jetë i ngrohtë deri te zjarri...Pse kështu? Mos është një lajthitje e natyrës, sepse edhe ekstremet duhet të jenë të barazpeshuara në natyrë. Pa këtë barazi nuk mund të bëhet fjalë për ekuilibër. Nëse është kështu, atëherë të vjen të mendosh që është lënë diçka mangut me dashje apo pa dashje, diçka që të çon drejt shkatërrimit, pas njëmijë vitesh, pas një milion vitesh, pas njëqind milion vitesh...Është pikërisht kjo që e sjell shkatërrimin, ndërsa ne flasim për rënie meteorësh, përplasje në orbitë apo ftohtë të diellit...Mendohet për këto dhe flitet për këto, po askush nuk kujtohet që njeriu e mban brendapërbrenda shkatërrimin, si një shtatzani kozmike që mund t'i afrohet milionave vite drite. Po filozofët e optimizmit mund të gjejnë rast këtu të bërtasin që jeta nuk mund të jetojë brenda zjarrit, po mund të jetojë brenda akullit. Dhe ata sjellin si shembull fosile miliona- vjeçare të ruajtura mrekullisht në akujt e Arktikut. Thonë që ato janë të "fjetura" dhe nuk janë të vdekura. Thonë që presin t'i zgjojë teknika e së ardhmes. Ata presin, po a duam ne t'i zgjojmë? A nuk thuhet që jemi shumë edhe kaq sa jemi? Ika tepër larg. Pse të shkoj deri në Arktik, kur unë e kam atë përpara derës? E kam ende aty, me ata krahët e fshehur dhe sytë përdhe... Është e çuditshme natyra e njeriut...E çuditshme, sepse në vend që të qaj hallin e saj, unë rri dhe mendoj pse i mban sytë përdhe. Rri dhe mendoj se mbi kapakët e syve të saj rëndojnë dy piramida më të mëdha se ajo e Keopsit. Rri dhe mendoj që edhe këtu natyra ka bërë një gabim të dytë që e ka pajisur njeriun me atë ndjenjën e çuditshme që quhet turp. Natyrës do t'i shkonte për natyrë ta kishte përjashtuar njeriun dhe ta quante të za-

konshme që ai të vriste, të vidhte dhe të lypte, pa pasur turp. Çfarë është në fund të fundit ky turp dhe sa peshë ka përpara qëllimit të madh të njeriut dhe natyrës për mbijetesë? Thonë që është një element civilizimi dhe përsosmërie morale te njeriu, thonë që është një element rebelimi kundrejt natyrës që kërkon ta mbajë në jetë me çdo kusht. Thonë që natyrës njeriu i intereson fizikisht, si një qenie që popullon planetet dhe nuk i intereson shpirtërisht. Gjithë këtë ashpërsi pas kësaj, mund ta zbusësh vetëm nëse kthen sytë nga religjioni... Kjo është diçka më vete, por le të kthehemi sërish tek të lypurit, si një fenomen ekzistence. Më pëlqen të mendoj që e ka pikënisjen pikërisht atëherë, kur dikujt i kanë munguar mjetet për ekzistencë dhe kjo mund të jetë tepër e vjetër dhe mund të ketë nisur që me njerëzit e neandertalit dhe më saktë, kur njeriu e veçoi vetveten nga kafsha. Kjo mund të ketë nisur si një fenomen krejt rastësor, ndoshta edhe si një përpjekje për t'ia marrë një ujku drerin e vvarë. Nuk ia merr dot me të fortë, as njeriut të neandertalit, por dikur, me të lutur, arrin t'i shkëpusë një copë nga dreri. Kur njeriu jep diçka, është momenti, kur fillon njeriu. Aty njeriu i neandertalit kujtohet që është i ngjashëm me të ngjashmin e vet. Aty fillon mëshira.

Ajo gjithnjë në heshtje dhe me sytë ulur përpara derës sime. Nuk jam në gjendje të them si i ka sytë dhe për një çast dysjoj nëse sheh. Ka ardhur si e verbër deri aty, mbase vetëm me një fjollë drite që e lejon sa të shquajë njerëzit dhe të kapërcejë shkallët. Për një çast besoj se, po të vazhdojë në këtë gjendje, do t'i shuhet edhe ajo fjollë drite. Çfarë është drita në fund të fundit? A është energji?

Ajo gjithnjë përpara meje, gjithnjë në atë mënyrë, që nuk ka fjalë ta përshkruajë dhe piktor ta hedhë në pëlthurë. Përnjëherësh para saj Xhokonda, Mona Liza si një trill, si një vegim i momentit. E përsosur, kulm harmonie, kulm i një çasti të parritshëm lumturie. Një lumturi e qetë, e sigurt, aq e sigurt sa të bën të mendosh që lumturia buron nga siguria. Da Vinçi ka humbur një rast të madh dhe një modele të papërsëritshme, ka humbur atë që kam përpara. E ka humbur duke vdekur shumë shpejt. Nuk duhej të vdiste në atë kohë, madje ai nuk duhej të vdiste fare. A ishte e mundur të bënte një pakt me djallin për të mos vdekur kurrë? Në mesjetë thuhej që ishte e mundur. Vetëm Da Vinçin do ta pranoja të jetonte edhe si vampir, vetëm të jetonte... Me këtë model, Da Vinçi patjetër që do të arrinte të na jepte diçka që nuk e ka menduar askush, varfërinë që buron nga pafajësia. Po ndoshta do të arrinte deri te diçka e pafalshme, do të pikturonte bukurinë e varfërisë... Njerëz, është tmerr të zbukurosh varfërinë. Gjithsesi, kjo e fundit më kujton një sentencë të shkruar vite përpara: "Varfëria për religjionin është virtyt, për kapitalizmin paaftësi dhe për socializmin barazi." Për dy deduksionet e fundit jam i sigurt, për të parin jo gjithaq, sepse nuk jam aq i thellë në religjion. Sido që të jetë, kështu është shkruar dhe mbi të duhet gjykuar.

Ajo dridhet. Është e sëmurë? Ka të ftohtë? Është e uritur? Ndonjëherë mund ta zgjidh nga këto të tria, por nuk më jepet të zgjidh asnjërën. E di si shfajsohem? Nesër do të jetë prapë e sëmurë, nesër do të ketë prapë uri, nesër do të ketë prapë të ftohtë... O qiell, sa shumë jemi prishur.





# Arsimi që tregtojmë

Vehap S. Kola

*Qytetarë të Athinës, unë ju përshëndes dhe ju çmoj shumë,*

*por më tepër do t'i përulëm Zotit sesa juve,  
dhe sa të ketë frymë e forcë në mua,  
s' do të ndalem së kërkuari të vërtetën,  
e t'ju këshilloj, e t'ju mësoj dhe kur me dikë prej  
jush të takohem,*

*do të flas sipas shprehisë sime:*

*"Miku im i nderuar, je qytetar i Athinës, shtetit  
më të respektuar për nga forca dhe urtia,  
e a nuk turpërohesh që përkujdesesh se si të  
grumbullosh më shumë para, famë, respekt,  
e për mençuri, vërtetësi e shpirt, për t'u bërë  
më të mirë,*

*për këto nuk përkujdesesh dhe nuk çan kokën  
fare?*

*Dhe ju mësoj se virtyti nuk krijohet me para,  
por virtyti krijon paranë."*

SOKRATI

Qëkur dija e zhvendosi interesin e saj nga kërkimi i kuptimit, në kërkimin e fitimit, shoqëria njerëzore u bë dëshmitare e shndërimeve dramatike në të gjitha rrafshet e ekzistencës. Në këtë rrokullisje të dijes drejt inxhinieringut, çdo qasje që synonte të rrokte të vërteta themelore dhe parime të gjithëkohshme, u reduktua në rrugë të painterestë dhe u braktis masivisht dhe progresivisht nga njerëzit përgjatë kohës. Ky bar, i mbirë në shtegun e moçëm të dijes, dendësohet dhe rritet

aty për të fshehur çdo gjurmë të kahershme që mund të dëshmojë se herëdokur dija ishte dukshëm tjetër gjë nga ajo që sot bota beson dhe ndjek si të tillë. Asketi, filozofi, artisti dhe shkrimtari, zunë të përfaqësojnë shembuj të pasuksesshëm dhe me funde tragjike.

Shndërrimi, që nuk reshti së ndryshuari shpirtin, fytyrën dhe drejtimin e zhvillimit të shoqërisë njerëzore, përfundimisht i dha tregut, industrisë, parasë pushtetin të vendosë se çfarë është dhe si duhet të përmbushet edukimi i njerëzve: dituri të leverdisshme sipas kërkesave të tregut. Prandaj, që nga momenti historik i këtij parakalimi, fushat më të dëshiruara të thellimit, nuk janë më filozofia, arti dhe metafizika, por ekonomia, inxhinieria dhe marrëdhënia publike. Filozofët, artistët dhe asketët, pushuan së qeni njerëzit më të rëndësishëm dhe më të njohur dhe ekonomistët, inxhinierët dhe folësit publikë bëhen modele të njerëzve të suksesshëm dhe të famshëm.

Kjo shkëputje nga jeta intelektuale dhe shpirtërore dhe përngjitja me aspiratën ekonomike e materiale, pothuaj e kanë çrrënjësuar vetëdijen e shoqërisë njerëzore mbi pazëvendësueshmërinë e udhërrëfimit intelektual e shpirtëror, mbi nevojën e parimeve udhëheqëse të jetës dhe mbi rolin përcaktues të dijes në natyrën dhe drejtimin e zhvillimit të botës. Përpjekja për të ndërtuar një jetë pa Zotin, e çoi njerëzimin drejt korrupsionit të misionit të tij moral dhe zvetënimit të pashembullt shpirtëror, duke pamundësuar, kësajsoj, pozitën e dijes, si lokomotivë e udhëtimit njerëzor.

Aq çrrënjësës ishte ky proces reduksionist përgjatë historisë, sa, herë në emër të laicizmit e herë në emër të ateizmit, shumëkund në emër të shkencës dhe ndokund në emër të progresit dhe shkëputjes nga primitivizmi, misioni i mësuesit, si kultivues i karakterit dhe



dijeve, u tkurr në detyrën e instruktorit të veprimeve praktike dhe konkrete. Edukimi u bë arsimim. Kjo vërehet qartë në etiketimin "intelektual" të profesionistëve me arsim të lartë apo studime profesionale pasuniversitare. Statusi i profesionistit rregullohet gjithnjë nga një kod etike, që kujdeset për çdo detaj të veprimtarisë dhe sjelljes së tij, çka krijon mbresën e rrejshme të disiplinës shpirtërore dhe emancipimit intelektual.

Liberalizimi në fushën e arsimit është ripohimi më i fundit i faktit se arsimimi (lexo: ish-edukimi) mund të rregullohet si çdo sektor tjetër i tregut të të mirave dhe shërbimeve. Dora e fshehtë e mekanizmit të tregut, ku publiku kërkues dhe tërësia e ofruesve pikëndeshen për të gjykuar shkëmbimin e vlerave, ka marrë përsipër detyrën e trajnimit dhe zhvillimit profesional të fuqisë punëtore, që do t'i shërbejë po këtij tregu.

Instrumenti lehtësues i këtij akti shkëmbimi është, si për çdo të mirë e shërbim tjetër, paraja. Sepse "ajo është matëse e vlerës" dhe "ruajtëse e saj". Sepse vlerë është gjithçka që njeriu fiton e zotëron në përpjekjen e tij për mirëqenie. Dhe sa kohë mirëqenia matet me një tregues të të ardhurave për frymë, vlera është një derivat i parasë dhe jo i jetës.

Disiplinimi i edukimit nga mekanizmi i tregut e ka shndërruar shoqërinë njerëzore në një armatë gjigande profesionistësh dhe zanatçinjsh, ku zërin kryesor dhe gjithnjë e më të lartë e kanë sindikatat, njësoj si ushtritë e sklevërve. E folmja drithëruese e një libri të shenjtë apo prania hirëplote e një të urti (apo shumë të tillësh) për të gjykuar midis së vërtetës dhe së shtrembrës, tingëllon si një shfaqje prapanike dhe asfare demokratike. Mirëpo, tregu vepron në bazë të interesit material për të prodhuar konsumatorë besnikë dhe jo në bazë të nevojës së individëve dhe familjeve për të edukuar njerëz të mençur dhe të virtyshëm.

Po nga lind interesimi i tregut për arsimimin apo, që është e njëjta gjë, mospajtimi i tregut me edukimin?

Edukimi ka si mision të ruajë dhe të rrisë natyrën burimore të njeriut; ta nxisë njeriun të mendojë, të kuptojë dhe të rrokë të vërtetën e pranisë së tij në jetë;


të pranojë dhe të marrë përsipër misionin pse është. Parimisht, pritet që njeriu i edukuar të jetë i pajisur me një vizion, të gëzojë një gjerdan virtytësh, ku spikat përgjegjshmëria ndaj burimeve natyrore dhe e drejta e brezave ndaj tyre. Ky individ, me prirje konsumi të vetpërmbytura, ishte shkaku që rritja mesatare vjetore e prodhimit nga viti 1400 deri në vitin 1900, të ishte vetëm 1% në vit. Së këndejmi, nuk ka pse të jetë befasues qëndrimi jomiqësor i tregut ndaj edukimit.

Ndërkaq, arsimimi ka për mision zhvillimin e aftësive profesionale të njeriut. Nevoja për mjeshtëri dhe profesionalizëm ka ekzistuar gjithmonë dhe në botën tradicionale çirakët fitonin aftësitë teknike në mjediset e punës. Por çirakët nuk ngatërroheshin kurrë me të urtët e filozofët, artistët e mistikët. Njerëzit e arsimuar, pra profesionistët, kanë një prirje të vetvetishme për konsum më të lartë dhe një imperativ për standard

"profesional". E tillë është prirja dhe/apo kërkesa për paraqitje, sjellje dhe

zgjedhje profesionale, si dhe për mallra e shërbime të statusit. Për këtë arsye, arsimiti nuk prodhon vetëm asete për tregun, por edhe vetë blerësit e mallrave dhe të mirave që ata ideojnë dhe realizojnë. Ky lloj i individit është shkaku pse rritja mesatare vjetore e prodhimit gjatë shekullit të 20-të qe 5%.

Vendosja e hegjemonisë së tregut mbi arsimin, përbën edhe përplotësimin e pushtimit të gjithçkaje në re nga paraja. Me këtë larje hesapësh, gjithçka mund të tregtohet, dhe, meqë arsimimi nënkupton pajisjen me një kuadër dijesh teknike dhe praktike, edhe ai mund të tregtohet. Duke e bërë atë të këndshëm dhe dobipurës, njësoj si shumësia e mallrave dhe shërbimeve të tjera përmes marketingut modern, tregu e ka vënë njeriun bashkëkohor nën diktaturën e konsumit. Megjithë shijen e hidhur që lë ky konstatim, ai mbart edhe një të mirë në brendinë e tij: rikonfirmimin edhe për njeriun bashkëkohor, se shpirti i njeriut është trualli i vetëm që nuk mund ta pushtojë tregu.





# DEMOKRATIZIMI I MARRËDHËNIEVE NË SHKOLLË

*Soc. Raimonda Draçini*

*Vendosja e komunikimeve mësues - nxënës,  
shprehje e respektimit të lirive e të drejtave të nxënësve në shkollë*

Sipas studimeve psikologjike: “Komunikimi, shpirti krijues në të gjitha format dhe bashkëpunimi mund ta largojnë dhunën dhe vuajtjen”, komunikimet e frytshme me mësuesin e aftësojnë nxënësin të dialogojë e bashkëpunojë - kërkesa këto tepër të mprehta të atmosferës së sotme sociale.

Zgjidhja e kësaj çështjeje gjendet e fshehtë në realitetin njeri. Është e vërtetë e pakontestueshme se njeriu, i cili është dërguar në këtë botë me qëllim sprove, është i përshtatshëm edhe për të mirën edhe për të keqen. Ngaqë sprova kërkon që njeriu të ketë mundësi edhe për të drejtën edhe për gabimin. Është e qartë se, nëse nxënësi e përfundon shkollën e mesme duke mbetur një njeri i tërhequr, i mbyllur, i ndrojtur, i turpshëm e pa guxim, atëherë mund të thuhet se shkolla dhe mësuesit nuk e kanë socializuar komunikativisht nxënësin.

Në moshën 14-18 vjeç, formohen cilësitë e rëndësishme të karakterit, fitohen dije e shprehje që nxënësit i nevojiten tërë jetën, prandaj duhet vlerësuar seriozisht. Sa më i lartë është standarti i jetesës, kultura demokratike e një populli, aq më shumë vlerësohen të drejtat e njeriut. Kryesore janë cilësitë e njerëzve, pra dhe të mësuesit në shkollë. Kur mësuesit i mun-

gon shpirti human, fisnikëria, toleranca, gatishmëria për të komunikuar e bashkëpunuar me nxënësit e tij, konsensusi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve e konflikteve me nxënësit e prindërit e tyre, ai nuk mund të jetë mbrojtësi i lirive e të drejtave të nxënësve në shkollë, por vetëm shkelësi i tyre.

Arsyeja, të menduarit, të gjykuarit dhe vullneti, nuk janë të mjaftueshme që e mira të dalë ngadhënjimtare karshi së keqes në këtë konflikt. Sikur të mjaftonin vetëm këto elemente, atëherë Allahu i Lartë nuk do të ndihmonte njeriun e parë të krijuar, Hazreti Adem-in edhe me revelatë. Por Allahu i Lartë ka udhëzuar njerëzimin vazhdimisht drejt së vërtetës me shpallje, zbulesë hyjnore, dhe me profetë. Njeriu me arsye arrin në “formën më të bukur”, respektivisht, në pozitën më të lartë që mund të arrijë njeriu. Prandaj edhe mësuesi në klasat e ulëta tregon ngrohtësinë me fjalë e qëndrim miqësor, kurse ndaj nxënësve të shkollave të mesme më shumë me kontakte shoqërore jashtë mësimin. Pra, kjo ngrohtësi ekziston kur nxënësi e ndjen se mësuesi e vlerëson atë si njeri, e çmon në personalitetin e tij, punon për ta zhvilluar më tej atë, për të mbrojtur liritë e të drejtat e tij, si qenie që ka nevojë për ndihmën



e mbështetjen e më të mëdhenjve. Në këtë mënyrë nxënësit mësojnë se kanë vlerë, çmohen dhe respektohen, se nevojat e dëshirat do t'u përmbushen dhe se të drejtat e tyre do mbrohen.

Lind pyetja: Një mësues, që nuk është i zoti i vetes, a mund t'i mbrojë të tjerët?

Nëse ekziston një fakt i tillë, komunikimet mësues-nxënës zbehen, ftohen, bile edhe ndërpriten. Në këtë mënyrë, nuk arrihet socializimi komunikativ i adoleshentit për të shërbyer si model për komunikimet e tij në të ardhmen, kur të ketë fituar statusin e qytetarit të rritur.

Komunikimet e dendura dhe të frytshme, jo vetëm që shprehin shkallën e bashkëpunimit të mësuesit me nxënësit adoleshentë, por edhe krijojnë premisa për nxitjen e këtij bashkëpunimi. Nxitja e bashkëpunimit shënon edhe përmirësimin e marrëdhënieve.

Komunikimet e frytshme ndihmojnë që nxënësit të vetshprehen më mirë. Të mësuarit e sotëm nuk mund të kuptohet pa mbështetje shkencore edhe në sferën emocionale të nxënësve. Mësuesi nuk merret vetëm me trurin e nxënësit, por edhe me gjithë botën e tij shpirtërore, prandaj ka rëndësi sa i merr parasysh dhe sa mbështetet në veçoritë e personalitetit të tij, në cilësitë e temperamentit e të karakterit, në prirjet, aftësitë dhe interesat e tij. Por ka raste, ku komunikimet mund të jenë jo të frytshme dhe ndodh ftohtësia mes mësuesit dhe adoleshentit, antipatitë e sëmura, mëritë, përdorimi i notës si presion për të frikësuar e për të vënë në vend "autoritetin e tij", kundërsulmet, paralajmërimet, kërcënimet, pabarazia në vlerësimin e nxënësve, krijojnë stres tek adoleshentët, i mërzhisin, i detyrojnë edhe të largohen nga orët e mësimin, madje të braktisin edhe shkollën.

#### VLERËSIMI I DIVERSITETIT TË MENDIMEVE

Njerëzit nuk mendojnë me një kokë, as nuk kanë të njëjtat parime. Secili ka konceptet e bindjet e veta filozofike, morale, politike, të cilat duhet të respektohen. Edhe mësuesi duhet të dëgjojë vërejtjet e sugjerimet e nxënësve, sepse është një e drejtë e tyre, e përcaktuar edhe në rregulloren e shkollës. Për të ndërtuar një shoqëri të hapur, për t'u marrë vesh njerëzisht vëllazërisht, është e domosdoshme të dëgjojmë me vëmendje njëri-

tjetrin, të mos flasim me të bërtitura, me nervozizëm, të mos e themi të parën fjalën e fundit. Kjo arrihet nëpërmjet debatit të lirë, diskutimit e ballafaqimit të pikëpamjeve e qëndrimeve të ndryshme.

Adoleshenti ka të drejtë të flasë e të shprehë mendimet e tij deri në fund, pa i ndërhyrë. Atij i duhet lënë kohë e mjaftueshme për t'u përgatitur për debat dhe i duhen krijuar kushtet për t'u shprehur lirisht. Sa më thjesht të organizohet debati, sa më pranë psikologjisë së moshës, sa më natyrshëm, me humor, me tolerancë e dashamirësi të zhvillohet, aq më i suksesshëm do të dalë, aq më e madhe do të jetë dëshira e nxënësve për t'i organizuar ato herë pas here.

Nxënësit i duhet folur hapur, me çiltërsi, por edhe duhet nxitur të shfaqë mendimet e tij. Në të kundërt, ai e humbet besimin tek mësuesi, bëhet indiferent ose e ndërpret plotësisht komunikimin gjatë debatit. Pa njerëz të guximshëm, të vendosur, të aftë për t'u dhënë zgjidhje problemeve, debatet nuk mund të kenë sukses. Nëpërmjet debatit shprehet diversiteti i mendimeve.

Mendimi është dhunti, kurse formësimi i tij, aftësi. Ekzistenca nuk i nxjerr në shesh të fshehtat e saj vetvetiu. Ato i zbulojmë ne, duke kaluar nëpër rrugën e mendimit. Edhe vetë ligjësitë e mendimit, njëri i zbulon me anë të mendimit. Uniteti shkak-pasojë në formën e tij më të bukur, vetëm në mendim ekziston.

Demokratizimi i klimës shkollore kërkon që mësuesi të adaptojë sjellje të tilla, që marrin parasysh gjendjen shpirtërore të nxënësve. Aftësia e mësuesit për të përforcuar sjelljen e mirë të nxënësit e për të kritikuar në kohë e në masën e duhur sjelljen e keqe, për të nxitur nxënësit në angazhime të ndryshme, për të rritur bashkëpunimin midis tyre, për të formuar gjykime kritike e për t'i nxitur ato, janë cilësi të domosdoshme për mësuesin që përpiqet të krijojë komunikime cilësore, të natyrshme dhe të dobishme me nxënësit.

Nuk ka mirëqenie shoqërore, nuk ka prosperitet shoqëror, pa respektimin dhe mbrojtjen e lirive e të drejtave të njeriut. Standardi i tyre mund të arrihet vetëm duke zgjeruar dhe përforcuar bashkëpunimin dhe duke zhvilluar individë me pavarësi të plotë shpirtërore dhe morale për jetën e tyre.



# E shkuara dhe e sotmja në atmosferën e 5 - vjetorit të xhamisë së re të Parrucës

Imam Muhamed Sytari

Myfti i Zonës Shkodër

5-vjetori i inaugurimit të xhamisë së re të Parrucës më ktheu pas në mendime. Shumë kohë më parë, në një vend, ndryshe nga vendi ynë, në një realitet, ndryshe nga realitetet tona të përditshme, dy njerëz të mëdhenj takoheshin për herë të parë në jetën e tyre. Njëri ishte profet i madh, Musai (a.s.), tjetri, "një rob prej robëve Tanë", Hizri (a.s.). I pari nxënës, kërkues i dijeve, i dyti mësues, jo si çdo mësues.

Episodi i tretë i udhëtimit të tyre në rrugën e zënies së dijes dëshmohej qartas në Kuran: *"Dhe që të dy vazhduan të ecnin, derisa arritën në një fshat dhe u kërkuan banorëve të tij që t'u jepnin për të ngrënë, por ata nuk i pranuan mysafirë. Aty ndeshën një mur që ishte duke u rrëzuar dhe ai (Hizri) e drejtoi. (Musai) tha: "Sikur të kishe dashur ti, mund të kërkoje shpërblim për këtë."* (Kurani, el-Kehf, 77.)

Ai mur ishte pjesë e pronës së një besimtarit të ndershëm, që kishte lënë pas dy jetimë. Poshtë atij muri ndo-

dhej një thesar. Për të ruajtur singeritetin e besimtarit të ndershëm dhe sekretin e lutjeve të tij: *"Zoti yt dëshiroi që ata të arrinin moshën e pjekurisë e ta nxirrnin thesarin e tyre, si mëshirë nga Zoti yt."* (Kurani, El-Kehf, 82.)

Ajo që lidh të sotmen tonë me të shkuarën e dy jetimëve, është besimi në Një Zot dhe shpërblimi i lutjeve të singerta për pasardhësit dhe rrugëtimin e tyre.

Kush do ta kishte menduar ato ditë të vitit 1967, kur satanizmi i drejtuesve të shtetit shqiptar kishte arritur kulmin dhe shërbëtorët e tyre shkatërronin xhaminë e Parrucës (si simotrat e saj), se do të vinte një ditë, plot 40 vite pas asaj dite të kobshme, që xhamia e re e Parrucës të ishte sërish aty, në të njëjtin vend, me të njëjtën madhësi, me të njëjtin mision!?

Kush do ta kishte menduar ato ditë të hirta të vitit 1967, teksa në gazetën e sistemit faraonik, njerëz të dehur nga duhma e rëndë e ateizmit deklarorin se: *"Lumturinë tonë po e gjejmë tek partia dhe jo tek feja e zoti"*<sup>1</sup>, do të vinte një ditë, plot 40 vite nga ajo ditë e zezë, kur prishej xhamia e Parrucës, që në të njëjtin vend, duar të pastra myslimane shqiptare do të ngrinin sërish në këmbë faltoren e Teuhidit!?

Kush do ta kishte menduar ato ditë të kryqëzatës komuniste, teksa një rini e lajthitur, krejtësisht idhujtare, i shkruante femohuesit të madh: *"Nën dritën e fjalimit tuej të 6 shkurtit, ju premtojmë se do të përqafojmë dhe do t'i vemë në jetë mësimet e partisë për zhdukjen e të gjitha mbeturinave, do*

1. Q. H., shkrimi me të njëjtin titull, në gazetën "Zëri i popullit", nr. 77 (5802), e premte, 31 mars 1967, fq. 2.



të djegim me zjarr çfaqjet e hueja që pengojnë ecjen tonë përpara dhe do të kalitemi me moralin komunist. Pak ditë ma parë ne vendosëm njëzani t'i kthejmë dy xhamijat e lagjes nga institucione të errësinës dhe vatra të propagandës së çfrenueme kundër interesave të popullit në qendra për edukimin dhe argëtimin e brezit të ri... Tue kuptue damin që i sjellin familjes dhe shoqnisë zakonet prapanike dhe bindjet fetare, ne zotohemi: 1) Do të punojmë me të gjitha forcat si aktivistë të organizatës së frontit për të dërmue çdo gja që pengon, sado pak, ecjen tonë në rrugën e caktueme nga partia jonë e lavdishme. 2) Do të heqim të gjitha ceremonitë e festat fetare që kanë xanë vend deri tashti. 3) Nuk do të presim njeri për festat fetare. ...”<sup>2</sup>, do të vinte kjo ditë e bekuar e rilindjes islame!

Kush, ato ditë, kur një skllav i ngratë i një sistemi degradues të vlerave njerëzore dhe besimore, thërriste me të madhe se: “Për vazhdimin e luftës kundër ideologjisë fetare, shumë i vlefshëm do të ishte krijimi i një muzeu ateistoshkencor në qytetin tonë. Hapja e një muzeu të tillë, për të cilin janë krijuar mundësitë, do t'i vlente jo vetëm qytetit dhe rrethit tonë, por edhe rretheve të tjera.”<sup>3</sup>, ishte i aftë të mendonte se do të vinte sërish një ditë, kur kjo kolerë faraonike do të fashitej dhe shqiptarët do t'i riktheheshin sërish fesë së tyre dhe amanetit të baballarëve të shkuar!?

Kush, ato ditë, kur një shkrimtar servil dhe propagandues i antivlerave shkruante: “Muzeu ateist i Shkodrës është një ekspozë, ku parulla e partisë, “Armiku më i rrezikshëm është ai që harrohet” konkretizohet në mënyrë të shkëlqyeshme... Qymja e Pejgamerit (Muhametit) është vendosur pranë manekinit të shën Prosperit martir... Qymja e Muhametit dilte një herë në vit, ditën e Mevludit, që myslimanët fanatikë ta puthnin duke pritur me orë të tëra në procesion... Dokumentat në muze janë të ndryshëm dhe fillojnë që nga vigjilja e shekullit të 19-të, për të ardhur në ditët tona. Një histori e tërë e një terrori, vjedhjeje e gënjeshtre të rafinuar të klerit dhe e lidhjeve të tij me çdo pushtues... çdo të huaj...”<sup>4</sup>, mund të mendonte

2. Letër e hapur e popullit të bllokut nr. 1-2 të lagjes “Kongresi i Përmetit”, Shkodër, me titull: “Do të heqim të gjitha ceremonitë e festat fetare”, në gazetën “Zëri i popullit”, v. 26, nr. 73 (5798), e diel, 26 mars 1967, fq. 3. (Letra mban datën 19 mars 1967).

3. L. F., “Përdorimi i emrave me origjinë fetare është i dëmshëm”, në gazetën “Jeta e re”, viti II, nr. 59 (134), e mërkurë, 24 korrik 1968, fq. 3.

4. F. K., “Copa të zeza veladonësh - (Duke vizituar muzeumin ateist të Shkodrës)”, në gazetën “Drita”, 14 tetor 1973, fq. 12.

se nuk do të vononte dita, kur faraonët dhe skllëvërit e tyre do të binin dhe servilët e dikurshëm do të ktheheshin në elitën e sotme!?

Teksa lexoj pasrreshtat e takimit të Musait (a.s.), me Hizrin (a.s.) dhe shoh gëzimin e besimtarëve në këtë ditë të 5-vjetorit të inaugurimit të xhamisë së Parrucës, falënderoj Allahun e Madhëruar, që na bëri dëshmitarë të triumfit të besimit mbi njoancën e femohimit. E falënderoj me të madhe, që na bëri të jemi dëshmitarë të mrekullisë së ruajtjes së nderit të lutjes së të parëve tanë, në realitetet e jetuara prej nesh.

Për shumë dekada, ne shqiptarët mbetëm jetimë, si jetimët e kohës së Hizrit. Në thellësitë e shpirtave tanë ishte mbuluar thesari i besimit, që na lidhte me genin e paraardhësve tanë me mjekra të bardha e kokën në sexhde. Muri dukej se do të rrënohej, por mëshira e Zotit është më e madhe dhe më e paparashikueshme se llogaritë e atyre që lidhën besën me të mallkuarin! Ai mur u ngrit në këmbë, që ne, në një fazë pjekurie, të arrinim preken e themeleve, dëshmimin e amanetit, rikthimin në origjin!

Për shumë dekada, shqiptarët mohuan Zotin, i shpallën “luftë” Atij, menduan se e bënë Shqipërinë Satanistan, por gabuan (ndonëse akoma përpiqen me forma të reja)!

Sot, teksa shoh njerëzit të gëzuar për këtë dhuratë të shtrenjtë të Zotit ose më mirë thuaj: teksa shoh se si shqiptarët po i ndërtojnë vetë xhamitë, me duart e tyre, në damarët e të cilave qarkullon gjaku i baballarëve të nder-

shëm, myslimanë, besimtarë, me sytë nga toka e duart nga qielli, gëzohem dhe lutem që të jemi si ata, baballarët, sekretin e lutjes së të cilëve e ruajti Allahu!

Prandaj, në këtë përvjetor të pestë të inaugurimit të xhamisë së qytetarisë shkodrane dhe origjinës së tyre të vërtetë, është mirë të shohim përreth dhe të lutemi që Allahu të na ruajë nga format degraduese të politikave sataniste, që sërish e marrin për dore shqiptarin drejt humnerave të ateizmit dhe degradimit moral. Sepse, në fund të fundit, format e degradimit satanist, tërheqin ndëshkime hyjnore, që kur bien në tokë, dëshmojnë së “perandoria e femohimit dhe imoralitetit” nuk është shpëtimil!

Zot na ruaj dhe na udhëzo!

Shkodër, 23 mars 2012



*Sot, teksa shoh njerëzit të gëzuar për këtë dhuratë të shtrenjtë të Zotit ose më mirë thuaj: teksa shoh se si shqiptarët po i ndërtojnë vetë xhamitë, me duart e tyre, në damarët e të cilave qarkullon gjaku i baballarëve të ndershëm, myslimanë, besimtarë, me sytë nga toka e duart nga qielli, gëzohem dhe lutem që të jemi si ata, baballarët, sekretin e lutjes së të cilëve e ruajti Allahu!*



*Nexhat Spahiu*

# Rinia

## është begatia më e çmueshme e një kombi

Çfarë brezi po rrisim? Ç'të ardhme po ndërtojmë?

Po jetojmë në një kohë shumë të vështirë, ku rinia jonë po përballet çdo ditë me sfida të ndryshme, siç janë: droga, prostitucioni, alkooli etj. Të rinjtë tanë po mundohen të imitojnë kultura të ndryshme dhe po harrojnë veten e tyre.

Rinia është begatia më e çmueshme e një kombi. Pa një rini të shëndoshë, një komb nuk ka perspektivë të ndritur. Rinia e popullit shqiptar ka kohë që gjendet në udhëkryqet e saj.

Gjithmonë është thënë se rinia është ardhmëria e një shoqërie, e një populli, e një shteti dhe në duart e saj do të barten përgjegjësitë dhe obligimet për të udhëhequr, edukuar, zhvilluar dhe për të çuar përpara bashkësinë njerëzore.

Rinia shqiptare po kalon momente shumë të vështira dhe, ashtu si i gjithë kombi shqiptar, ndodhet në një udhëkryq të madh. Kërkon të ndërtojë të ardhmen e saj, por ndeshet me shumë probleme, të cilat shpesh janë shumë të vështira për t'u zgjidhur.

Koha në të cilën jetojmë është mjaft dinamike dhe sot në botë ndryshimet ndodhin me një shpejtësi marramendëse.

Periudha e rinisë është periudha e fuqisë, e cila gjendet në mes dy periudhave të dobësisë: dobësisë së fëmijërisë dhe dobësisë së pleqërisë, siç tregon për këtë Kurani famëlartë:

***“Allahu është Ai që ju krijoi në një gjendje të dobët, pastaj, pas asaj dobësie ju dha fuqi e pas fuqisë, dobësi e pleqëri. Ai krijon çka të dojë, Ai është më i dijsmi, më i fuqishmi”.*** (Er-Rum, 54)

Faza e rinisë është një begati që duhet të shfrytëzohet. Të rinjtë janë ata që mund të bartin detyra të rënda, të ballafaqohen me sfida të ndryshme, të durojnë dhe të sakrifikojnë për ideale. I Dërguari (a.s.), ka thënë:

*“Nuk do të lëvizë askush ditën e Kiametit, derisa të pyetet për katër gjëra: për jetën si e ka harxhuar, për rininë si e ka vjetëruar, për pasurinë si e ka fituar dhe ku e ka harxhuar dhe për punën e tij - ç'bëri.”* (Tirmidhiu)

*“Shfrytëzo pesë gjëra, para pesë të tjerave: rininë tënde para pleqërisë, shëndetin para sëmundjes, pasurinë para varfërisë, kohën e lirë, para se të zihesh dhe jetën para vdekjes.”* (Bejhekiu)



Rinia sot po jeton në një zbrazëti shpirtërore. Ajo ka energji, por këtë energji po e shpenzon kot, pa e ditur qëllimin e krijimit të saj. Sheh një numër të madh të rinjsh pa të ardhme, pa kontroll. Bëjnë jetë të çastit, nuk mendojnë për një të ardhme të ndritshme. Kanë pak moral, flasin shumë e asgjë s'thonë. Edhe ato fjalë që flasin, i kanë sharje, mallkime, tallje etj. Pra, aq sa dinë, flasin. Shkojnë në shkollë, si duke shkuar në dasmë. Bile në dasmë, njerëzit dërgojnë dhurata. Me një fletore në xhep, të gjitha lëndët i përziejnë në të.

Shkollën nuk e llogarisin si vend të arsimit dhe edukimit. Për ta, shkolla është një mundësi për largim nga shtëpia. Shkollat kanë filluar të marrin rolin e vendeve ku bëhet sfilata, ku secila vajzë shtyhet me tjetrën se cila e ka fustanin më të shkurtër, cila ekspozon lakuriqësinë më shumë, disa të tjera, kush bën makijazhe më të mira. Kjo, pothuajse nuk po i shqetëson shumë prindërit dhe edukatorët e tyre, por nëse një vajzë e re vendos të mbrojë nderin dhe identitetin e saj fetar, për rrethin dhe pedagogët e saj ajo është e nënçmuar, e përjashtuar nga orët e mësimin, por ka raste edhe të përjashtimit nga shkolla.


Për rininë e perëndimit dhe problemin e zbrazëtisë së saj shpirtërore, Dr. Jusuf El-Kardavi thotë: "Ata ankohen për shkak të boshllëkut, brengës dhe jetës së pakuptimtë. Për këtë shkak, jeta e tyre është e ngjashme me mënyrën nomade të ekzistencës, ngase ky civilizim bashkëkohor nuk u ka ofruar inspirim shpirtëror, nuk e ka mbushur boshllëkun dhe vakuumin fetar. Nuk i ka mbrojtur nga frika. Ata nuk kanë kuptuar me të zanafillën, as zhvillimin e tyre. Nuk e kanë kuptuar domethënien e ekzistencës të tyre. Te kokat e tyre ende sillen pyetjet e përhershme: prej nga janë, ku dhe përse shkojnë?"

Dr. Jusuf El-Kardavi thotë: "Të rinjve u nevojitet autoriteti, por a mund të gjejnë një model të duhur në shtëpi? Po në shkollë dhe shoqëri?"

Fatkeqësisht, modele të tilla të dhura, sot ka gjithnjë e më pak. Sot, është vështirë të gjendet një baba, i cili të jetë shembull për fëmijët e tij, as pedagog, tek i cili nxënësit do të shihnin autoritetin dhe edukatorin e duhur. Është e vështirë të gjendet ky lloj, përveç atyre të cilët i ka mëshiruar Allahu, (xh.sh.), ndërsa ata, siç

duket, janë të rrallë.

Në disa shkolla ekziston një program i mirë për studimin e diturive të Sheriatit dhe të ngjashme, mirëpo arsimimi nuk nënkupton vetëm programin ose librin e mirë apo lëndët, të cilat duhet mësuar përmendsh për të kaluar provimin. Arsimimi është diçka më e thellë dhe më e madhe se kaq. Arsimimit i nevojitet një model, i cili diturinë e vet të arrijë ta transmetojë tek nxënësit ngrohtësisht dhe të zgjojë tek ata vëmendjen dhe dëshirën për fitimin e diturisë, i cili do të ishte shembulli i gjallë i arsimit."



*Arsimimit i nevojitet një model, i cili diturinë e vet të arrijë ta transmetojë tek nxënësit ngrohtësisht dhe të zgjojë tek ata vëmendjen dhe dëshirën për fitimin e diturisë, i cili do të ishte shembulli i gjallë i arsimit.*

Për këtë, i riu mysliman duhet të bëhet vetë shembull i mirë për ta ndjekur tjerët. Askush nuk ka të drejtë që këtë t'ia hedhë tjetrit apo shoqërisë. Ne të gjithë jemi përgjegjës, sepse kjo është prej problemeve thelbësore të shoqërisë dhe kjo nënkupton edhe përgjegjësinë tonë kolektive për mosrealizimin e këtij objekti madhor islam.

Shembulli i mirë duhet të ekzistojë në të gjitha fushat e jetës, si: përkushtim fetar, shkencë, moral, sjellje të mirë, familje, shoqëri etj.

Shumë prej të rinjve i kanë neglizhuar obligimet fetare dhe i kanë lënë mënjanë. Ka prej atyre që i kanë lënë krejtësisht, e prej atyre që u kanë ikur disa nga obligimet, disa nga shtyllat.

Nëse zemra e të riut lidhet pas epsheve, ajo është prishur edhe sfiduar dhe ai është bërë rob i atyre epsheve, vrapon pas tyre, edhe pse ato e drejtojnë drejt shkatërrimit të tij.

"Kush e lë shpirtin e vet të zbrazët, në të do të vendoset pakujdesia. Shpirti nuk mund të mbetet bosh. Nëse nuk mbushet me të mirë, do të mbushet me të keq, nëse nuk mbushet me udhëzim, do të mbushet me mashtrim, nëse nuk mbushet me të vërtetën, do të mbushet me të pavërtetën".

Disa sfida, me të cilat për fat të keq po ballafaqohet rinia jonë:

#### **ALKOOLI**

Konsumimi i alkoolit dhe drogës krijon një gjeneratë plotësisht të shkatërruar, prej së cilës nuk pritet asnjë dobi, sepse kjo gjeneratë do të jetë vegël e tjetërkujt. E, nëse kjo gjeneratë është kështu, kjo do të jetë fat-

keqësia më e madhe, sepse, nëse rinia bie, atëherë kush do të ngrihet me ndërtimin dhe kush do të rikthejë fitoren dhe rezultatet:

**“Shejtani nuk dëshiron tjetër, përveçse nëpërmjet verës dhe bixhozit të hedhë armiqësi mes jush, t’ju pengojë nga të përmendurit e Zotit dhe t’ju largojë nga namazi. Pra, a po i jepni fund (alkoolit e bixhozit)?”** (El Maide, 91)

#### **NARKOMANIA-DROGA**

Në vendin tonë, droga paraqet armën më moderne të djallit të mallkuar.

Për fat të keq, narkomania po merr sot një shtrirje me përpjesëtime më të gjera katastrofale dhe është një problem bashkëkohor dhe universal i çdo nacionaliteti.

Ajo është një problem botëror dhe, ç’është më e keqja, kjo epidemi planetare po përqafohet nga kategoritë e ndryshe e, në veçanti, nga të rinjtë.

Sot në shumë vende të botës, droga është bërë traditë dhe pjesë përbërëse e njeriut, në shkollë, rrugë, dasma, ahengje, dëfrime, mbrëmje gazmore, si dhe në momente dhe situata të ndryshme. Në anën tjetër, shumica e prindërve, duke dashur që të tregohen “modernë” dhe se i kuptojnë veprimet e fëmijëve të tyre dhe të rinisë në përgjithësi, shpeshherë bëhen të shurdhër për jetën e tyre, duke mos i kuptuar pasojat e saj.

#### **DUHANI**

Duhani është një traditë e fëlliqur, e cila është shpërndarë me të madhe në mesin e rinisë dhe të të tjerëve. Dijetarët janë shprehur qartë për ndalesën e duhanit dhe dëmet e tij. Allahu i Madhëruar thotë:

**“...ai u lejon atyre si të ligjshme At-Tajibat (gjithçka të mirë dhe të ligjshme për besimin, punët, njerëzit, ushqimet, sendet) dhe ua ndalon si të paligjshme Al-habaith (gjithçka të keqe dhe të palejueshme për besimin, punët, njerëzit, ushqimet).”** (El

Araf, 157)

#### **INTERNETI**

Kjo sprovë e re ka hyrë në shtëpitë tona tani afër dhe pa kontroll. Edhe pse interneti mund të përdoret për të mirë dhe për përmirësim, shumica e të rinjve e shfrytëzojnë atë me qëllim të lojës dhe kalimit të kohës më kot e ndoshta edhe në gjëra të ndaluara. Kjo është prezente tek shumica e të rinjve në kohën tonë, të cilët kalojnë nëpër faqe të ndryshme të këqija, duke shikuar atë që nuk kanë pasur mundësi ta shohin përmes kanaleve satelitore.

Ja një shembull se si duhet të jetë një i ri: Ibrahim (a.s.), ishte një i ri në moshë shumë të vogël, por edhe pse në atë moshë, ai nuk pranoi t’i adhuronte idhujt dhe këtë veprim ia mohoi babait dhe popullit të vet.

Siç e përmend, Allahu (xh.sh.), në Kuranin Famë-lartë:

**“Ç`janë këto statuja?” Ata thanë: “I gjetëm të parët tanë duke i adhuruar.” Ai u tha: “Edhe të parët tuaj edhe ju ishit të humbur.” Pastaj vazhdoi të debatonte me ta, deri sa i mposhti dhe u tha: “Pasha Allahun, posa të largoheni ju, unë kam për t’ua bërë atë që duhet statujave tuaja! Dhe i bëri ato copë-copë, përveç një më të madhes që kishin ata, me shpresë se do t’i drejtoheshin atij (për të kuptuar se kush i theu).”** (Enbija, 57-58)

Kur u kthyen, ata u habitën se ç`kishte ndodhur me zotat e tyre. Ja si e shpjegon Kurani këtë rast:

**“Ata thanë: Kush e bëri këtë me Zotat tonë? Ai na qenka kriminel. (Pastaj) Thanë: Kemi dëgjuar për një djalosh që i përqeshte ata, të cilin i thoshnin Ibrahim.”** (Enbija, 59-60)

Ibrahimi ishte një djalosh i ri, ndoshta edhe më i ri se ne, por në atë moshë ishte në rrugën e Allahut (xh. sh.) dhe iu kërcënua atyre se do t’ua bënte copë-copë zotat dhe e realizoi kërcënimin e vet. Kur ata e pyetën nëse e kishte bërë, ai u përgjigj:

**“Mirëpo, pastaj e shoshitën këtë gjë në kokat e tyre (u kthyen nga bindja në kokëfortësi) dhe thanë: Poti e ke ditur se këta nuk flasin!”** (Enbija, 65)

#### **DISA HADITHE, NË TË CILAT PËRMENDET RINIA**

Meqë këto fjalë vërtiten rreth problemit të rinisë, unë kisha dashur që të përmend disa hadithe, në të cilat përmendet rinia. Nga mesit e tyre janë:

1. **“Zoti yt është i kënaqur me atë adoleshent, i cili është i lirë nga pasioni rinor.”** (Ahmed)



2. "Janë shtatë persona të cilëve Allahu do t'u ofrojë hije prej hijes së Tij, në ditën kur s'do të ketë hije tjetër përveç hijes së Tij. Sunduesi i drejtë; i riu i cili qe edukuar në dëgjueshmëri ndaj Allahut; njeriu, zemra e të cilit është e lidhur për xhaminë; dy njerëz, të cilët e duan njëri-tjetrin vetëm për hir të Allahut dhe takohen për hir të Allahut; njeriu, i cili joshet nga një grua me pozitë dhe bukuri dhe thotë, "Unë i frikësohem Allahut."; njeriu i cili ka dhënë lëmoshë fshehurazi, saqë dora e tij e majtë nuk e di se çfarë ka dhënë e djathta e tij; dhe personi, i cili e përkujton Allahun në vetmi dhe nga sytë e tij rrjedhin lotët (për shkak të frikës ndaj Allahut)." (Buhari dhe Muslim)

3. "Hasani dhe Huseini (radiallahu anhuma), do të jenë udhëheqësit e të rinjve në xhenet." (Tirmidhi)

4. Do t'u thuhet njerëzve të Xhenetit: "Për ju është rinia dhe ju kurrë s'do të plakeni." (Muslim)

5. "Asnjëherë një i ri nuk e nderon një të vjetër për shkak të moshës e që Allahu të mos i caktojë dikë, i cili do ta nderojë atë gjatë pleqërisë së tij." (Tirmidhi me zinxhir të dobët të transmetimit)

6. Ebu Bekri i tha Zejd bin Thabitit, derisa Umeri ishte krahas tij (radiallahu anhum): "Ti je një i ri, inteligjent. Ne s'dyshojmë në ty dhe ti e shkrove shpalljen për të Dërguarin e Allahut, salallahu alejhi ue selam. Pra, ndiqe Kuranin dhe mblidhe atë." (Buhari)

7. Pejgamberi, salallahu alejhi ue selam, i erdhi një të riu kur ai ishte në agoninë e vdekjes dhe e pyeti: "Në ç'gjendje e sheh veten?" Ai tha: "Kam shpresë në Allahun, O i dërguar i Allahut dhe frikësohem për mëkatet e mia." Pejgamberi, salallahu alejhi ue selam, tha: "Nuk bashkohen këto dy gjëra (shpresa dhe frika) në zemrën e robit në një moment të këtillë e që Allahu të mos ia japë atë për çka shpreson dhe ta shpëtojë atë nga ajo prej të cilës frikohet." (Ibn Maxhe)

8. Në lidhje me betejën e Hunejnit, Bera bin Azib (radiallahu anhu), tha: "Jo, pasha Allahun, Pejgamberi, salallahu alejhi ue selam, nuk ka ikur, por madje edhe shoqëruesit e tij të rinj, të cilët qenë të lodhur dhe të pajisur dobët, u shfaqën për të luftuar." (Buhari)

9. Ibn Mes'ud (radiallahu anhu), transmeton: "Ne luftonim me Pejgamberin, salallahu alejhi ue selam, kur ishim të rinj." (Ahmed)

10. Alkame, i cili është njëri nga shoqëruesit e Ibn Mes'udit, (radiallahu anhu), transmeton: "Unë ecja me Abdullahun në Mine, kur ai e takoi Uthmanin (radiallahu anhu). Abdullahu qëndroi duke biseduar me Uthmanin (radiallahu anhu), kur ai tha: "O Ebu Abdir-Rahman, a do të martojmë ty me një vajzë të re, në mënyrë që ajo

të t'i përkujtojë disa gjëra, të cilat kanë kaluar gjatë kohës tënde." Abdullahu tha: "Nëse e thoni këtë, me siguri Resullullahu, salallahu alejhi ue selam, na ka treguar neve." "O rini, kushdo nga ju që ka mundësi, le të martohet, sepse kjo është më efektive në mbrojtjen e shikimit dhe më e dëlirë për vendet e turpshme. Nëse dikush s'ka mundësi ta bëjë këtë, atëherë ai duhet të agjërojë, sepse kjo është mburojë për të (nga mëkatet)." (Buhari dhe Muslim)

11. Në hadithin që ka të bëjë me Dexhallin, të transmetuar nga Pejgamberi, salallahu alejhi ue selam: "Dexhalli do ta thërrasë një person, i cili është në kulmin e rinisë së tij dhe do ta godasë atë me shpatë, duke e prerë atë në dy pjesë, sikur goditja e shënjestrës. Pastaj, Dexhalli do ta thërrasë të riun. I riu do të përgjigjet, me fytyrë vezulluese dhe duke qeshur." (Muslimi)

12. Malik bin Huvejrith (radiallahu anhu), transmeton: "Ne erdhëm te Pejgamberi, salallahu alejhi ue selam, derisa ishim të rinj me moshë të ngjashme. Qëndruam pranë tij për njëzet ditë dhe net. I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selam, ishte i mëshirshëm dhe i butë. Kur mendoi se ne mërziqeshim për familjet tona në vështirësi, na pyeti se çfarë kishim lënë prapa dhe ne e informuam. Pejgamberi, salallahu alejhi ue selam, tha: "Kthehuni te familjet tuaja, jetoni me to, mësoni ata, thirrni ata," dhe ai përmendi edhe disa gjëra të tjera: "Faluni, ashtu siç më shihni mua duke u falur. Kur të afrohet koha e namazit, atëherë njëri prej jush duhet ta thërrasë thirrjen e namazit (ezanin) dhe më i vjetri nga mes i juaj le të udhëheqë në namaz." (Buhari)

Lusim Allahun e Lartësuar me emrat e Tij më të bukur dhe me cilësitë e Tij më të larta që ta mbrojnë rininë tonë nga trillimet e sprovave dhe t'i bëjë prej udhëzuesve të udhëzuar, mbrojtësve të Islamit me udhëzim dhe dritë prej Zotit tonë, derisa ta takojmë Atë, duke qenë i kënaqur me ne.









NJË DITË PESHKIMI NË DAJLANAT  
E SHKODRËS, MARUBI 1929

# FOTOJA E MUJAJIT





# Një Ajet

*Me emrin e Allahut,  
të Gjithëmëshirshmit, Mëshirplotit!*

**“Dhe kështu, Ne i dhamë Jusufit pozitë në atë vend dhe ai kishte çfarë të dëshironte. Ne e shpërblejmë me mëshirën Tonë, kë të duam dhe punëmirëve nuk ua humbim shpërblimin.”** (Jusuf, 56)

Surja Jusuf fillon me një ëndërr të Jusufit (a.s.), që ia tregon babait, Jakubit (a.s.). Jusufi (a.s.), shikon në ëndërr njëmbëdhjetë yje, diellin dhe hënën duke i bërë sexhde. Kjo ëndërr simbolizonte jetën dhe pozitën që do të arrinte Jusufi (a.s.). Nga ky këndvështrim, çdonjëri prej nesh është një Jusuf, sepse të gjithë kemi ëndrra për të ardhmen dhe jetën e programojmë në përmbushjen e kësaj ëndrre.

Smira për suksesin e të tjerëve ka ekzistuar gjithmonë dhe kësaj nuk do t'i shpëtonte as Jusufi (a.s.). Për këtë arsye, Jakubi i kërkoi ta mbante sekret ëndrrën, të mos e ndante as me vëllezërit e tij. Nga kjo, kuptojmë kujdesin e Jakubit (a.s.), për të mos i dhënë mundësi shfaqjes së zilisë midis fëmijëve. Në të njëjtën kohë, na paralajmëron se tradhtia mund të vijë edhe nga njerëz shumë të afërt. Ajo, së cilës i frikësohej më së shumti Jakubi, i ndodhi Jusufit (a.s.). Jusufi (a.s.), ra pre e tradhtisë së vëllezërve të vet. Ndër alternativat për t'i bërë keq Jusufit (a.s.), ishte edhe eliminimi fizik i tij, por në fund vendosën ta braktisnin, duke e hedhur në një pus. Kur u paraqitën tek babai, Jakubi (a.s.), sollën argument të rremë, duke thënë se e hëngri ujku. Jusufin (a.s.), e gjeti një karvan që shkonte për Egjipt, e morën dhe ia shitën një nënpunësi të lartë në mbretëri në tregun e skllëvërve. **“Dhe kështu, Ne e vendosëm Jusufin në atë tokë të bukur dhe i mësuam shpjegimin e ëndrrave. Allahu ka kontroll dhe fuqi të plotë mbi çështjet e Tij, por shumica e njerëzve nuk e dinë.”** Jusufi (a.s.), shpëtoi nga kurthi i vëllezërve, duke u vendosur i sigurt në Egjipt, por jo nga sprovat e kësaj bote. Pasi vendoset në shtëpinë e vezirit, zonja e shtëpisë kërkon ta joshë, por nderi i Jusufit (a.s.), i qëndroi tundimit. **Ai tha: “O Zoti im, më shumë dua burgun se atë ku më shtyjnë ato. Nëse Ti nuk e largon prej meje dredhinë e tyre, unë do të prirem drejt atyre dhe do të bëhem nga ata që nuk (i) dinë (ligjet e Tua).”** (Jusuf, 33)

Jusufi (a.s.), megjithëse i pafajshëm, dënohet me burgim disa vjet. Pas interpretimit të saktë që i bën ëndrës së mbretit, nxirret nga burgu dhe emërohet përgjegjës për thesarin dhe rezervat e mbretërisë. **“Dhe kështu, Ne i dhamë Jusufit pozitë në atë vend dhe ai kishte çfarë të dëshironte. Ne e shpërblejmë me mëshirën Tonë, kë të duam dhe punëmirëve nuk ua humbim shpërblimin. Ndërsa shpërblimi i jetës tjetër është më i mirë për ata që besojnë dhe e kanë frikë Allahun.”** (Jusuf, 56-57)

Këto janë vetëm disa fragmente të zgjedhura nga tregimi i Jusufit (a.s.), por nga sa treguam, mund të nxjerrim këto përfundime:

Në pamje të parë, e ardhmja e Jusufit (a.s.), duket si e pashpresë: në fillim e hedhin vëllezërit në pus, ata që e gjejnë e shesin me një çmim të lirë në tregun e skllëvërve, mbas kësaj e ndjek burgu disaveçar. Të gjitha këto, janë prova shumë të mëdha në jetën e një njeriu. Por mbas gjithë këtyre fatkeqësive, Allahu, i cili nxjerr të gjallën nga e vdekura, po përgatiste të ardhmen e ndritur të Jusufit (a.s.).

Me këtë kuptojmë që disa dukuri, që mund të na duken të këqija apo të dëmshme, jo gjithmonë janë kështu dhe e kundërta. **“Por mund ta urreni një gjë, ndërkohë që ajo është e mirë për ju e mund ta doni një gjë, ndërkohë që ajo është e dëmshme për ju. Allahu di, kurse ju nuk dini.”** (Bekare, 216)

Mbas çdo fenomeni qëndron fuqia hyjnore dhe përcaktimin e Krijuesit nuk mund ta pengojë askush. Përfundimi i ngjarjeve do të jetë gjithmonë sipas përcaktimit të Allahut.

Si përfundim, në një mënyrë apo një tjetër, ne përsërisim jetën e Jusufit (a.s.). Vullneti i Allahut zbatohet mbi çdonjërin prej nesh, sepse Allahu është Zotëruesi i gjithë Pushtetit!

**“Ti ia jep pushtetin kujt të duash dhe ia heq kujt të duash; Ti lartëson kë të duash dhe poshtëron kë të duash. Çdo e mirë është në Dorën Tëndë! Ti je vërtet i Plotfuqishëm për çdo gjë.”**



# Një Hadith

*Transmetohet nga Ebu Hurejra (r.a.)  
se Resulullahi (s.a.v.s.) i ka thënë:*



*“Kush beson Allahun dhe ditën e fundit, le të thotë fjalë të mira ose të heshtë!”*

Ky hadith përmban shumë urtësi të vyera. Është një hadith që duhet të jetë moto, jo vetëm për individin e thjeshtë, por edhe për shoqërinë në përgjithësi. Në fenë islame është parësore të qenët i dobishëm për njerëzit. Nëse nuk mundesh të jesh i dobishëm për njerëzinë, të paktën mos u bëj i dëmshëm për të. Për një shoqëri në harmoni është i domosdoshëm distancimi prej fjalëve të kota dhe kjo arrihet, sipas hadithit, ose duke folur fjalë të mira e të dobishme, ose duke heshtur. Komunikimi është thelbësor për zhvillimin e shëndoshë të çdo shoqërie e, rrjedhimisht edhe të vetë individit, si qenie njerëzore. Komunikimi zhvillohet duke i bërë shprehi fjalët e mira, fjalët e bukura dhe duke u larguar sa të mundemi nga thashethemet e ofendimet. Në një shoqëri, ku dominojnë thashethemet, shpifjet dhe ofendimet, nuk mund të ekzistojë një komunikim konstruktiv ndërnjerëzor. Në një shoqëri ku mungon fjala e mirë, sundon e keqja. Prandaj, kush dëshiron të flasë, së pari duhet të mendohet për pasojën që mund të ketë fjala. Nëse është e dobishme, duhet të flasë dhe, nëse jo, atëherë është më mirë të heshtë. Duhet të jemi të përgjegjshëm për çdo fjalë të thënë, sepse për çdo fjalë të thënë do të gjykohemi. Siç e pohon edhe ajeti kuranor: **“Për çdo fjalë që ai thotë, ka pranë vetes një mbikëqyrës të gatshëm (për ta shënuar atë).”** (Kaf, 18)

Ata që besojnë Allahun dhe ditën e gjykimit, ndjejnë një përgjegjësi të madhe për çdo sjellje apo fjalë që shprehin. Siç dihet, disiplina është e lidhur ngushtë me besimin në ditën e gjykimit, sepse një njeri që beson ditën e gjykimit dhe pasojat që vijnë pas gjykimit, si dënimi apo shpërblimi, përpiqet me gjithë mundësitë e veta për të mos bërë asnjë vepër, që është në dëm të tij në ditën e gjykimit, duke filluar me ruajtjen e gjuhës nga fjalët që mund të jenë fyese, përçarëse e dashakeqëse, të cilat bëjnë të mundur humbjen e besimit ndër njerëz.

## **Mësimet që nxjerrim nga hadithi:**

1. Fjala e mirë ose, në të kundërt, preferohet heshtja.
2. Fjala e mirë ose heshtja, tregojnë përsosjen e besimit.
3. Pejgamberi (a.s.), përdor metoda të ndryshme sipas temës.

# Nga lulishita e zemrës

Osman Nuri Topbash



Nga morali shembullor i të dashurve të Allahut

## NDJEKJA E PROFETIT (A.S.), ME DASHURI DHE BINDJE

Që feja të jetohet me dashuri, emocion, paqe dhe hijeshi, është e domosdoshme që Kurani dhe Suneti të zënë vend në çdo pjesë të saj. Dhe mënyra më e mirë për të arritur një përsosmëri të tillë shpirtërore, është mbushja e zemrës me **“dashuri”**, sepse dashuria sjell me vete edhe bindjen edhe sakrificën. Gjithashtu, edhe lidhja shpirtërore midis zemrave, mund të ndërtohet vetëm në sajë të dashurisë.

Njëri prej sahabëve të nderuar, Enes ibën Malik (r.a.), tregon:

Një njeri erdhi te Profeti (a.s.) dhe e pyeti:

“O i Dërguar i Allahut! Kur është dita e kijametit?”

Profeti (a.s.), e pyet duke i thënë:

“Çfarë ke përgatitur për ditën e kijametit?”

Njeriu përgjigjet:

“Dashurinë për Allahun dhe të Dërguarin e Tij...”

Pas këtyre fjalëve, Profeti ynë (a.s.), thotë:

“Atëherë, ti do të jesh me atë që do”.

Në vazhdim të këtij transmetimi, Enesi (r.a.), thotë:

“Përveç hyrjes në islam, asgjë tjetër nuk na kishte gëzuar më shumë se fjala e të Dërguarit të Allahut: “Atëherë, ti do të jesh me atë që do”. Prandaj dhe unë e dua Allahun, të Dërguarin e Tij, Ebu Bekrin dhe Omerin. Megjithëse nuk kam bërë aq sa kanë bërë ata, shpresoj që të jem së bashku me ta.” (Muslim, Birr, 163.)

Profetin (a.s.), mund ta njohim aq sa dashuri ndjejmë për të dhe aq sa mund t’i afrohem atij, sepse, dashuria midis dy të dashuruarve, përjetohet aq sa është edhe forca e dashurisë. Pra, edhe hadithi “Njeriu është me atë që do”. (Buhari, Edeb, 96.), shpreh këtë bashkim

zembrash. I dashuruari, i ngjan të dashurit dhe merr pjesë prej karakterit të tij, vetëm në masën e dashurisë që ndjen për të. Përfitimi shpirtëror më i mirë që duhet të marrim prej të Dërguarit të Allahut (a.s.), është bashkimi i botës sonë të brendshme me ndjenjat e tij shpirtërore.

### ME SYRIN E ZEMRËS SË EBU BEKRIT (R.A.)

Kur dashuria arrin nivelet më të larta, atëherë del në pah edhe miqësia e vërtetë. Dhe në mes të gjithë njerëzve, ai që ka arritur nivelin më të lartë të miqësisë me Profetin (a.s.), padyshim që është Ebu Bekri (r.a.). Për shkak se përjetimi i dashurisë së Ebu Bekrit (r.a.), për Profetin (a.s.), ishte në nivelin më të lartë, ai sakrifikoji pasurinë, shpirtin dhe çdo gjë tjetër për të. Sakrificat që bënte me gjithë shpirt për Profetin (a.s.), ishin kthyer në lumturinë më të madhe të jetës së tij. Dhe si rezultat i horizontit të gjerë të dashurisë që ndjente për të, ka thënë:

“Nga kjo botë, më janë bërë të dashura vetëm tri gjëra:

- Shikimi i fytyrës së Profetit (a.s.),
- Martesa e vajzës sime me të,
- Shpenzimi i pasurisë në rrugën e tij.”

Shpenzimi pa kufi i çdo gjëje për Allahun dhe të Dërguarin e Tij, e ngriti ëmbëlsinë e besimit të Ebu Bekrit (r.a.), në nivelet më të larta. Ebu Bekri (r.a.), ishte aq i lidhur me Profetin (a.s.), sa që edhe pas vdekjes, ai e mbante të gjallë në zemrën e tij. Madje, tek Ebu Bekri (r.a.), ishte e mundur të ndjeje edhe frymën e Profetit (a.s.). Këtë gjendje të Ebu Bekrit (r.a.), na e tregon Ebu Hurejre (r.a.):



“Një ditë, Ebu Bekri (r.a.), doli në minber dhe tha:

- Siç e dini, vitin e kaluar i Dërguari i Allahut (a.s.), qëndronte midis jush, ashtu siç po qëndroj edhe unë... Pas këtyre fjalëve, nga sytë e tij rrodhën lot. I përsëriti këto fjalë, por lemza i zuri fytyrës. Kur e përsëriti për herë të tretë, nuk e mbajti dot veten dhe filloi të qante.” (Shih. Tirmidhi, Deauat, 105)

Edhe zemrat e ndritura, që e njihnin dashurinë e madhe të këtij sahabiu për Profetin (a.s.), në çdo rast mundoheshin të përfitonin prej tij. Me kujtimet e Profetit (a.s.), mundoheshin sadopak të shuanin mallin që kishin për të.

Një prej sahabëve të nderuar, Berabin Adhib (r.a.), na tregon kështu për dëshirën e madhe të babait të tij për të dëgjuar ndonjë prej kujtimeve të Profetit (a.s.):

“Ebu Bekri (r.a.), bleu një samar prej babait tim dhe m’u lut ta çoja deri në shtëpinë e tij. Por babai kundërshtoi, duke thënë:

- Jo! Kjo nuk është e mundur, nëse nuk më tregon se si bëtë hixhret me të Dërguarin e Allahut nga Meka në Medinë, ndërkohë që po ju ndiqnin mushrikët.

Pas kësaj Ebu Bekri (r.a.), tregoi udhëtimin e hixhretit. (Shih. Buhari, Ashabu’n-Nebi, 2.; Ahmed, I, 2)

Sa bukur e pasqyrojnë

dashurinë për Profetin (a.s.), këto fjalë të Ebu Bekrit (r.a.):

“Dashuria për Profetin (a.s.), është më e vlefshme se jeta askete dhe lufta në rrugë të Allahut.” (Bagdadi, Tarihu Bagdad, VII, 161)

## NJË DASHURI MË E SHENJTË SE JETA...

Dashuria e sahabëve për Profetin (a.s.), kishte arritur në nivele aq të larta, saqë edhe sakrifkimin e jetës së tyre e konsideronin si një borxh ndaj tij. Disa nga shembujt më të mahnitshëm që e vërtetojnë këtë, janë përjetuar në luftën e Uhudit, në momentet kur ushtria islame u përça për pak çaste. Një grup prej mushrikëve, që përfituan prej rrëmujës dhe përçarjes, sulmuan me egërsi duke synuar të vrasin të Dërguarin e Allahut (a.s.). Një pjesë prej sahabëve, të përbërë prej Muhaxhirëve dhe Ensarëve, e rrethuan Profetin (a.s.), me qëllim që ta mbronin. Ata u betuan se, po të ishte nevoja, do të jepnin edhe jetën për të. Pastaj i dhanë besën Profetit (a.s.), duke thënë:

“Fytyra ime, mburojë mbi fytyrën tënde. Trupi im u sakrifikoftë për trupin tënd! Paqja e Allahut qoftë gjithmonë me ty! Nuk do të ndahemi asnjëherë prej teje.” Pastaj luftuan me gjithë fuqinë që kishin. (Ibën Sa’d, II, 46.; Uakidi, I, 240)

Ebu Talha (r.a.), ishte një har-këtar që e tërhiqte fort harkun



*“Fytyra ime,  
mburojë mbi fytyrën tënde.  
Trupi im u sakrifikoftë  
për trupin tënd!  
Paqja e Allahut qoftë  
gjithmonë me ty! Nuk do të ndahemi  
asnjëherë prej teje.”*



e tij. Gjatë luftës së Uhudit, për shkak të entuziazmit që i jepte besimi, në dorën e tij u thyen dy-tre harqe. Ndërsa i Dërguari i Allahut, këdo që kalonte pranë tij me torbën e shigjetave në sup, e urdhëronte:

*“Zbraze torbën e shigjetave pranë Ebu Talhasë!”* Profeti (a.s.), qëndronte mbas Ebu Talhasë dhe, sa herë që ngrinte kokën për të parë mushrikët, Ebu Talha, thoshte:

*“Të qofshin falë nëna dhe babai im, o Resulullah! Mos e ngri kokën! Kam frikë se mos të godet ndonjë prej shigjetave të mushrikëve. Gjoksi im le të jetë mburojë për gjoksin tënd. Ajo që do të prekë ty, le të më prekë mua!”* (Buhari, Megazi, 18)

Edhe Sa’d bin Ebi Uakkas (r.a.), qëndronte pranë Profetit (a.s.) dhe pa pushim gjuante me shigjeta mbi armikun. Ndërsa Profeti (a.s.), për shkak të sakrificës së tij thoshte:

*“Qëll o Sa’d! Të qofshin falë babai dhe nëna ime!”* Këto fjalë i dëgjoji edhe Aliu (r.a.), i cili u shpreh kështu:

*“Unë nuk e kam dëgjuar kurrë Profetin (a.s.), që përveç Sa’dit t’i thotë dikujt tjetër: “Të qofshin falë babai dhe nëna ime!”* (Tirmidhi, Edeb 61, Menakib 26.; Ahmed, I, 92)

Në fund të luftës së Uhudit, Profeti (a.s.), u bë merak për gjendjen e Sa’d bin Rebisë, njërit prej sahabëve, të cilin e donte shumë. Prandaj, urdhëroi një prej sahabëve që të shkonte e ta kërkonte në fushëbetejë. Sahabiu kërkonte shumë, por nuk mundi ta gjejë Sa’din. Kur ishte duke u kthyer, me një shpresë të fundit thërret:

*“O Sa’d! Më ka dërguar Profeti. Ai më urdhëroi që ta njoftoja nëse je gjallë apo ke rënë shëhid!”*

Në atë moment, Sa’di që po përjetonte çastet e fundit dhe nuk kishte fuqi për të përgjigjej, kur dëgjoji se Profeti ishte bërë merak për të, mblodhi veten dhe tha:

*“Tashmë jam midis të vdekurve!”* Sahabiu që po e kërkonte shkoi menjëherë pranë Sa’dit dhe e gjeti atë me trup të shpuar e të prerë prej goditjeve të shpatave. Sa’di, duke pëshpëritur fjalët e fundit, tha:

*“Për Allahun! Edhe sikur t’ju ketë ngelur fuqi vetëm*

sa për të lëvizur sytë, nëse nuk e mbroni Resulullahun prej armiqve, por e lini t’i ndodhë ndonjë e keqe, nuk do të kenë asnjë të drejtë të justifikoheni përpara Allahut!” (Muuatta, Xhihad, 41.; Hakim, III, 221/4906.; Ibën Hisham, III, 47.)

Sulmet që i janë bërë sulltanit të profetëve, të dashurit tonë (a.s.), kur ishte ende gjallë, në mënyra dhe kamuflazhe të ndryshme, shpeshherë po vihen re edhe në ditët tona. Sahabët e mbrojtën Profetin (a.s.), me jetët e tyre. Prandaj edhe ne në ditët e sotme duhet t’i dalim për zot trashëgimisë së bekuar të Profetit tonë (a.s.). Kjo është detyra jonë si umeti i Muhamedit (a.s.).

Të mos harrojmë se profetët nuk lanë trashëgimi materiale. Trashëgimia e vërtetë që i ka ngelur umetit prej Profetit (a.s.), është karakteri, personaliteti dhe devotshmëria e tij. Ndërsa dy amanetet e tij më të mëdha, janë Kurani Kerim dhe Suneti i tij. Mbrojtja e kësaj trashëgimie dhe e këtyre amaneteve, është e mundur vetëm duke u edukuar me moralin e tij, duke jetuar një jetë të devotshme dhe duke e përfaqësuar atë, Profetin (a.s.), në çdo vend dhe kohë ashtu siç e meriton. Nuk duhet të harrojmë se edhe kjo është një sprovë për besimin dhe devotshmërinë tonë.

Shpirti i bekuar i Profetit tonë të dashur (a.s.), është djegur e përvëlur për dertet e umetit të tij. Gjatë gjithë jetës, Ai është përpjekur dhe ka punuar për shpëtimin e njerëzimit. Ka shpërndarë dashuri dhe është bërë ortak në vuajtjet e popullit të tij. Gjithmonë është gjendur pranë të hidhëruarve dhe të varfërve. Në këtë mënyrë, me ndihmën e Allahut, ai arriti të edukonte një shoqëri sahabësh që e donin më shumë se shpirtin e tyre.

Mesazhi që na vjen prej Profetit tonë të dashur (a.s.), është: **“Njeriu, të cilit i kemi zgjidhur hallet dhe shoqëria ku kemi shpërndarë dashuri, është e jona”.**

Ja pra, sahabët që u edukuan në një atmosferë të tillë dashurie, e kishin kënaqësi të jepnin edhe shpirtin e tyre për Profetin (a.s.), duke thënë: *“Të qofshin falë nëna dhe babai im, o Resulullah!”* Njërin prej shembujve të panumërt të këtij fakti, e shohim edhe në ngjarjen e Rexhit:

Profeti (a.s.), e kishte zakon të dërgonte mësues në



fiset përreth, me qëllim që t'u mësonin islam. Dy nga fiset që kishin kërkuar mësuës, ishin edhe fiset Adal dhe Kare. Për këtë arsye, një grup prej dhjetë vetave doli në udhë për të shkuar tek këto fise. Mirëpo, gjatë udhëtimit, grupi ra në pusi dhe tetë prej mësuësve ranë shehidë, ndërsa dy të tjerë u kapën rob. Dy mësuësit që ranë rob, ishin Zejdi dhe Hubejbi (r.anhuma.). Që të dy iu dorëzuan mushrikëve të Mekes, të cilët më pas i vranë. Por para se ta vrisnin, mushrikët i thanë Hubejbit (r.a.):

"A do të dëshiroje që tani në vendin tënd të ishte Profeti dhe ti të shpëtoje?"

Hubejbi (r.a.), me keqardhje për Ebu Sufjanin, i cili i bëri edhe pyetjen, tha:

"Jo vetëm që nuk dua që Profeti të jetë në vendin tim dhe unë të jem me familjen dhe fëmijët e mi, por unë nuk dëshiroj që as një gjemb ta shpojë këmbën Profetit, për të shpëtuar unë".

Ebu Sufjani, i cili u shtang i mahnitur nga kjo skenë e pashembullt dashurie, tha:

"Me të vërtetë e mahnitshme! Në këtë botë, ende nuk kam parë dy njerëz që të duhen ashtu siç e duan sahabët Muhamedin." (Uakidi, I, 360; IbënSa'd, II, 56)

Shumë prej studiuesve të huaj, të cilët e kanë studiuar jetën e Profetit tonë (a.s.), me objektivitet, nuk kanë arritur ta fshehin mahnitjen e tyre. Shkrimtari perëndimor, Thomas Carlyle, rrëfen:

"Asnjë perandor me kurorë në kokë, nuk ka parë kaq dashuri dhe respekt sa Muhamedi (a.s.), që vishte rroba, arnat e të cilave i qepte me dorën e vet."

I vetmi kusht që duhet të plotësohet për ta njohur në kuptimin e vërtetë të fjalës dhe për të përfituruar prej tij ashtu siç e meriton, është dashuria dhe respekti që tregohet ndaj tij. Asnjë dashuri tjetër në zemrën e sahabëve, nuk e kaloi dashurinë për Allahun dhe të Dërguarin e Tij. As dashuria për pasurinë, as ajo për fëmijët dhe familjen dhe as dashuria për jetën e vet... Të gjitha këto do të ngeleshin në këtë botë, ndërsa dashuria për Allahun dhe të Dërguarin e Tij, do të bëheshin kapitali i shpirtit të tyre për arritjen e lumturisë së përjetshme.

## NËSE E DONI ALLAHUN...

Hasan Basriu (Allahu e mëshiroftë), transmeton:

"Sahabët e nderuar i thanë Profetit (a.s.):

- O i Dërguar i Allahut! Ne e duam shumë Allahun

Teala. Mirëpo, a na thua se cili është treguesi i dashurisë së vërtetë për Allahun?

Për këtë arsye, Allahu Teala zbriti një ajet fisnik, në të cilin thuhet:

**Thuaju (o Muhamed): "Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t'ju dojë dhe t'jua falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë".** (Al-i Imran, 31) (Shih.Taberi, *Xhamiu'l-Bejan*, nr. 6845, 6846)

Pra, dashuria për Profetin (a.s.), do ta bëjë njeriun të arrijë edhe dashurinë e Allahut Teala, sepse dashuria për Profetin (a.s.), është dashuri për Allahun. Bindja ndaj tij, është bindje ndaj Allahut. Ndërsa kundërshtimi i tij, është kundërshtimi i Allahut.

I nderuari Alaeddin Konevi, me qëllim që nxënësit e tij të ndiqnin rrugën e Profetit (a.s.) dhe ta respektonin atë, u vuri këto kushte:

1. Të bënë salavate, sa herë që përmendësh emri i bekuar i Profetit (a.s.).

2. Të tregonin edukatë dhe të mos e ngrinin zërin gjatë vizitës së varrit të Profetit (a.s.).

3. Të respektonin Medinë-i Muneueren, që është edhe qyteti i Resulullahut dhe të gostitnin popullin e saj.

4. Të ruheshin nga gjërat që e ulin vlerën e fjalëve dhe veprave të Profetit (a.s.). P.sh., kur të përmendësh se Profeti (a.s.), e pëlqente diçka, menjëherë në zemrat e tyre të zgjohej ndjenja e dashurisë për të njëjtën gjë.

5. Të mos vendosnin libra të tjerë apo sende të ndryshme mbi Kuranin dhe librat e haditheve.

6. Të mos e hidhnin apo të grisnin një letër, në të cilën ishte shkruar emri i Allahut ose i Profetit (a.s.). Madje, të tregonin respekt për çdo libër të fesë. Nëse ato nuk do t'i përdornin më, t'i groposnin në një vend ku nuk shkelej ose t'i digjin.

## SALAVATET FISNIKE

Njeriu që dashuron dikë, e imiton atë aq sa dashuri ndjen për të. Nuk e nxjerr atë nga zemra dhe nuk e lëshon nga gjuha. Dhe treguesi më i mirë i një lidhje të tillë shpirtërore me Profetin (a.s.), është përkujtimi i tij me salavate. Ndërsa e kundërta e kësaj, të çon në një humbje të madhe shpirtërore. Nga Ebu Hurejre (r.a.), transmetohet se i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: "Ai që nuk bën salavat për mua, kur pranë tij përmendet emri

im, është i humbur dhe i nënçmuar.” (Rijadu’s-Salihin, fq.20, 1408.)

Ndërsa, në disa hadithe të tjerë, transmetohet se Profeti (a.s.), ka thënë:

“Koprrac është ai që, megjithëse përmendem pranë tij, nuk bie salavat për mua.” (Tirmidhi, Deauat, 100.)

“Kush harron të bie salavate ndaj meje, ngatërron rru-gën për në Xhenet.” (Ibën Maxhe, Ikamet, 25.)

Ja pra, kaq të rëndësishme janë salavatet fisnike! Madje edhe gjatë faljes së namazit, kur ulemi për Tahijatin, jemi urdhëruar të bëjmë salavate dhe t’i japim selam të dashurit tonë, të Dërguarit të Allahut (a.s.). Megjithëse dhënia selam dikujt gjatë namazit është prej gjërave që e prishin namazin, Allahu Teala, e ka bërë dhënien e selamit për Profetin (a.s.), prej rukneve vaxhib të namazit.

I nderuari Imam Gazali, ka thënë:

“Gjatë teshehudit në namaz, mundohu të përfytyrosh fytyrën e bukur dhe karakterin e lartë të Resulullahut (a.s.) dhe thuaj “es-salatuue’s- selamualejke ja Resulallah!” Të jesh i sigurt se selami yt do t’i shkojë të dërguarit të Allahut dhe ai do të të përgjigjet në një mënyrë edhe më të bukur”. (Ihja’u- Ulumi’d-Din, I, 224.)

## DELIKATESA E OSMANLLINJVE NË DASHURINË NDAJ PROFETIT (A.S.)

Të parët tanë, Osmanllinjët, treguan një dashuri dhe bindje të thellë ndaj Kuranit dhe Sunetit, mbajtën lart flamujt e Islamit për gjashtëqind vjet, duke i treguar botës mirësitë e Islamit dhe u bënë flamurtarë të lirisë dhe drejtësisë. Mirëpo, ndjenjat e dashurisë dhe respektit që kishin ndaj Profetit tonë të dashur (a.s.), ishin më madhështore se qytetërimi që ngritën.

Kubenë e parë mbi varrin e Profetit (a.s.), të cilën dëshiron ta vizitojë nga afër çdo i përmalluar për Profetin (a.s.), e ka ndërtuar Sulltani Memluk Kajëtbaj. Ndërsa nderin e restaurimit të xhamisë së Profetit (a.s.) dhe ndërtimit të kubesë së gjelbër që shohim sot, e ka pasur njëri prej Sulltanëve Osmanlli, Mahmudi i II.

Kur u bë fjalë për restaurimin e kubesë, Mahmudi II dërgoi arkitektët dhe ustallarët më profesionistë prej Stambollit. Arkitektët dhe ustallarët u menduan

thellë para se të fillonin nga puna, sepse do t’u duhej të ngjiteshin mbi kubënë ekzistuese, të hiqnin tullat dhe më pas, ta ndërtonin nga e para. Kjo detyrë duhej të realizohej me delikatesë të madhe, pa bërë asnjë veprim që do ta shqetësonte shpirtin e bekuar të Profetit (a.s.). Pasi u konsultuan gjerë e gjatë, më në fund morën një vendim:

“Gjatë punës së ndërtimit nuk duhet të flasim asnjë fjalë të kësaj bote. P.sh., Kur të kemi nevojë për tulla, të themi “Allah!”, kur të duam ujë, të themi “Bismillah!”, kur të kërkojmë çekiçin, të themi “La ilahe il-lall-llah!” e kështu me radhë...

Ja pra, Kubbe-i Hadra / Kubeja e gjelbërt, u ndërtua me madhësi dhe respekt, në një atmosferë të tillë shpirtërore. Gjithashtu, edhe ustallarët që punuan në restaurimin e Mesxhidit Nebevi, çdo gur e vendosën duke qenë me abdest dhe duke thënë bismillah. Mad-

je, kur duhej të ngulej një gozhdë, me qëllim që të mos bëhej zhurmë, i veshën çekiçët me shajak.

Në librin me kujtime “Tajjibetu’l-Edhkar”, që u shkrua në fund të shekullit të 18-të nga Dervishi Ahmed Peshkarizade, në lidhje me edukatën, respektin dhe delikatesën që është treguar në Ravza-i Mutahhara<sup>1</sup>, tregohet:

“Pasi largohej xhemati i namazit të jacisë, agallarët e ngarkuar me detyrë tek Ravza, me një fener në dorë, shëtisnin Haremin

Sherif qoshe më qoshe dhe, kur vinin tek Babu’s-Selam, mbyllnin derën. Nëse vihej re dikush që ishte ende brenda në mesxhid, i bënë me shenjë që të dilte, duke thënë “Bismillah”, sepse në Haremi Sherif nuk fliteshin fjalë të kësaj bote. Nëse dikush gjendej afër varrit të Profetit (a.s.) edhe atij i bëhej me shenjë, duke thënë “La ilahe il-lall-llah!”.

Tri orë para lindjes së diellit, (kur hynte koha për namazin e natës), kryemuezini thërriste njëherë jashtë derës: “La ilahe il-lall-llah!” Me të dëgjuar këtë thirrje, roja që ndodhej brenda, thoshte: “Muhamedur-Rasulullah...”, pastaj hapte derën”.

Padyshim që në gjithë këtë delikatesë dhe edukatë që është treguar nga të parët tanë, gjenden mësimet të rëndësishme. Një nga këto, është edhe braktisja e

1. Vendi ku gjendet varri i Profetit (a.s.).



fjalëve të kota dhe boshe të kësaj bote, sidomos prej atyre që shkojnë në Haxh dhe Umre dhe vizitojnë varrin e Profetit (a.s.). Gjuhët dhe zemrat e tyre duhet t'i lajnë me përmendjen e Allahut dhe me qetësi e respekt të bëjnë salavate për Rasulullahun (a.s.).

Një banor i devotshmëm i Medine-i Muneuures, Zijaeddin Efendiu, i këshillonte kështu ata që vinin për të vizituar atë vend të bekuar:

“Ai që vjen në këtë vend, duhet të hyjë tek Ravza duke parë majat e këmbëve dhe në të njëjtën mënyrë duhet të kthehet në shtëpinë e tij”.

Pra, nuk duhet ta prishë gjendjen shpirtërore, duke menduar për punët e çarshisë dhe telashet e kësaj bote, por duhet të përqendrohet dhe të kujtojë se ndodhet në një vend të bekuar.

Një shembull tjetër i respektit dhe edukatës që kanë treguar të parët tanë ndaj Profetit (a.s.), është edhe ky:

Abdulhamit Hani i II, ndërtoi një hekurudhë që lidhte Stambollin me Medine-i Muneuuren. Stacionet i vendosi në vendet ku kishin bujtur Profeti (a.s.), gjatë udhëtimit të tij. Ndërsa stacionin e trenit të Medines, e vendosi rreth 2 km larg Ravzës dhe shinat e trenit që kalonin brenda Mendines, i veshi me shajak, me qëllim që të mos bënë zhurmë dhe për pasojë, të shqetësohej shpirti i bekuar i Profetit (a.s.).

Poeti Nabi, në një varg të një poezie të tij, e shpreh kështu ftesën për edukatë, respekt dhe dashuri ndaj Profetit (a.s.), që treguan Osmanlinjtë, të cilët u kujdesën jashtë mase për qytetet e shenjta:

“Ki kujdes edukatën! Ky është qyteti i të Dashurit të Allahut...”

Të parët tanë, që treguan shembuj të pashoq të respektit dhe dashurisë për të Dërguarin e Allahut në qytetet e shenjta, sollën edhe në qytetet e tyre zakone që mbanin frymën shpirtërore të Haramejnit (dy qyteteve të shenjta).

Për shkak të dashurisë ndaj Profetit (a.s.), dhe për të mbajtur besimin gjithmonë të gjallë dhe dinamik, ishte bërë zakon që prej personave të kualifikuar, të lexoheshin në xhami tre libra për xhematin. Në shenjë respekti, të tre këtyre librave, iu dha cilësia “Sherif”. Këta

libra ishin Buhari-i Sherif, Shifa-i Sherif dhe Mesnevi-i Sherif.

Osmanlinjtë, në themel të të cilëve gjendej respekti dhe lartësimi i Kuranit, treguan kujdes të veçantë dhe dashuri të pashoqe edhe në lidhje me **“emanetet e shenjta”**<sup>2</sup> Gjithashtu, Osmanlinjtë i quajtën ushtarët e tyre “Mehmetçik”, duke u dhënë mundësinë që sipas kapacitetit të vet, çdonjëri prej tyre të ndjente frymëzimin e të qenit një **“Muhamed”**.

Ndër zakonet e Osmanlinjve, zinin vend edhe festimet madhështore të Mevludeve. Aty silleshin qimja e mjekrës së bekuar të Profetit (a.s.), hurma prej Medine-i Muneuures, Zemez prej Meke-i Mukerremes dhe në një atmosferë të mbushur plot emocione, kujtohej Profeti (a.s.) dhe jeta e tij. Në një pjesë të Mevludit sherif, ku përfytyrohet lindja e Profetit (a.s.), i gjithë xhemati ngrihej në këmbë dhe këndonte salavate dhe selame për nder të Rasulullahut...

Në kohën e Osmanlinjve ishte bërë zakon që në xhamitë, që ishin ndërtuar nga sulltanët apo gratë e tyre, të gjendej një muezin i verbër. Kjo vazhdoi deri vonë në xhaminë Sulejmanije, Fatih dhe xhami të tjera si këto. Në të shumtën e rasteve, ky fakt pandehej si një rastësi, prandaj kalonte pa u vënë re. Mirëpo, ky zakon e kishte zanafillën në “epokën e lumturisë”. Në Mesxhidin Nebevi, përveç Bilali Habeshiut (r.a.), kryente detyrën e muezinit edhe sahabiu i verbër, Abdullah ibën

Umm-i Mektum (r.a.).

Pra, për të vazhduar këtë zakon të Profetit tonë të dashur (a.s.) dhe për të ngjallur sunetin e tij, të parët tanë, deri në kohët e vona kanë treguar kujdes të madh që në xhamitë e ndërtuara prej Sulltanëve apo grave të tyre, të mbajnë muezinë të verbër.

**Allahu Teala na bëftë nga ata që marrin shembull prej delikatesës dhe ndijesive shpirtërore të të parëve tanë! E bëftë të vazhdueshme lidhjen shpirtërore me Profetin (a.s.)! Sunetin e tij e bëftë boshtin e jetës sonë! Na faltë dhe na mëshiroftë për hatër të të Dashurit të tij!**

**Amin!..**

2. Sendë, veshje, bizhuteri, armë etj., që i përkisnin Profetit (a.s.), të afërmeve të tij dhe sahabëve.

Projektoje bisedën tënde:

# 21 teknika PËR KOMANDIMIN E BASHKËBISEDIMIT

*Altin Torba*



Teknika të mirëqena, që burojnë nga referenca të mirëfillta dhe që bëjnë të mundur afirmimin në artin e komandimit të bashkëbisedimit.

Referenca më madhështore, ku përftohen nocionet më të përsosura mbi çështjen e bashkëbisedimit, është Shpallja Hyjnore Islame me dy burimet madhore të saj, Kuranin famëlartë, Librin e Allahut dhe Traditën e të nderuarit tonë, profetit Muhamed (lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të!)

Teknikat e komandimit të bashkëbisedimit po i paraqesim në dy ekrane:

1. Ekranin e teknikave të prezantuara nga mesazhi hyjnor islam.

2. Ekranin e teknikave të marra nga referenca studimore-shkencore.

## **EKRANI I PREZANTIMIT HYJNOR:**

· Nga Ebu Umameh (r.a.), vjen se: Një i ri i erdhi Profetit (a.s.) dhe i tha: "O i Dërguar i Allahut, lejomë të bëj prostitucion!" Të pranishmit iu kanosën atij me zë. Profeti (a.s.), i tha: "Afrohu!" Djaloshi u afrua pranë tij. Profeti (a.s.), i tha: "Ulu!" Djaloshi u ul. Profeti (a.s.), i tha: "A e do atë (prostitucionin) për nënën tënde?!" Djaloshi tha: "Jo, për Allahun. Allahu më bëftë kurban për ty." Profeti (a.s.), i tha: "As njerëzit nuk e duan atë për nënën e tyre." E pyeti: "A e do atë për motrën tënde?!" Djaloshi tha: "Jo, për Allahun. Allahu më bëftë kurban për ty." Profeti (a.s.), i tha: "As njerëzit nuk e duan atë për motrat e tyre." I tha: "A e do atë për hallën tënde?!" Djaloshi tha: "Jo, për Allahun. Allahu më bëftë kurban për ty." Profeti (a.s.), i tha: "As njerëzit nuk e duan atë për hallat e tyre." I tha: "A e do atë për tezen tënde?!" Djaloshi tha: "Jo, për

Allahun. Allahu më bëftë kurban për ty." Profeti (a.s.), i tha: "As njerëzit nuk e duan atë për tezet e tyre." Sakaq, Profeti (a.s.), e vendosi dorën e tij mbi djalosin dhe tha: "O Allahu im, falja atij mëkatin, dëlirësoja zemrën dhe imunizoja organin e tij gjenital!" Paskëtaj, djaloshi nuk i hapi sytë pas gjëje. (Publikim i saktë i Ahmedit)

· Nga Enesi [Allahu qoftë i kënaqur me të!], vjen se ka thënë:

Profeti i Allahut (a.s.), ishte njeriu me moralin më të përsosur. Unë kam pasur një vëlla, që asokohe ende pinte gji e që thirrej Ebu Umejr. Kur Profeti (a.s.), vinte tek ne, i thoshte atij: "O Ebu Umejr, si i ka punët zogu?"; që ishte një zog i vogël, me të cilin im vëlla lozte. Kur Profeti (a.s.), ishte në shtëpinë tonë, ndodhte të vinte koha e namazit, me ç'rast ai na urdhëronte ta fshinim dhe shkundnim qilimin ku kish ndenjor, pastaj ngrihej të falej me ne dhe ne qëndronim pas tij. (Publikim i Bukhariut dhe Muslimit)

· Transmetohet se Utbe ibn Rabia bisedoi me Profetin e Allahut (a.s.) dhe i tha: "O djali i tim vëllai, ti e di pushtetin fisnor që ke ndër ne, si dhe pozitën shoqërore. I ke ardhur popullit tënd me një gjë të madhe, me të cilën përçave komunitetin e tyre, ua prishe ëndrrat dhe ua shave dhe cenove hyjnitë e tyre, duke rënë kështu në mohim të së shkuarës së etërve të tyre. Dëgjomë të të propozoj disa gjëra, ndoshta disa prej tyre i pranon. I Dërguari i Allahut (a.s.), i tha: "Fol o Ebu Uelid, po të dëgjoj." Utbeja tha atë që tha... Kur Utbeja mbaroi, Profeti (a.s.), iu drejtua: "A mbarove, o Ebu Uelid?" Po- i tha. Profeti (a.s.), i tha: "Dëgjomë mua!" Utbeja i tha: "Ashtu po bëj." Profeti i Allahut (a.s.), filloi t'i lexonte nga sureja Fusilet, deri kur arriti në thënien që ka sexhde,



ajeti 37, ku i tha Utbes: *"E dëgjove, o Utbe. Ti dhe kjo që dëgjove."* Utbeja shkoi tek shokët e tij, disa prej të cilëve thanë: "Betohemi në Allah, ka ardhur Ebu Uelidi me tjetër çehre nga ajo me të cilën shkoi." Utbeja u kërkoi atyre ta linin Muhamedin (a.s.), në punën e vet, gjë pas së cilës ata i thanë: "Të paska magjepsur me të folurën e tij, o Ebu Uelid. (Publikuar nga Ebu Jeale dhe Ibn Is'haku)

· Transmetohet se kurejshët dërguan te Profeti (a.s.), një nga krerët e tyre, pikërisht Husajn el Khauzein, i cili ishte prej kryepleqve dhe oratorëve të tyre. Detyra që kurejshët i ngarkuan atij, ishte të negocionte me Muhamedin (a.s.), lidhur me çështjen e cenimit të idhujve. Kur hyri te Profeti (a.s.), Husajni i tha: "O Muhamed, kam marrë vesh se ti i shan idhujt (zotat) tanë dhe na quan mendjelehtë. Babai dhe gjyshit y qenë më të garantuar dhe më në rregull. Profeti (a.s.), i tha: *"O Husajn, im atë dhe yt atë janë në zjarr. O Husajn, sa hyjni adhuron?"* I tha: "Shtatë, një në qiell dhe gjashtë në tokë." Profeti (a.s.), i tha: *"O Husajn, kur të kanoset uria dhe varfëria, kë lut?"* Iu përgjigj: "Atë që është në qiell?" Profeti (a.s.), i tha: *"Kur të humbet fëmija, cilit hyjni i lutesh?"* Tha: "Atij që është në qiell." Sakaq, i Dërguari i Allahut (a.s.), i tha: *"Ai një i vetëm ta përmbush lutjen dhe ti shoqëron me Të tjetërkënd!"* Në këtë moment, Husajni u zgjua dhe u bind mbi atë që i tha Profeti (a.s.). Profeti i ofroi atij Islamit, me ç'rast Husajni hyri në Islam. (Publikuar nga Tirmidhiu dhe Tabaraniu)

· Allahu i Lartësuar ka thënë: **"A nuk e ke parë atë (Nemrudin) që Allahu i dha pushtet** (e ai u tregua bukëshkalë me mirësitë e Allahut ndaj dhe), **ai (Nemrudi) polemizoi me Ibrahimin rreth Zotit të tij. Kur Ibrahim i tha: «Zoti im është Ai që jep jetë dhe vdekje!»**, **ai (Nemrudi) tha: «Edhe unë jap jetë dhe vdekje!» Ibrahim i tha: «Zoti im e sjell diellin nga lindja, sille pra ti atë nga perëndimi?!» Sakaq, ai që nuk besoi, mbeti i hutuar. Allahu nuk e shpie në rrugë të drejtë popullin zullumqar** (që dhunon të drejtat

e të tjerëve, e të drejtat më sublime janë të drejtat e Zotit Lavdiplotë." (Bekare: 258.)

· Këqyre me vërejtje historinë islame të ndalimit të alkoolit, sesi Islami e ndaloi gradualisht atë, me një metodë unike dhe tepër të arrirë, në përmbyllje të së cilës Allahu u komunikon të komunikuarve thënien e Tij: **"A po i jepni pra fund (alkoolit e bixhozit)?"!** (Maide: 91.)



*Ji i ndershëm në qëllimin tënd dhe dije se edhe në arrish t'i manipulosh njerëzit, kurrë s'do arrish ta manipulosh Zotin e njerëzve.*

Efekt i pozitiv i "ligjit të të vjelave", nuk vonon të dalë në pah, në përgjigjen e të komunikuarve, të cilët aty për aty u përgjigjën: "I dhamë fund, o Zoti ynë, i dhamë fund."

## EKRANI I TEKNIKAVE DIDAKTIKE

### 1. PYETJA MË E RËNDËSISHME:

Para se të fillosh të komunikosh me tjetrin, më thuaj sinqerisht:

Cili është qëllimi yt?

Bëj kujdes që synimi yt të mos jetë shpalosja e muskujve të tu ideologjikë?!

Ji i ndershëm në qëllimin tënd dhe dije se edhe në arrish t'i manipulosh njerëzit, kurrë s'do arrish ta manipulosh Zotin e njerëzve.

Allahu është Njohës i mirëfilltë i zemrave dhe i ka ato në dorë tërësisht.

Lute Allahun që në vazhdimësi të kesh një qëllim të denjë dhe të drejtë.

### 2. OBJEKTIVIZMI:

Përcakto objektivin ku synon të arrish, përcakto personin e duhur me të cilin të duhet të komunikosh për këtë, përcakto dhe përgatitu të jesh ti drejtuesi i bisedës dhe që ta latosh atë sipas transformimit të synuar, në përputhje me pikëpamjen dhe qëndrimin që ti do.

Pa këto përcaktime, do mbetesh pasiv dhe i komanduar.

### 3. SHIKIMI ME SYTË E TJETRIT:

Po deshe ta bartësh tjetrin nga qoshja e tij tek qoshja



jote,  
d u -  
het që të  
shohësh me  
sytë e tij.

Kjo bartje kërkon që, së pari, të shkosh ti tek qoshja e tij dhe më pas, të vijosh të ecësh me të, derisa ta stabilizosh te qoshja jote, në një formë të tillë që ai të besojë se tanimë ka gjetur qoshen e tij adekuate.

#### **4. FILLO ME PIKAT E PËRBASHKËTA:**

Jepi shanse vetes dhe tjetrit në njohjen sa më në detaje të pikave të përbashkëta dhe komunikimin tënd filloje pikërisht me to.

#### **5. DREJTO PYETJE TË HAPURA:**

Sa më e hapur të jetë pyetja, aq më shumë do të flitet dhe sa më shumë të flitet, aq më shumë mundësi komunikimi do të të hapen. Pyetja është burimi i stimulimit të vëmendjes, pasi ajo përmban në të elementin e të panjohurës dhe joshjes, që uni human i do së tepërmi.

#### **6. PREKJE DASHAMIRËSE:**

Vendosja e dorës mbi kraharor, fjalët e bukura, lutja, syri që sheh me dhembshuri, etj., përbëjnë shtimin e prekjeve magjike.

#### **7. BËJE TJETRIN TË NDJEJË SE TI SHQETËSOHESH DHE INTERESOHESH PËR TË:**

Sjellja modeste, buzëqeshja, përdorimi i nofkës së preferuar, të folurit sipas mendësisë dhe kapacitetit të tij..., kur merren si dhe sa duhet në konsideratë, e bëjnë tjetrin të ndjejë se për të po tregohet vërtet interes.

#### **8. NJOHJA E FORMIMIT KULTUROR TË TIJ:**

Ta pyesësh mbi interesat që ka, mbi shqetësimet, problemet dhe përshtypjet e tij, me qëllim që të de-

përtosh tek botëkuptimet e tij. Kjo zbrazje e bën atë të jetë konfident me ty, si pasojë e ndijesisë së tij se tanimë, ti ke goxha njohuri për të.

Në krahun tjetër, nga këtu ti përfiton informacionin e shumëkërkuar për të ndërtuar bazën e komunikimit, mbi të cilën mund të vijosh bashkëpunimin produktiv.

#### **9. EDUKATA:**

Sjellja me edukatë dhe nivel të lartë, pavarësisht dinivelit të tjetrit në moshë, dituri apo post, përbëjnë stimuluesin më efikas për tërheqjen e tij.

#### **10. BËJE VESHIN PIPËZ:**

Dëgjo më shumë dhe fol më pak. Mos e ndërpre tjetrin kur ai flet. Jepi tjetrit shansin ta shprehë atë që bluan brenda vetes, edhe në qoftë i gabuar.

#### **11. RESPEKTIMI:**

Dëgjimi i tjetrit me vëmendje, dhënia atij e shansit që “kovën e tij ta zbrazë tek e jotja” dhe drejtimi i të gjitha gjymtyrëve të tua kah ai, janë tregues se ti po i thua atij: “Unë të respektoj, pavarësisht këndvështrimeve të ndryshme që mund të kemi”. Bazamenti i respektimit qëndron mbi aksiomat: “Imponimi pjell opozitë”, ndërsa “Shëmbëlltyra sjell qasje”; që presupozojnë se në lirinë e zgjedhjes së tjetrit, mund të ndikosh vetëm duke qenë shembullor.

#### **12. VETPËRMBAJTJA:**

Pranimi ashtu siç është, çiltërsia, durimi dhe matura, të lejojnë t’i qasesh me efikasitet arsyes dhe mendësisë së tjetrit.

#### **13. MOS U ZEMËRO:**

Ky të jetë slogani yt, përsërite atë rishtas, me zemër dhe gojë.

Zemërimi pjell tension negativ në unin human dhe me të drejtë, është renditur tek “armët e shkatërrimit në masë”.

Zemërimi përbën izolatorin më fatal dhe zhurmuesin më turbullues, që pengojnë hyrjen e kthjellët të informacioneve në vetëdijen e njeriut. Zemërimi përbën faktorin më negativ të komunikimit. Nga ana tjetër, përmbajtja e zemërimit dhe fjalët e qeta, e bëjnë njeriun të jetë i balancuar dhe objektiv. Gjakftohtësia e ndriçon unin human, siç e ndriçon hëna e plotë terrin e natës.

#### **14. ORIENTIMI INDIREKT:**

Përbën një nga metodat më të shquara të komu-



nikimit. Nëse e bën atë çiltërsisht, duke synuar vetëm të mirën e tjetrit, atëherë ai do të kthehet nga ti dhe do e pranojë fjalën tënde. Orientimi indirekt është një metodë e shquar dhe ndjellëse, që ndihmon së tepërmi korrektimin e mendësive të tjetrit e, për më tepër, të jep aftësinë të bëhesh goja e tij. Impenjimi i tjetrit stimulohet sidomos me pyetje si ato të Profetit (a.s.): “Sa hyjni adhuron?... Kur të kanoset uria e varfëria dhe kur të humbet fëmija, cilës hyjni i lutesh?” Gjatë orientimit indirekt nuk duhet të harrojmë kurrë se: “Njerëzit i duan pa masë subjektet me të cilat janë lidhur shpirtërisht. Sado naivë qofshin këto subjekte, njerëzit i kanë vendosur ato në prioritetet e tyre jetike dhe nuk lejojnë askënd që t’i cenojë.”

### **15. KOMUNIKIMI I ARSYESHËM:**

Presupozon të bëhet ndarja midis problematikës dhe personit, nga ku ajo ka buruar. Vatra së cilës i drejtohet komunikimi, është vetëdija e tjetrit, bazuar në aksiomën “vetëdija e di dhe e do të vërtetën”. Kur ne arrijmë tek vetëdija e palës tjetër, kjo gjë e bën atë të reagojë pozitivisht. Kjo mënyrë sjelljeje, e kalit besimin e tjetrit dhe kultivon çiltërsinë, gjë që përbën elementin më thelbësor të komunikimit produktiv.

### **16. LËRE TJETRIN TA ZBULOJË VETË REALITETIN:**

Ai duhet ta zbulojë realitetin që e rrethon, jo t’ia zbulosh ti. Duke i përfutuar dhe analizuar informacionet vetvetiu, pa u ndikuar nga të tjerët dhe pa u komanduar nga lart, ai do ndihet më i besueshëm.

Akti yt i komunikimit duhet të bazohet tek argumentimi, arsyetimi dhe sinteza, në shpalosje të statuskuo-së tënde vizionare dhe objektive.

### **17. DËBIMI I “JO-SË” NGA KOMUNIKIMI:**

Pasja në majë të gjuhës e fjalës “jo”, tregon se ti je egoist dhe të nxjerr në gabim me të tjerët.

Kjo fjalë është fjala që të tjerët i thyen në mes, i rrënon, shton inatin e tyre dhe i bën ata t’i mëshojnë egos dhe kryeneçësisë së tyre.

Njeriu llërëpërveshur i shmanget “jo-së” në maksimum, ndaj dhe e gjen atë të përshkojë distanca të gjata sa vetë jeta.

Në konfirmim të këtij fakti vjen proverbi: “Fjala jo, është çekiçi mbi kokë.”

### **18. JI GUXIMTAR:**

Mos ki ndrojtje të thuash “nuk e di”, në një çështje që vërtet nuk e di, sepse kjo të bën të mbetesh në padituri, si dhe të mos tregosh çiltërsi.

Faktet flasin se sinqeriteti është arma më e fuqishme e bashkëbisedimit produktiv.

### **19. SHQETËSIMI YT TË JETË I VËRTETË:**

Synimi yt kapital të jetë arritja tek e vërteta.

Mbikëqyre zemrën tënde, kontrolloji tekat personale dhe kujdes me ndershmërinë e unit tënd, në bindjen që po adopton.

### **20. QASJA SHPIRTËRORE:**

Presupozon tolerancën dhe modestinë që e endin tjetrin të qaset sa më pranë teje, presupozon qëndrimin larg kanosjes dhe cenimit të tjetrit, qoftë edhe me fjalë apo gjeste, si dhe presupozon dashurinë e çiltër e të pakushtëzuar për të; gjëra këto që janë kritere kyçe të krijimit të afrimit shpirtëror.

### **21. LIGJI I TË VJELAVE:**

Për të konstatuar nëse metoda që përdore u takon apo jo teknikave inteligjente dhe dinamike të komunikimit, duhet që orvatja jote të finalizohet me pjekjen e vlerës që mbolle dhe me vjeljen e realizimit të asaj çfarë po synoje.

Një gjë e tillë realizohet vetëm kur arrin të hysh në mendjen e tjetrit me sjelljen që i vjen për shtat pronarit të kësaj mendjeje. Ky ligj apelon se reformimi i tjetrit arrihet përmes kontaktit shpirtëror me të.

- Këto janë teknikat që rrezatojnë komunikimin produktiv. Mësimi i tyre të mundëson të arrish ta komandosh drejt bashkëbisedimin dhe prej këndeje, me lejen e Zotit, të komandosh suksesin.





“...marrë frymë  
ajrin e atdheut”

Xhahid Bushati

- Ese për lirishtetësin, mendimtarin e lirë, ushtarakun, politikanin, filozofin dhe poetin Hamid Gjylbegaj -

## 1.

Hamid Gjylbegajn e kam takuar dy herë në jetë. Në të dyja rastet nuk kam biseduar qoftë edhe një fjalë me të, por e kam fiksuar portretin e tij me sytë e fëmijërisë.

Shumë vite më vonë dëgjova si nën zë shumë ngjarje e histori paksa të çuditshme që lidheshin me emrin e këtij burri, që unë shumë e shumë vite më parë e kisha njohur. Këto ngjarje e histori që lidheshin me të si protagonist e që tregoheshin me zë të ulët, me siguri përkonin me këtë moment që historiani Dashnor Kaloçi shkruan: “... nga viti 1945 e deri në vitin 1979 ai nuk mori pjesë asnjëherë në votime, duke i bojkotuar rregullisht ato. I gjithë populli i Shkodrës dhe i Elbasanit, ku ai jetoi, e mbajnë mend fare mirë se Hamidi nuk shkoi asnjëherë pranë kutive të kuqe të votimit.

...

Ai ngrysej dhe gdhihej i vetëm në shtëpinë e tij, duke kaluar netët e gjata dhe të acarta të dimrit pa kushtet minimale të jetesës. Hamid Gjylbegu, shkodrani me bindje antikomuniste, që mbahet mend si rast i rrallë në të gjithë Shqipërinë...”<sup>1</sup>

Shumë vite më vonë, lexova e rilexova gjithë librat e tij (me nga 16 faqe, a diçka më shumë), dhe sytë e fëmijërisë sime nuk e kishin tjetërsuar atë portret. Imazhi qëndronte i gjallë, i paprekur si atëherë...

Ishte serioz. Serioz tërë kohën. Të dukej sikur i kishin humbur buzëqeshja, sikur nëpërmjet bisedave e kërkonte atë... Fliste rrallë, duke tundur kokën. I ulur në një karrige, shpesh meditonte në vetminë e

1. Kaloçi Dashnor: “Gjylbegu, njeriu që s’votoi kurrë”, Gazeta Shqip - tare, 12.10.2003

ditëve fatin e shkruar dhe të pashkruar... I vrazhdë në vetvete. Me ballë të rrudhosur e sy të tretur, deri aty ku s’arrin dhe pikë lotit. Shpesh kërciste dhëmbët si shenja nervozizmi për t’i bërë sfidë kohës që e mendoit dhe e plagosi shumë për fjalën e lirë, për peshën e lirisë, për karakterin e vendosur e të admirueshëm. Esmer, me mustaqe që iu zbardhën në pleqëri, por me një shpirt të çelur që rrëfente një bujari të vërtetë. (Të mos harrojmë që ai shpirt mbante dramën që ia shkaktoi egër e torturuese diktatura e egër dhe e pashpirt, që ai shpirt qante në heshtje e mbante të ndezur dritën e shuar të të birit të vetëm, Virtytit, që e donte më shumë se sytë e ballit). Reflekset e tundimit shpirtëror, të krizës morale i gjejmë dukshëm të pasqyruara në librat “Zana e shitueme”, “Fyelli i barive” e “Harpa e thyeme”, botime të vitit 1943.

Një bardhësi e bukur i mbulonte kokën. Siç duket, kjo bardhësi si një lirishtetësi fatlum, ishte krijuar enkas për të zbutur pamjen e zemrën e këtij njeriu që më shumë mendonte se sa fliste, që kishte rënë 27 herë në luftë e ishte plagosur 2 herë. Të dukej sikur Hamid Gjylbegaj me një botë poeti, jetonte diku mes kufijve të ireales me realen, të legjendës me mistiken, të amëshimit me pafajësinë, të ëndrrës që nuk arriti kufijtë e realitetit... Jetonte vetëm me “ajrin e atdheut”, të cilin e deshi aq shumë.

## 2.

Hamid Gjylbegaj lindi më 28 shkurt të vitit 1889 (ndonëse ka versione të ndryshme) në një familje me emër e nga më të vjetrat e qytetit të Shkodrës, siç ishte ajo e Gjylbegajve. Shkollën fillore dhe të mesme ushtarake i ndoqi në vendlindje. Vitin e fundit e bëri në Manastir. Akademinë Ushtarake e përfundoi



pas tre vjetësh studimi në Stamboll. Në korrik të vitit 1912 emërohet instruktor i rekrutëve të regjimit të 38-të në Selanik. Gjatë Luftës Ballkanike u gjend në korparmatën e Selanikut, në frontin me serbët dhe mori pjesë në luftime në Kumanovë, Qyperli, Perlep, Manastir e pastaj në front me grekët në Bilisht, Korçë, Janinë. Më 6 mars 1913, Janina ra në duart e grekëve dhe Hamidi dërgohet rob lufte në ishullin Zanta. Në tetor të vitit 1913 lirohet e kthehet në Stamboll. Më pas vjen në Shqipëri për të punuar për forcimin e shtetit shqiptar. Zgjidhet anëtar i Komitetit Ekzekutiv të Klubit "Lidhja Kombëtare". Me krijimin e Komitetit Kombëtar për Mbrojtjen e Kosovës, më 1918 zgjidhet anëtar i Kryesisë së atij Komiteti. Bën pjesë në grupin e atyre që caktoi Komiteti për përgatitjen e Kongresit të Lushnjës. Në mars të vitit 1920, u emërua nënprefekt në Pukë. Drejton veprimet luftarake në fazën e parë të Luftës së Koplikut (korrik-gusht 1920).

Qeveria e Fan Nolit e nxori në pension. Hoqi dorë nga veprimtaria politike. Arsyen e mbulon heshtja. Vdiq në Elbasan, më 24.02.1979, katër ditë para se të mbushte moshën 90-vjeçare.

### 3.

Hamidi zotëronte: turqisht, italisht, gjermanisht, frëngjisht. I pajisur me një kulturë të gjerë ushtarake, filozofike e letrare, të cilat reflektuan në punën e tij, bënë që gjithherë të udhëhiqej nga bindjet nacionaliste.

Poezitë e para i botoi në revistat "Agimi" dhe "Afrimi". Më pas botoi librat: "Flutura ndër lule" (1924), "Pak a shumë" (1925), "Fjala e Virtytit" (1929), "Monument i Atdheut" (Shtypshkronja "Saide" Elbasan, 1930), "Kunora e Lumnis / Caku i filozofis" (Shtypshkroja "Ora e Shkodrës", 1931), "Fletra e jetës" (Shtypshkroja "Ora e Shkodrës", 1932), "Drita e S'vërtetës" (1933), "Kopje origjinale" (Shtypshkroja "Ora e Shkodrës", 1933), "Fyelli i Barive", Tiranë, 1943), "Zana e shitue-me", 1943, "Harpa e thyeme", 1943) etj.

Në dorëshkrim i mbetën poezi të bëra pas çlirimit

e disa përkthime. Mblodhi këngë lirike në trevat e Malësisë së Madhe. Një pjesë i botoi. Ka shkruar dhe artikuj politikë në gazetën "Populli" në Shkodër, "Dajti" në Tiranë, herë me emër, herë me pseudonim...

### 4.

Kritiku Izet Bebeziqi, në studimin e tij mbi krijimtarinë e Hamdi Gjylbegajt, në mes të tjerave thotë: "Po, po, koha do të vijë dhe penda (pena) e tijë do të çmohet". Krahas këtij vlerësimi, kritiku në fjalë e ka njohur shumë mirë kulturën, filozofinë dhe karakterin e Hamidit. Në analizën që u bën shumë poezive të tij, evidenton këto dukuri që i krahason me poezitë e poetit gjerman Storn-i. Aq më shumë kjo gjë përforcohet, kur, sipas autorit Bebeziqi, poezia e Hamidit gjen pika takimi me të Storn-it. (me sa duket ky emër ka qenë një preferencë e Hamidit dhe ndikim i tij, e, në bisedat e ndryshme me Bebeziqin, duhet ta ketë përmendur shumë herë). Dhe për ta përligjur mendimin e mësipërm, nga studimi i I. Bebeziqit shkëpusim këtë fragment si argument: "Vjershat e tij janë vende-vende me një frymë lyrike njaqë të kandëshme e të natyrshme, sa që në "Urata e Dashtnisë", "Vera", "Vjolca", "Bylbylit", "Vegimi i sajë" etj., të thueshë se flet Storn-i. Si ky, ashtu dhe Hamidi, nuk dijnë t'i veshin ndjenjat e tyne me lule e fjalë pompoziteti, por i shprehin siç i ndijnë: Me za të popullit".

### 5.

Jeta e Hamid Gjylbegajt i ngjan një deti të trazuar, valët e të cilit e rrahën egër dhe në mënyrë të pamëshirshme, por nuk e gjunjzuan dot. Kantian nga filozofia. Karakter i një edukate gjermane. I prerë në vendime si ushtarak i Akademisë turke. I heshtur gjer në dhembje. E gjitha kjo ishte bota ku shëtiste Hamidi, parimet e së cilës nuk i cenonte, por nuk lejonte t'ia cenonte askush.



*"Po, po, koha do të vijë dhe penda (pena) e tijë do të çmohet".*



“...Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli,  
derisa njerëzit ta ndryshojnë veten e tyre...”  
(Er-Rra'd, 11)

Nexhat Ibrahim

# E ardhmja brezit të ri!?

## GJENDJA AKTUALE

Përfundimi i shekullit XX në Ballkan ishte në shenjë të luftërave të përgjakshme ndërmjet popujve ballkanikë, gjegjësisht ndërmjet kasapit të Ballkanit, serbo-malazezëve në një anë dhe pjesës së mbetur në anën tjetër. Në periudhën e pasluftërave, në fillim të shekullit XXI, fillon periudha e akuzave, e krijimit të ndikimit, ku sërish Serbia në rolin e ujkut lart rrjedhës së ujit, e akuzon qengjin se i turbullon ujin që gjendet poshtë tij. Në këtë periudhë edhe sfidat janë më të shpeshta. Ndër të tjera, pjesa më e sfiduar e shoqërisë, rinia, shtron pyetjen: nga t'ia mbaj? Ç'drejtim të ndjek, shpirtërisht dhe fizikisht?

Krahas rinisë edhe shumë njerëz në këtë konfuzion idesh e propozimesh gjenden para dilemave: nga të ec në arritjen e diturisë dhe në ndërtimin dhe fuqizimin e karakterit. Deri sa dituria arrihet në fazën e hershme, ndërtimi i karakterit është çështje që zgjat gjithë jetën, i ri apo i vjetër. Nxënësi apo student plotëson çdo ditë thesarin e tij me dije të freskët, por edhe krijon shprehje pune. Por me rritjen e nxënësit dhe studentit, këshillat zvogëlohen, kurse burimet e njohjes shteren. Vetëm një numër i vogël njerëzish janë në gjendje ta ndihmojnë atë në shkollimin e mëtejshëm, në projektin e ri apo në aftësimin e mëtejshëm. Këtu fillon edhe dyshimi i parë, lëkundja e parë, sepse ata pyesin: çfarë na duhet gjithë kjo punë studimore dhe çfarë do të kemi ne nga tërë kjo!

## KU QËNDRON FAJI?

E dimë se zakonisht faji është jetim. Masa e popullit ia hedh fajin politikës, kurse politika e pastron veten, duke thënë se po bëhet kurban për fajin e popullit dhe për vetë popullin. Por një meditim serioz, një analizë e thellë, thotë se faji është i të gjithëve. Fajësimi vetëm i politikanëve nuk është i drejtë, siç nuk është i drejtë fajësimi vetëm i intelektualëve apo i studentëve. Edhe pse udhëheqës të caktuar gabojnë, për shkak të mosdijes apo dëshirës së flaktë për pasurim a karrierë, ata vazhdojnë të punojnë po aty apo në vende

të ngjashme. Njerëzit akademikë, në të shumtën e rasteve heshtin apo edhe kur reagojnë, këtë reagim e bëjnë “butë” dhe në çështje të caktuara. Në anën tjetër edhe politizimi i skajshëm i kuadrit akademik, duke mbajtur anën e një partie, do të kishte pasoja afatgjata në lirinë dhe pavarësinë intelektuale, shkencore dhe hulumtuuese. Kjo së shkurti, është e vërteta për fajin, i cili, pak a shumë, i prek të gjithë. Nuk ka tërësisht të pastër, siç nuk ka tërësisht të fajshëm.

**Studenti fajtor.** Nga njeriu, të cilit nuk i ofrohet rasti, nuk mund të presësh ndonjë kontribut apo ndonjë përvojë. Për këtë arsye, studentët, në pamundësi të marrin shans për punë, gjenden vetë, sidomos duke u angazhuar nëpër shoqata e organizata joqeveritare, të vendit apo të huaja. Kjo (mosdhënia shans të rinjve) nuk është normale, kur dimë se shumë njerëz mbajnë nga dy a tre vende pune, kurse kuadri i ri nuk mund të gjejë as një vend, madje diçka vullnetare.

Faji i studentit është që, përballë kësaj gjendjeje, nuk bën asgjë që ta ndryshojë atë. Ai është pajtuar me gjendjen ekzistuese, bëhet përtac, i dorëzohet dëshpërimit dhe kohën më të madhe e kalon në humbakohë apo në shoqëri të keqe. Në vend të ndryshimit të gjendjes, studentët bëhen faktorë ndihmues në rritjen e saj, duke ngulfatur idetë e shumta dhe implementimin e tyre eventual.

**Profesori fajtor.** Ndër fajet që studentët i trashëgojnë nga profesorët e tyre, është edhe përtacia, dukuri kjo ballkanike, jo vetëm e shqiptarëve. Mangësi tjetër është edhe jospécializimi i kuadrit të ri. Lexohet mjaft, por pa gjëra konkrete. Koha, ku çdo ditë kemi miliona informacione, nuk lejon erudit të tipit mesjetar, por specialist. Edhe pse të gjitha fakultetet e kanë në program specializimin, aftësimin e mëtejshëm të studentëve, kjo nuk ndodh ose ndodh aq pak, sa nuk mja-





fton ky riprodhim me hapa bresh-ke. Duke marrë parasysh se këto programe i punojnë profesorët dhe krerët e fakulteteve, atëherë rezulton se faji është te kajmaku i dijes e jo te studentët. Studenti diplomon, por ai më shumë i ngjason makinës së informacionit, se një njeriu akademik me mendim e gjykim kritik, me shpirt kreativ. Edhe theme-luesit e fakulteteve, shkollave dhe institucioneve të tjera, në programet e tyre zotërojnë pa-ragrafë për aftësim të kuadrit, për shkollim plotësues, por puna mbaron me kaq. Kjo gjendje, *as ty as mua*, e vdes shpirtin e të dyja pa-lëve. Edhe të studentëve, të cilët nuk gjejnë mënyrë për t'u imponuar edhe të klasës sunduese, që nuk gjen vullnet për të krijuar brez shpresëdhënës.

### **SHPËRFILLJA E RINISË**

Edhe kur ndodh që studenti të ofrojë ndonjë projekt apo kërkon sugjerime e ndihmë konkrete për ndonjë projekt, qysh në fillim ai do të shpërfillet nga të ashtuquajturit ekspertë. Refuzimi i studentit, por edhe përbuzja dhe neglizhimi i tij dhe i projektit të tij, çon në përfundimin se materializimi ka përfshirë të gjitha institucionet vendimmarrëse, politikëbërëse, duke mos i përfshijtur edhe ato arsimore e edukative. Ndodh që ndihma të vjen nga s'e ke pritur, shpesh nga profesorë të paktë në numër, por që në damarët e tyre ende pulson altruizëm e solidaritet, humanitet e devocion. Por studenti ka nevojë edhe për më shumë, sepse ai duhet të sigurohet edhe materialisht. Solidariteti me studentin nuk e zëvendëson ndihmën materiale, sikurse edhe kjo e fundit nuk e zëvendëson atë të ndihmës profesionale. Është mendimi im se as shteti, as institucionet fetare nuk janë në nivel të përgjegjësisë së kohës dhe nuk kanë politikë kuadri, për të shfrytëzuar këtë potencial intelektual, sasior dhe cilësor, në rritje.

### **MUNGESA E LIDERIT TË MIRËFILLTË**

Nëse do ta pyesni rininë myslimane për respektin ndaj profesorëve të tyre, të gjithë do të rikujtojnë emra të vjetër, që mbase as nuk i kanë parë, madje as që kanë qenë të gjallë, por që kanë dëgjuar për ta apo kanë lexuar diçka. Por pak kush prej tyre do të përmendë dikë nga kjo gjeneratë me të cilën jeton, mëson prej tyre dhe mund t'i kontaktojë çdo ditë. Ku qëndron problemi? Vallë, këta profesorë aktualë nuk kanë bartur ndonjë cilësi nga mësuesit e tyre që kujtohen me admirim dhe këtë t'ia transmetojnë drejtpërdrejt këtij brezi, nëpërmjet personalitetit të tyre. Përse respektohen më shumë ata që janë të shkuar qysh moti, por jo edhe këta të kohës?

Përgjigjja e mirëfilltë është e rëndë, por mendojmë se rinia aktuale kërkon liderë të mirëfilltë, tipa karizmatikë, kërkon liderë të tillë çfarë nuk frekuentojnë aktualisht apo janë strukur dhe jetojnë në thellësi të shpirtit të tyre. Ata po kërkojnë profesorë të tillë, që t'i dëgjojnë dëshirat e tyre, që t'i kup-

tojnë ambiciet e tyre dhe t'u ndihmojnë, së paku verbalisht dhe moralisht në sendërtimin e vizioneve të tyre.

Krizë liderësh apo qasje e gabueshme! Mendoj se kjo e dyta, qasja e gabueshme, është qendrore, përse xhemati ynë nuk na dëgjon sa duhet në katedër, në foltore, në minber, në mihrab, përse nxënësi ynë nuk na ndjek sa duhet, përse fjala jonë nuk e ngroh kraharorin e tyre, shpirtin e tyre të etshëm për diçka të madhe!

### **SI TË NDRYSHOHET GJENDJA?**

Secili njeri i mençur do të thoshte se ndryshimi i gjendjes së amullisë në gjendje aktive, kërkon angazhime e sakrifica të shumta. Por a ekziston dëshira për ndryshim, por pa e ndryshuar dhe qëndrimin e deritashëm ndaj vetes, të tjerëve dhe ambientit? Në këto rrethana të mbyllura e burokratike, njeriu i ri e ka të vështirë ta gjejë veten. Ai nuk e takon kritikën e bazuar të lavdërimit, e cila do ta ndihmonte si përkrahje dhe motivacion, as kritikën e bazuar të qortimit, e cila do t'i ndihmonte të riparonte defektet e tij. Por besimtari i mirë nuk ka nevojë për lavdërim, sepse ai besimin bazament e ka për jetën e tij, dijen e ka për udhëheqës në zgjidhjen e problemeve, kurse punën kusht që veten, rrethin dhe më gjerë, ta bëjë më të mirë. Suksesi ynë nuk bën të varet nga lavdërimi apo qortimi. Mjafton mesazhi islam, që brezi i ri është me rëndësi të jashtëzakonshme në Islam.

Nuk duhet të bazohemi në rezultatet e shkuara. Nuk bën të vetëkënaqemi me të kaluarën. Nuk bën ta kuptojmë Islamin si "dua" në kuptimin pasiv, duke pritur se Allahu do të sjellë mirësinë në tryezën tonë në mënyrë të gatshme, kurse ne, duke neglizhuar ligjin e Tij. Duaja jonë duhet të jetë në pajtim të plotë me vullnetin e Allahut e jo në shërbim të interesave të ulëta, të shefave, të shtetarëve, të liderëve. Duhet të ndjekim rrugën e mirëfilltë e jo gabimet e profesorëve tanë dhe bashkëkohësve tanë, duke mos përkrahur të rinjtë dhe punëtorët.

Vetëdija për identitetin fetar dhe nacional, vetëdija për tërësinë tonë është me rëndësi për zhvillimin e sistemit tonë të të menduarit dhe aktivitetit. Harrimi i së kaluarës do të na bëjë pre të lehtë për zullumqarët e së ardhmes.

### **SI TË KAPËRCEHET KRIZA AKTUALE?**

Ekziston vetëdija se kriza është e pranishme. Shumë intelektualë kanë shkruar për krizën e arsimimit, edukimit, të moralit, të punës etj. Pa dashur të hyjmë në përsëritje apo në biseda bajate, do të theksojmë se edhe neglizhimi i rinisë dhe zërit të tyre, është ndër krizat e pranishme. Pa u dëgjuar fjala e tyre është gabim. Sepse, kjo bën që edhe studentët më të mirë i shfrytëzojnë OJQ-të e ndryshme, shtetet e ndryshme e jo organizata dhe shteti amë.

Ky shkrim nuk atakon individët as institucionet tona, por tërheq vërejtjen e të rinjve dhe të të vjetërve që kjo gjendje duhet të ndryshojë për të mirë, në të kundërtën, pasojat do të jenë më të rënda për kohën tonë dhe atë që vjen.

Shekulli XXI do të ofrojë mundësi të reja, por edhe përgjegjësi të reja. Ndryshimi do të varet nga vullneti i të gjithëve. Të diturit të mësojnë të rinjtë, kurse të rinjtë të absorbojnë e praktikojnë të mësuarën, por vetëm pas një studimi kritik dhe të përgjithshëm. Vendit tonë dhe fesë sonë nuk do t'i ndihmojnë puthadorët as lakmatarët, por këmbëngulja dhe besimi i pathyeshëm i besimtarëve.



# Rrugët e afërimit me Allahun

Transmetohet nga Ebu Hurejra (r.a.), se Profeti (a.s.), në një hadith kudsî ka thënë:

*"Allahu ka thënë: "Kush tregon armiqësi me ndonjë prej velive (miqve të dashur) të Mi, Unë do t'i hap luftë. Robi im nuk mund të më afrohet në ndonjë mënyrë më të mirë se sa me ato që Unë ia kam bërë farz (të detyrueshme). Robi im vazhdon të më afrohet edhe me (vepra) nafîle (vullnetare) dhe Unë e dua atë. Kur Unë e dua, i bëhem veshi me të cilin dëgjon, syri me të cilin shikon, dora me të cilën prek dhe këmba me të cilën ecën. Nëse kërkon diçka prej Meje, ia jap, nëse strehohet tek Unë e mbroj..." (Buhari, Rikak, 38.)*

## **KUSH ËSHTË VELI (MIK I DASHUR I ALLAHUT)?**

Në këtë hadith kudsî, gjëja e parë që të tërheq vëmendjen është "armiqësia ndaj velive". Kuptimi i fjalës "veli", është mik i dashur. Ndërsa "evlijauallah" do të thotë miqtë e Allahut. Në kuptimin e përgjithshëm, të gjithë ata që e jetojnë fenë me devotshmëri të lartë dhe sinqeritet të plotë, konsiderohen veli. Ndërsa në një kuptim më specifik dhe si një koncept i veçantë i tasavufit, veli konsiderohen ata që i janë afuar Allahut, kanë fituar kënaqësinë e Tij

dhe kanë grada të larta shpirtërore. Në një ajet të Kuranit Fisnik thuhet:

**"Pa dyshim, miqtë e Allahut nuk do të kenë arsye për t'u frikësuar dhe as për t'u dëshpëruar."** (Junus, 62.)

Ata që ndajnë mendime të kundërta me tasavufin, fjalën "veli" nuk duan ta mbartin jashtë kuptimit të saj të përgjithshëm. Ky është një mendim dhe ne e respektojmë atë. Por nuk është aspak e pëlqyeshme që të fyesh apo të diskutosh personalitete të larta, si Mevlana, Hallaxh Mansuri, Muhjedin Arabiu etj, të cilët pjesa më e madhe e popullit i ka pranuar si "veli". Dikush mund të mos i pranojë mendimet e tyre, por, nëse këto kundërshtime mendimesh e shtynjë deri në kufirin e armiqësisë, atëherë lindin probleme.

Nëse këto personalitete janë me të vërtetë "veli" pranë Allahut Teala, atëherë njerëzit që shkojnë shumë larg në armiqësinë ndaj tyre, do të përballen me pasojat që shprehen në hadith: *"Kush tregon armiqësi me ndonjë prej velive (miqve të dashur) të Mi, Unë do t'i hap luftë..."*







## *Evolutionet e Botës Shqenxore*

(Njeriu para Natyrës – Theorit kryenalta shqenxore në shekullin XIX – në përparimet shqenxore grada e shekullit XX – nga astrologhia n'astronomi e nga magjia në shimi – nga luvgjetët në mjeksi – në theorit shqenxore nuk ka përjetësi – transformacioni i theorive është përfundimi i shvillimit së mendjes njeriut).

Me gjithë që nuk duhet mohuë as pak se ditunit'ona të deri tashme janë të kufizueme me pllajën që mund të dishmojnë ndjesit e mendimet, por nuk mund të pretendohet thuj thanë se e vërteta është e përmbledhun me doemos në këto kufi; i cillt pretendim kishte me qenë fare një mantalitet primitiv. Prej të vërtetave natyrale një pjesë shumë e vogël ka pushtue mendjen e njeriut. Nga shkaku që quhet njeriu më i zhvilluëshmi i gjithë krijesave nuk duhet që të jetë i kuptueshem plotsisht në të vërtetat natyrale.

Pozicioni i sotshëm i njeriut përkundrejt librit të natyrës është si aji i një foshnjës përkundrejt librit abetares; njeriu vetëm e vetëm në shekullin XIX tue zanë në librin e natyrës me përgojë shkronjen (a) prap me një përkdhelje foshnjore i dëfryëm e i refkëtuëm ishte e bindur tuej pandeh se kish ndërhy në kauzin e natyrës. Të tana themat e theorit e nalta të këtij shekulli ishin treguë n'ato kohra sikur ishin të pshetuna ndër themelime të pa-ndryshueshëm. Por çudija është këtu: Shekulli XX që sot po përgojon shkronjën (b) filloj m'u bind se vetëm për me xanë abetarën e natyrës njeriut mjer'i duhen me kalu shumë e më shumë shekulla. Pra kështu në këtë shekull u filluë të merren në tryzën e gjelbërt të gjitha bazat shqenxore që konsideroheshin si të plota e të mbarueme në shekullin e kaluëm. Mbas përpjekjevet që u-banë midis mendimeve të reme, e sypër-natyre, dhe të shqenzës, u

muhuen ato ngjarje që nuk mund me u shquë e shpjegu; dhe një pjesë prej mendimeve të remë e të shtrembëta u muerën mbrënda në qarkun e kuptimit të trunit njeriut.

Ditunit e gjyldanivet mbi të drejtën botnore (astrologia) dal nga dal u kthy n'astronomië – magjinat, të hyshtunat i lanë vendin shimis dhe fizikës. Mbesimet mbi xhindjet, perrit e djejt u aratisën përpara mjeksis; perendesha e rrufes dhe e breshnit u trëmb kundrejt paratonerit të Franklenit; U vërtetua që të shkalumit, të shuplakunjit, shkaktoheshin nga sëmendjet nevrastonike, të tjera e të tjera...

Mbas kaq evolucioneve i XIX ti shekull tue u këthy kohravet të shkuara po i veshtron te me një sy irronie prallat e kalueme; po kush na siguron neve, se dhe shekulli XX mbas evolucionit që është tue u përgatit, nuk do të shifet me sy të tallunit nga skotat e shekujvet që kanë me ardhë; ku e dim se mendimet e sotëshëm mbi spiritizmën, dhe mediomet, nesër përpara atyne që kanë me ardhë me çfarë prove janë për t'u biseduë dhe çfarë vleftje kanë me pasë mundet ato fjalë që kanë me thanë skotat e ardhme për neve, kanë me qenë më të ashpërta se këto t'onat që themi për të kaluemit.

Sot përpara syve t'onë telegrafi pa-tel, telefoni pa tel, numrohen si një mrekulli e shqensës të tanishme; por nesër në istorin e shqenzës nuk do të shifet nevojë fare për të përmendunit e këtyne si një shpikje me randësi. Për ket nuk ka dyshim! Çdo shekull nga shekujt që i vinë po pritët sheshit e lehtazi me ironi, në këtë mënyrë po konsiderohen hipotezë-t që sot prej të zotëneve quhen si një mjet i sigurt për me pushtuë pa njehsinat e natyrës, por këto hipoteza e teorina që ngref një shekull nuk ngelen



të perjetshme; ndodhin principe qi janë qujtun definitivisht si mendime të zgjedhun të një kohës caktume, qi të gjitha ndodhinat me ndihmën e këtyne interpretohen fare lehtëazi; por perjudha e re me të krijuar principet e reja, prap ato ndodhina shtrohen perpara mendimeve të rregullume me kuptime të ndryshme; me çdo faqe të evolucionevet ksodore njerzija futet pak ma shum në fushën e së vërtetës, por duhet ta dimë se në kto ndryshime natyra dhe ndodhinat ngelin gjithnji ato qi kanë qenë të pa ndryshuëme; njerzit me të tanë mendime e besimet e tyne tuj i ushqyëm me ato ndodhina i kanë transformue në forma të ndryshme; duhet t'a dijmë se përtëritja e teorivet nuk lenë nga përfundimi i ndryshimeve të ndodhinavet.,

Shkaku i ndryshimit vazhduës të mendimit njeriut para fenomeneve lind nga zhvillimi i trunit, dhe nga shtesa e kapacitetit menduër qi mendohet të futet sa ma thellë në pshehtinat e shpirtit të natyrës. Kjo pra nuk asht gja tjetër veç se nevoja e ligjit zhvilluës!..

Mendja e njeriut mbasi është si një thrrime e gjindjes natyrore nuk mund të pushtojë me një të hovun natyrën; por përpjekjet e sajë me këtë tue i dhanë prova të reja po fiton ç'do çap fuqinë futëse e cilla ka frytëzue bimat e kaqi shpikjeve të ndryshme. Njerëzit e mëdhenj qi shpikin gjana të çuditshme i kanë trut e tyne shumë të shkëlqy e, shumë të begatû, për zhvillimet e shpejta; ç'do shekull për veten e vet ka pasun të till xhenira.

Kishim thanë mâ nalt, se në ç'do shekull ndodhën principe qi janë pranû; por edhe këto janë tue bam evolucione; Nji prej ktyne dhe mâ randësishmja qi ndodhen para mendimeve të zgjedhun në shekullin XIX. Æsht ligji i fuqis së heqjes (la loi d'attraction) qi ka shpjegu Neëtoni i cili tue u bazuë në kalimin e shum shekujve, sa do qi kishte bindun shumicën e njërzve, se nuk do të ndryshohesh ky ligjë madhshtuës, por pati nderin e naltë shekulli XX qi t'i krej në

shesh pikat e tij qi janë të meta dhe qi kanë nevojë meremetimi.

Shekulli i XX e shtrini landën sypër tryezës së gjelberët anatomike; filloj të bâjnë prap studime përmbi atë; kur pa se kualiteti, esenca e materiës nuk ishte aq simplë, e çveshun, sa pandehesh e kujtohesh. Mbi këtë kështu, u krye në shesh mendimi se kuptimet e landës kanë nevojë korigjimi dhe, përfundisht shimia nuk i ka të sakta bazat e para-themeluëme. Shimia e shekullit XIX tët ishte e bindun se landa nuk shduket kurr dhe elementet nuk kanë probabilitete transformacioni; sot doli në shesh se të tana ato bindësina shkaktoheshin aso kohe, nga mangutsëi e mendjes dhe ngushtica e sajë.

Ka qenë themelue një ligjë evolusioni dhe përmbahesh mendimi se gjith gjallninat ishin të përulun para kti ligji; por shekulli XX filloj t'a kritikoj edhe këtë ligji: bani edhe modifikime mbi bazat e këtij, tue i zgjanu sheshin e aplikimevet; u kuptue se si gjallsinat edhe ngrirësinat rregullohen brenda një ligji; Radjomi është i pari qi shkaktoj evolusionin në botë shqenzore, i cilli e forcoj mâ shum ligjin e zhvillimit.

Në ligjet e gjallsinavet filluan ndryshime; mendimet e vjetër përmbi essencan e jetës gjallnis i'u lanë vëndin kuptimeve të reja. Fenomenet trashigjore dal nga dal filluen m'u shpjegue.

Po t'i përmbledhim mendimet e e shpjegu shkurtazi duhet të thomi shqenza kurdoherë po vazhdon në transformatinet e saj; shkaku asht fare simplë; se esenca e gjânave është e pa njoftun nga neve; por të tana teorit qi shpjegojnë fenomenet janë proporsionel; e sakta dhe e vërteta, përherë po ngelin jashtë fushës së kuptimit t'onë. Pse! Se mëndja qi jetonë mbi këtë tokë, truni i ksajë bote, nuk e ka fitu edhe kapacitetin influencuës, kundrejtë së vërtetës; por është shtegtuës, gjurmuës i asaj rruge dhe njerzia afër ose von, një dit, ka me pasun nderin të vinj ballë më ballë me atë të vërtetë.



# Punimet enciklopedike në literaturën islame

Në punimet enciklopedike përfshihen në mënyrë sistematike informacionet në lidhje me tërësinë e fushave të ndryshme të shkencës, kulturës, artit dhe teknologjisë, deri në periudhën kur botohen këto vepra apo të dhënat në lidhje me personalitetet, veprat, vendet gjeografike dhe institucionet e një fushe të caktuar apo sqarimet në lidhje me fjalët, konceptet, ngjarjet dhe temat e caktuara. Enciklopeditë janë punime shumëvëllimëshe dhe gjithëpërfshirëse, që veçanërisht në ditët e tona, përgatiten nga grupe të gjera akademikësh dhe studiuesish, që punojnë një kohë të gjatë në lidhje me përgatitjen e tyre, në sajë të cilave mund të gjenden në një kohë të shkurtër të dhëna në lidhje me çështje të caktuara.

Fjala enciklopedi rrjedh nga fjala latine *encyclopaedia*, e cila buron nga greqishtja dhe ka kuptimin "brenda rrethit të diturisë" (en-brenda, cyclo-rreth dhe paedia-dituri). Në Greqinë dhe në Romën antike, me këtë fjalë nënkuptohej tërësia e njohurive që duhej të merrte një person përpara se të hynte në jetë. Këto njohuri grumbulloheshin nën termin *septem artes liberales* (shtatë artet e lira) dhe ishin gramatika, retorika, dialektika, aritmetika, gjeometria, astronomia dhe muzika. Si term i ri, fjala enciklopedi u përdor për të parën herë në vitin 1531 në literaturën angleze nga Thomas Elliot dhe në 1532 në literaturën franceze nga Francois Rabelais. Ndërsa përdorimi i fjalës në kuptimin e njohur sot, pra si një zhanër botimi, u përdor për herë të parë në shekullin XVIII nga Dideroti dhe kolegët e tij.

Ndonëse ka indikacione që na lejojnë të supozohet se shembujt e parë të punimeve enciklopedike mund të jenë hartuar në qytetërimet antike egjiptiane, babilonase, indiane dhe kineze, shumë më përpara sesa qytetërimi antik grek, enciklopedia më e vjetër që njihet është shkruar në vitin 370 p.e.s. nga nipi i Platonit, Speusipos dhe quhej *Similitudes*. Në këtë veprë kishte të dhëna në lidhje me historinë e natyrës, matematikën dhe filozofinë. Vepra e dytë enciklopedike më e vjetër që njohim, është vepra *Praecepta ad filium* e shkruar nga romaku Kato, i cili

vdiq në vitin 149 p.e.s.

Do të ishte një romak sërish autori i një veprë tjetër enciklopedike të pajisur edhe me skica dhe piktura. Ai qe Marcus Terentius Varro i viteve 50 p.e.s., ndërsa vepra e tij titullohej *Disciplinarum libri*, në të cilin gjendeshin të dhëna nga nëntë fusha të ndryshme të shkencave (gramatika, logjika, retorika, gjeometria, mjekësia, arkitektura, aritmetika, astronomia dhe muzika). Një tjetër veprë e rëndësishme enciklopedike e antikitetit qe *Historia naturalis*, me autor romakun Plinius (v. 79), e cila përbëhej nga tridhjetë e shtatë vëllime, me dy mijë e pesëqind kapituj.

Vepra enciklopedike më e vjetër, e shkruar në Orientin antik, qe vepra *Huang lan*, e shkruar rreth viteve 220 me urdhër të perandorit kinez. Kjo veprë nuk ka mbërritur deri në ditët e sotme.

Shekulli VII (shekulli I hixhri) është epoka e lindjes së shkencave islame. Punimet e para buruan nga nevoja për të njohur në mënyrë të saktë dhe të plotë tekstin e Kuranit. Në këtë mënyrë, nga një anë, si rezultat i kësaj domosdoshmërie, u hodhën bazat e shkencave ndihmëse për të kuptuar drejt tekstin e Kuranit, siç ishin shkencat e gramatikës dhe gjuhësisë arabe, tefsirit dhe Kiraetit, ndërsa nga ana tjetër, domosdoshmëria për të grupuar hadithet e sakta nga profeti Muhamed, çuan në zhvillimin e shkencave të hadithit, sijerit (historia e jetës së profetit Muhamed) dhe ilmu rixhal (shkenca e mbledhjes dhe vlerësimit të të dhënave në lidhje me raportuesit e haditheve).

Duke filluar nga gjysma e dytë e shek II hixhri dhe veçanërisht në shekullin III hixhri, vihet re një zhvillim i shkencave islame dhe hartimi i një numri të madh veprash. Pjesën më të rëndësishme të tyre e zinin veprat e zhanrit tabakat, vepra që përmbanin në rend alfabetik të dhëna biografike. Vepra e parë e këtij lloji qe *Tabakatu ehli ilm ve xhehl*, e Vasil b. Ata (v. 748)

Në mesin e faktorëve që ndikuan në prodhimin e literaturës enciklopedike në botën islame, është pa dyshim procesi i përkthimeve në gjuhën arabe të burimeve të vjetra greke që zuri fill gjatë sundimit të



kalifatit emevi, për të arritur kulmin gjatë sundimit të kalifit abasi Memun (813-833). Në përfundim të këtij procesi përkthimesh, bota islame përjetoi një zhvillim të madh në fusha të ndryshme, si në mjekësi, farmaceutikë, zoologji, veterinari, kimi, botanikë, matematikë dhe astronomi. Vetëm pas zhvillimit të shkencave të ndryshme në botën islame, aty qenë pjekur kushtet për hartimin e punimeve enciklopedike. I pari që hartoi një punim të natyrës enciklopedike, qe Xhahidhi (v. 868 / 255 H.). Dy punimet e tij më të njohura qenë **Kitabu hajevan**, i njohur si Enciklopedia e kafshëve, për shkak se të dhënat në lidhje me ta janë më të gjera. Në të vërtetë, në këtë vepër ka të dhëna edhe për shkencat islame, historinë, gjeologjinë dhe gjuhësinë. Vepra e dytë e Xhahidhit qe **Bejan ve tebjin**, në të cilën janë përmbledhur të dhëna në lidhje me të gjitha temat e letërsisë arabe.

Por vepra e parë enciklopedike në literaturën islame, qe ajo e titulluar **Ujunul ahbar**, me autor Ibn Kutejbe. Menjëherë pas kësaj vepre, vihet re një zhvillim i madh i literaturës enciklopedike brenda një kohe të shkurtër. Kështu, në botën islame u hartua një literaturë e gjerë enciklopedike, e njohur nën emra të ndryshëm, si lugat, ferheng, kamus, muxhem, tabakat, tedhkire, tuhfe, menakib, ensab, fihrist, kenz, sefine dhe keshaf. Për nga përmbajtja, veprat tabakat, tedhkire, tuhfe, menakib dhe ensab, përmbajnë të dhëna biografike. Veprat lugat, ferheng, muxhem, kamus, keshaf përmbajnë të dhëna gjuhësore dhe bibliografike. Në këtë periudhë u hartuan edhe punime enciklopedike të fushave të ndryshme, si punimi gjashtë vëllimesh **Kitabu Nebat**, i Ebu Hanife Dineverit (v. 895/282 H.) në fushën e botanikës, vepra **Kamil fi lugat**, e Mubberedit (v. 898/ 285 H.), në fushën e letërsisë arabe, Havi e Raziut (v. 925/313 H.) në fushën e mjekësisë, në të cilën, përveç mjekësisë arabe, ai përfshiu edhe arritjet e mëparshme të mjekësisë antike indiane, greke dhe suriane.

Ndërkohë, në shekullin X (IV hixhri), nis periudha e hartimit të veprave enciklopedike me natyrë të përgjithshme. Vepra e parë e këtij lloji, është ajo e filozofit islam Farabi (v. 950 / 339 H.), e titulluar **Ihsaul ulum ve tarif**, në të cilën shkencat ndahen në pesë grupe kryesore. Vepra e Farabiut pati ndikim jo vetëm në literaturën e mëpasme islame, por edhe në perëndim. Kështu, ajo u përkthye në latinisht nga Gerard de Cremona, me titullin De Scientiis dhe u përdor për vite me radhë në Evropën Perëndimore si literaturë bazë. Vepra të tjera të rëndësishme enciklopedike, pas asaj të Farabiut, janë veprat **Mefatihul ulum**, me autor

Harizmin (v. X / IV H.) dhe **Xhevamiul ulum**, me autor Ibn Furaj.

Vepra më e rëndësishme enciklopedike e shekullit X (IV H), është vepra **Fihrist**, me autor Ibn Nedim (v. 995). Vepra e tij ngjason më shumë me një punim bibliografik, por informacionet që gjenden në të, në lidhje me përkufizimin e shkencave, klasifikimin dhe autorët më të rëndësishëm të çdo fushe, kanë bërë që kjo vepër të ketë një natyrë enciklopedike gjithëpërfshirëse. Vepra Fihrist ndahet në dhjetë kapituj, që janë: 1. Gjuhët, alfabetet, 2. Gjuhësia dhe gjuhëtarët, 3. Biografët, skribtët, këngëtarët, 4. Raportuesit e haditheve, poetët, 5. Kelamistët, asketët dhe sufitët, 6. Fakihët dhe muhadithët, 7. Filozofët, inxhinierët, matematikanët, mjekët, muzikantët, astrologët, 8. Magjistarët, 9. Fetë indiane, keldanase dhe zjarrpustitët dhe 10. Kimistët.

Një tjetër punim i rëndësishëm enciklopedik i shekullit X (IV H), janë përmbledhja e traktateve të bashkësisë së mendimtarëve filozofë, që njihen si Ihvani Safa. Ky punim dallon nga të gjithë të tjerët, sepse në të janë përmbledhur të dhëna në lidhje me shkencat të ndryshme dhe kjo gjë nuk është bërë nga një dorë e vetme, por nga një grup mendimtarësh. Kjo vepër enciklopedike përbëhet nga pesëdhjetë e dy traktate, të ndara në katër kapituj (matematikë, shkencat natyrore, shkencat logjike dhe psikologjike dhe shkencat teologjike).

Pas shekullit XIV (VIII H) filluan të pakësohen veprat enciklopedike në mënyrë paralele edhe me ngadalësimin e veprimtarive shkencore në botën islame. Do të ishte gabim të pohohej se pas kësaj periudhe u zhdukën fare punimet enciklopedike apo se zhvillimi i shkencave në botën islame ndaloi fare. Edhe pas kësaj periudhe, në botën islame dhe, veçanërisht, në perandorinë osmane u hartuan shumë vepra që përfshinin të dhëna enciklopedike, nën punimet me titujt tedhkire, tabakat dhe fehrese. Vepra e parë e këtij lloji në këtë periudhë, është vepra **Mekalidul ulum**, me autor Sejid Sherif Xhurxhani (1413 / 816 H), që përmban njëzet e një kapituj për fusha të ndryshme të shkencës. Ndër punimet më të njohura enciklopedike në periudhën osmane, është pa dyshim vepra **Keshfu dhunun**, e Katib Çelebiut (v. 1657 / 1067 H), në të cilën janë regjistruar të dhëna rreth dhjetë mijë autorëve dhe katërmëdhjetë mijë e pesëqind veprave dhe traktateve të ndryshme.

# Ndikimi i filozofisë islame në filozofinë perëndimore

Ndikimi i filozofisë islame në filozofinë perëndimore të krishterë dhe hebraike është shumë më i madh nga ç'mendohet. Ky ndikim ka filluar që nga shekulli X, me përkthimin në latinisht, hebraisht dhe gjuhë të tjera të librave të filozofisë së myslimanëve dhe ka vazhduar deri në kohët moderne. Filozofët perëndimorë të Mesjetës dhe Rilindjes nuk ngurojnë të përmendnin se ishin filozofët myslimanë ata që u kishin mësuar filozofinë. Ndryshe ndodhi me filozofët iluministë dhe modernë, si për shembull, **Dekarti** (1596 -1650), i cili nuk citon asnjë filozof nga i cili është ndikuar, qoftë mysliman apo i krishterë.

Perëndimorët e morën seriozisht këtë trashëgimi të pasur shkencore, filozofike dhe kulturore të myslimanëve. Ata ndërtuan disa shkolla të përkthimit të veprave nga gjuha arabe, në atë latine, në Palermo të Sicilisë dhe tjetra në Toledo të Spanjës. Më pas, nga shekulli XII dhe XIII nis një tjetër fazë përkthimesh nga gjuha arabe, por këtë radhë, krahas gjuhës latine edhe në gjuhën frënge dhe spanjolle, madje edhe në gjuhën greke, në Paris, Kordova, Napoli, Bolonja dhe Padova. Me përkthimin që iu bënë këtyre veprave filozofike, në Perëndim nisi të krijohet një traditë filozofike. Ndaj, burimi më i rëndësishëm i filozofisë perëndimore është filozofia islame. Pa u njohur filozofia islame, nuk mund të kuptohet mirë zhvillimi historik dhe doktrinal i filozofisë perëndimore.

Kur të krishterët perëndimorë filluan të njiheshin me qasjen islame të filozofisë, që nga shekulli XI, bota perëndimore filloi të mbante një qëndrim gjithnjë e më të zbutur ndaj filozofisë, ndryshe nga ai skolastik, që i kishte përfshirë prej shekujsh, i cili solli si pasojë Mesjetën e errët të tyre. Kështu perëndimorët, duke përkthyer në latinisht dhe gjuhë të tjera librat filozofikë të myslimanëve, filluan të interesoheshin për filozofinë. Në një farë mënyre, myslimanët u bënë për perëndimorët një urë lidhëse me shkencën dhe filozofinë. ("Felsefe", I. Ans., v. 12, fq. 317.)

Madje, një seri studiuesish perëndimorë, gjatë aty-

re kohëve, nuk u mjaftuan vetëm me librat e përkthyer, por vajtën vetë në medresetë dhe qendrat kulturore të botës islame, në Spanjë, Afrikë Veriore, Siri, Iran etj., për t'u njohur me filozofinë islame në veçanti dhe me qytetërimin islam në përgjithësi, si dhe mblodhën anekënd botës islame vepra të ndryshme me vlerë, për t'i përkthyer në gjuhët perëndimore. Për arsye të pushtetit që kishte krijuar gjuha arabe, universitetet më prestigjioze të kohës, p.sh., *Montpellier* dhe *Paris* të Franës apo *Oxfordi* i Britanisë, kishin përfshirë gjuhën arabe në kurrikulën e sistemit universitar. Edhe mbretërit e shquar të kohës, si mbreti i Sicilisë **Roger II** (1127 -1154) dhe i biri **Williami I** (1154 -1166), mbanin në administratë këshilltarë dhe përkthyes myslimanë.

Ndërkohë që perëndimorët po njiheshin me **Aristotelin** dhe **Platonin**, mësonin edhe filozofinë islame, përmes librave të myslimanëve. Kështu, në Perëndim, në shekullin XI nisi të zhvillohej mendimi filozofik. Teologët françeskanë u ndikuan më së shumti nga neoplatonizmi islam, duke e gërshetuar atë me agustinizmin. Domenikanët pëlqyen më shumë **Farabiun** dhe **Ibn Sinain** dhe aristotelizmin e tyre. Kurse disa të krishterë të tjerë dhe shumica e hebrenjve, që jetonin në Perëndim, pëlqenin ibnrushdizmin (averroizmin).

Ibnrushdizmi ishte një prej rrymave që pati ndikim të shpejtë dhe thajse reformator në teologjinë e krishterë të kohës. Ajo i dha një goditje të madhe, veçanërisht doktrinës së krishterë. Racionalizmi ibnrushdian dhe disa keqinterpretime të kësaj rryme, bënë që të lindnin mendime kundër Kishës. Madje, ibnrushdizmi u bë shkak që të shfaqen rryma ateistike në Perëndim. Nga shekulli XII, pasi e vunë re këtë situatë që kishte krijuar ibnrushdizmi, teologët françeskanë dhe domenikanë nisën të luftonin ibnrushdizmin. Arma më e përshtatshme për të luftuar ibnrushdizmin ishte gazalizmi. **Albertus Magnus** dhe **Toma Akuini** kanë mbajtur një qën-



drim tërësisht gazalist dhe kanë shkruar antiteza ndaj ibnrushdizmit.

Sado që në shekullin XIII dhe XIV gazalizmi dominonte si qasje filozofike, në shekullin XV u rikthye në vëmendje **Ibn Rushdi** dhe rrymat që lindën prej tij. Kjo situatë luajti një rol të rëndësishëm për të nisur lëvizjet e Rilindjes dhe Reformës europiane. Në shekujt në vijim vazhduan përkrahjet gazaliste dhe ibnrushdiste. Filozofia më e rëndësishme e kohës, në krye të së cilës ishte **Dekarti**, ishte karteizianizmi, e cila nuk ishte asgjë tjetër veçse vazhdimi i ibnrushdizmit. Veçanërisht në shekullin XVII, me popullarizimin e filozofisë së **Ibn Tufejlit**, në Perëndim fillon periudha e iluminizmit. Në themelet e filozofisë së iluminizmit, e cila karakterizohet me lindjen e empirizmit dhe të natyralizmit, si dhe me rigjallërimin e materializmit, qëndron **Ibn Tufejli** dhe interpretimi i tij nga perëndimorët.

Ky progres pozitiv, që e bëri Perëndimin të zgjohej nga gjumi 500- vjeçar, kishte dhe një aspekt negativ. Disa përkthyes dhe shkrimtarë, që bënë përmbledhje dhe qëmtime nga veprat e myslimanëve, nuk shënuan emrin e autorit të vërtetë të vaprave, por vendosën firmën e tyre në fund. Kjo situatë vazhdoi në një mënyrë të atillë, sa që shkrimtarët perëndimorë që erdhën pas shekullit XVI, nuk u bënë as edhe një referim të thjeshtë atyre mendimtarëve dhe shkencëtarëve myslimanë që i shfrytëzuan për shekuj të tërë.

Tani le të përmendim vetëm disa nga filozofët myslimanë që ndikuan, aq sa i dhanë tjetër rrjedhë mendimit perëndimor:

## 1. NDIKIMI I KINDI-T

Filozofi i parë dhe shkencëtari mysliman **el-Kindi** (vd. 873), i njohur në Perëndim si **Alkindus**, ka bërë aq efekt në botën perëndimore, sa që matematikani dhe fizikani italian **Girolamo Cardano** (1501-1576), në librin e tij *"De Subtilitate"* shprehet se sipas tij, **Kindi** është një nga dymbëdhjetë mrekullitë që kishin ardhur gjer në atë kohë. Kurse filozofi më i madh i Rilindjes, **Giordano Bruno**, shprehet në këtë mënyrë për **Kindin**: "Nuk ka më të ditur nga të diturit e parë, sesa filozofi arab **el-Kindi**. **Ibn Rushdi** është ndikuar nga veprat e tij. A nuk është kjo provë e mjaftueshme për të shprehur potencialin e **Kindit**?" (Quandri, La Philosophie arabe d'après les sources latines, Payot.)

Një seri filozofësh të krishterë kanë mbetur nën ndikimin e **Kindit**, përmes librave të tij të përkthyer

në latinisht. Në mesin e filozofëve të parë perëndimorë, që janë ndikuar nga **Kindi**, janë **Guillaume d'Auvergne** dhe **Albertus Magnus**. Të dy mendimtarët kanë pëlqyer klasifikimin e shkencave që ka bërë **Kindi**. I dyti ka shkruar një vepër me titull *"De Somno et Vigilia"*, të ndikuar tërësisht nga vepra e **Kindit**, e përkthyer në latinisht *"De Somno et Visione"*. **Toma Akuini** ishte një nga ata që kishte mbetur po ashtu nën ndikimin e **Kindit**, i cili në veprën *"Summa contra Gentiles"*, kuptohet qartë se ka pëlqyer teorinë e **Kindit** për mendjen.

## 2. NDIKIMI I FARABIUT

Një nga filozofët myslimanë, që ka bërë më së tepërmi efekt tek mendimi perëndimor i krishterë dhe hebraik, është **Farabiu** (vd. 950) apo siç njihet në Perëndim, **Alpharabius**. Ai, që kur ishte gjallë, është bërë i njohur në Perëndim përmes filozofëve hebrej **Ibn Masarra** (vd. 931) dhe **Ibn Gabriel** (vd. 1058).

Klasifikimin e shkencave që ka bërë **Farabiu**, thuhet se të gjithë filozofët perëndimorë, deri të kohëve të vona, e kanë përsëritur në mënyrë të njëjtë. Për shembull, mes librit *"De Divisione Philosophiae"* të **Dominicus Gundissalinus**-it (shek. XII) dhe librit *"Ihsau'l-Ulum"* të **Farabiut**, thuhet se nuk ndryshon asgjë.

Një nga fushat ku ndikimi i **Farabiut** vërehet qarta, është teoria e mendjes dhe kategoritë e mendjes. Filozofët e krishterë të Mesjetës: **Albertus Magnus** dhe **Toma Akuini** e përmendin me emër **Farabiun** dhe flasin për kontributin e tij në filozofi.

Këta filozofë janë ndikuar veçanërisht nga përkufizimi që i bëri **Farabiu** qenies. Shihet qartazi se **Toma Akuini** e ka pëlqyer mendimin e **Farabiut**, ndaj nuk e ka ndryshuar fare në librat e tij. Provat që jep **Farabiu** për ekzistencën e Zotit dhe interpretimi i tij për cilësitë e Zotit, mund të gjenden në veprën *"Summa Theologia"* e **Toma Akunit**, në mënyrë të njëjtë dhe të pandryshuara fare.

Mes epistemologjisë së **Farabiut** dhe **Toma Akunit** ka aq ngjashmëri, sa që mund të thuhet pa frikë se ai kopjoi edhe epistemologjinë e **Farabiut**. Këtë mund ta vërejmë tek shpjegimet që bëri **Akuini** për rolin e shqisave në arritjen e dijes, funksionet e fuqisë mendore dhe shpirtërore për të krijuar dijen dhe tek trajtimi i çështjes se sa mendja njerëzore mund të arrijë njohjen e Zotit.

Le të japim disa shembuj, sa për ta konkretizuar pak:

**Farabiu** për lëvizjen:

Në këtë botë ka gjallesa që lëvizin. Çdo gjallesë lëviz përmes një lëvizësi. (Vepra "Ujunu'l-mesail")

**Toma Akuini:**

Përmes shqisave tona vërejmë haptazi se në këtë botë ka gjallesa që lëvizin. Çdo gjallesë e bën të lëvizë një tjetër gjallesë. (Vepra "Summa")

**Farabiu:**

Në këtë botë, që është në ndryshim të vazhdueshëm, çdo gjallesë ka një shkak dhe ky shkak është vepër e një shkakut tjetër. (Vepra "Fususul-hikem")

**Akuini:**

Në këtë botë vërejmë një rend shkaqesh efektive. (Vepra "Summa")

**Farabiu:**

Allahu është një qenie e pashkak dhe e pafund. (Vepra "Sijasetul-medenije")

**Akuini:**

Zoti në mënyrë absolute është i pafund. (Vepra "Summa")

### 3. NDIKIMI I IBN SINAIT

**Ibn Sinai** (vd. 1037) apo **Avicenna**, siç njihet nga perëndimorët, është filozofi mysliman që ka ndikuar më së shumti në Perëndim. **Alexandre de Hales** (1180 - 1245) dhe **Guillaume d'Auvergne** (1190 - 1249) janë dy nga filozofët e parë të krishterë, tek të cilët vërehen gjurmët e filozofisë së **Ibn Sinait D'Auverge** e përmend **Ibn Sinain** krahas **Aristotelit**, si "Filozofi fisnik". Për shembull, vetëm në veprën "De Universe" të tij, **Ibn Sinait** i referohet mbi tridhjetë herë. **D'Auverge**-n e pasojnë **Duns Scot**, **Toma Akuini**, **Bonaventure**, **Albertus Magnus** dhe **Roger Bacon**. Prej këtyre, **Albertus Magnus** (1208 - 1280), i referohet **Ibn Sinait** thuajse në secilën faqe të veprave të tij. **Williami i Okamit** është një nga ibnsinaistët e parë të shekullit XIV. Kurse **Dekarti**, si një prej grupit të filozofëve modernë më të ndikuar nga **Ibn Sinai**, përmend në mënyrë të njëjtë arsytimin e **Ibn Sinait** lidhur me ekzistencën e shpirtit, madje shembullin "Njeriu fluturues" (përkth. Lat.:

"L'homme volant") të **Ibn Sinait**, **Dekarti** e përmend tekstualisht për të argumentuar ekzistencën e shpirtit jashtë trupit.

Përkthimi në latinisht që iu bënë veprave të **Farabiu** dhe **Ibn Sinait**, shërbeu për të lulëzuar dhe zhvilluar edhe rryma agustiniste. Sipas historianit francez të filozofisë **Etienne Gilson**, **Ibn Sinai** ndikoi në mendimin perëndimor përmes veprave të tij dhe përmes veprave të **Gazaliut** të përkthyer nga **Gundissalvi**. (H. Z. Ulken, Islam Felsefesi, fq. 277 - 281)

### 4. NDIKIMI I GAZALIUT

**Gazaliu** (vd. 1111) apo siç njihet në Perëndim **Algazel**, është një filozof, që në botën perëndimore ka ndikuar jo më pak se **Ibn Sinai** apo **Ibn Rushdi**. **Raymond Martinis**, **Alexandre de Hales** dhe **Guillaume d'Auvergne**, janë vetëm disa nga shumë ithtarët e **Gazalit**.

Veprat "Pugio Fidei" dhe "Esplanatio Symbili" të **Raymond Martinis** nuk janë gjë tjetër veçse një qëmtim nga veprat e përkthyer në latinisht të **Gazaliut**. Kurse në veprën "Polignard" të **Alexandre de Hales**, vërehet hapur se si është i ndikuar ai nga **Gazaliu**, kur kritikon **Ibn Rushdin** dhe ibnrushdistët perëndimorë.

**Guillaume d'Auvergne**, në veprën "De Anima", vërejmë se i është referuar mendimit të **Gazaliut** për mendjen. Në krye të gazalistëve të vërtetë ishin **Albertus Magnus** dhe **Toma Akuini**. Veçanërisht ky i fundit, në veprën "Summa Theologica", i referohet shpesh **Gazaliut**. Një tjetër gazalist është edhe **Raymond Lulle**, i cili në kritikën që i ka drejtuar **Ibn Rushdit**, ka përdorur metodën e njëjtë me atë të **Gazaliut** kur kritikonte filozofët.

Filozofët intuitistë dhe skeptistë, si **Williami i Okamit**, **Nikolas d'Antrecourt** dhe **Peter d'Ally**, janë ndikuar nga qasja nominaliste dhe metodologjia skeptiste e **Gazaliut**.

Studiuesi i Islamit, njëkohësisht dhe prifti katolik roman **Miguel Asin Palacios**, në shumë vepra të tij, veçanërisht në "Huellas del Islam" dhe në "La espiritualidad de Algazel y su sentido cristiano", shpjegon gjatë se si **Gazaliu** ka ndikuar në një shtresë të gjerë filozofësh dhe teologësh perëndimorë. **Palacios**, vetëm në krahasimin e veprës "El-Munkidhu mine'd-Dalaletu" të **Gazaliut** dhe "Pensées" të **Paskalit**, tregon një seri ngjashmëri mes tyre. Le t'i përmendim



disa prej tyre:

- **Paskali**, ashtu sikurse **Gazaliu**, mendon se shqisat mund të na shpjen në mendime të gabuara.

- Në mënyrë të njëjtë me atë çfarë shpreh **Gazaliu** tek "*Munkidhi*" edhe **Paskali** tek "*Pensées*" shprehet për raportin e së vërtetës me ëndrrën, që jeta është një ëndërr dhe zgjimi nga kjo ëndërr realizohet përmes vdekjes dhe se ëndrra është e vërteta.

- Që të dy filozofët e gjejnë shpëtimin nga skepticizmi, në misticizëm dhe në frymëzimin hyjnor (tek **Gazaliu**: *nur*).

- "*Logjika e zemrës*" (*Logique du coeur*) e **Paskalit** është e njëjtë me teorinë e **Gazaliut** "*Syri i zemrës*".

- Stili i shkruar i këtyre dy veprave, po ashtu është i njëjtë: arsyetim i zbritur në nivelin e masës së gjerë.

- Që të dy thonë të njëjtën gjë: *Zoti ndihet me zemër, jo me mendje* (Dieu est sensible au coeur, non a la raison).

**Palacios**, gjithashtu, tregon në mënyrë të gjerë ngjashmërinë e pamohueshme, madje kopjimin e teorisë së "*Bastit*" të **Gazaliut** nga **Paskali**, me teorinë e njëjtë "*Le Pari*" (shqip: basti), si provë e argumentimit të pafundësisë së shpirtit dhe e ekzistencës së botës së amëshuar (ahiretit).

Gjithashtu, **Dekarti** është i ndikuar nga skepticizmi metodik i **Gazaliut**, kurse **Malebranche** nga okazionalizmi i tij. Mes **Kantit** dhe **Gazaliut**, po ashtu, shihet një ngjashmëri në trajtimin e kategorive. **Clarke** duhet kujtuar si një tjetër gazalist i shekullit XVII, pasi ai ka mbajtur qëndrim gazalist ndaj qëndrimit ibnrushdist të **Leibniz-it**, gjatë diskutimeve mes tyre.

## 5. NDIKIMI I IBNRUSHDIT

**Michel Scot** dhe **Hermann l'Allemand** janë dy nga filozofët e parë të krishterë, që janë ndikuar nga **Ibn Rushdi** (vd. 1198) apo **Averroes**, siç njihet në Perëndim. Por ithtarët e flaktë të **Ibn Rushdit** janë ata të shekullit XII: **Amaury de Bene**, **David de Dinant** dhe studentët e tyre: **Robert de Courçon** dhe **Maurice Espagnol**. Pasues të tyre janë: **Alexandre de Hales** dhe **Robert de Lincoln**. Por ai që e ka lëvduar më shumë **Ibn Rushdin** është **Guillaume de'Auvergne**. Libri i tij "*De Universe*", është mbushur me referime të **Ibn Rushdit**.

Në krye të shekullit XIII janë **Roger Bacon** dhe **Toma Akuini**, ata që janë ndikuar më shumë nga **Ibn Rushdi**. **Toma Akuini** nuk është mjaftuar vetëm me pëlqimin e mendimeve të **Ibn Rushdit**, por ai rrëfen se metodën e komentimit që i bën **Ibn Rushdi Aristotelit**, e ka përdorur edhe ai gjatë komenteve që u ka bërë mendimeve të **Aristotelit**. Por ato mendime të **Ibn Rushdit**, që binin ndesh me Krishtërimin nuk i pëlqente dhe i refuzonte, si për shembull, doktrina e njësisimit të mendjes. **Duns Scot**, megjithëse ishte kritik i ibnrushdizmit, pëlqente doktrinën "*materia pa formë*" të **Ibn Rushdit**. (Renan, *Averroes et l'Averroisme*, *Oevres Completes*, Paris, 1949, v. III, fq. 189.)

Ibnrushdizmi ishte një rrymë kaq kërcënuese në syrin e Kishës, sa që në tre konsilet e organizuara në Paris, në vitet 1209, 1215 dhe 1277, kjo rrymë është shpallur e ndaluar dhe **Ibn Rushdi** është shkishëruar. Gjatë kësaj fushate të ndërmarrë nga klerikët kishtarë, në vitin 1266 u vra ibnrushdisti i famshëm latin **Siger de Brabant**, kurse **Orvieto** u burgos gjer në vdekje. (Frederick Copleston, *A History of Philosophy*, New York, 1999, v. II, fq. 139 - 141.) Një tjetër ibnrushdist, që është djegur nga Kisha, në vitin 1512, në Den Haag, për arsye të përkrahjes së ideve të **Ibn Rushdit**, është edhe hollandezi **Hermann van Riswik**. Megjithëse ibnrushdizmi u luftua shumë në Spanjë, Francë etj., natyrshëm nuk arriti të zhdukej, pasi ishte përhapur në të gjithë Europën. Ibnrushdizmi kishte lëshuar rrënjë në shumë shkolla të mjekësisë dhe të filozofisë, si ajo e Venecias dhe e Padovas.

**Montenji**, **Dekarti**, **David Hume**, **Spinoza** dhe **Leibnizi**, janë vetëm disa nga filozofët evropianë të ndikuar nga **Ibn Rushdi** dhe që mbronin hapur idetë e tij. Idetë e **Ibn Rushdit** bënë efektin e tyre edhe tek **Auguste Komte**, sa të formulonte humanizmin, e cila përbën themelin e filozofisë komtiane.

Ibnrushdizmit nuk i dhanë goditje vetëm Kisha, me vrasjen e ndjekësve të tij apo me djegien e veprave të **Ibn Rushdit** në sheshin e Granatës, së bashku me 80.000 kopje të tjera librash arabisht të qytetërimit islam me urdhër të kardinalit françeskan **Francisco Ximenez de Cisneros**, por edhe vetë myslimanët, veçanërisht fushata shkatërruese e muvahhidunëve (selefite e kohës).

Muslimi, Ahmedi dhe të tjerë, transmetojë nga Xhabir bin Abdilahi (r.a.), se Pejgamberi (s.a.v.s.), ka thënë: "Për çdo sëmundje ka ilaç e, kur ilaçi është i përshtatshëm, atëherë i sëmuri shërohet me lejen e Zotit."

Ahmedi, Nesaiu dhe të tjerë, transmetojnë nga Usame bin Sherik, i cili ka thënë: Isha te Pejgamberi (s.a.v.s.), ku erdhën disa arabë dhe e pyetën: "O Pejgamber i Zotit! A të mjekohemi?" Pejgamberi (s.a.v.s.), u përgjigj: "Po, o robërit e Allahut, kërkoni mjekim, se Allahu (xh.sh.), nuk ka dërguar sëmundje që nuk ka shërim, përveç njërës!" Ata thanë: "Cila është ajo?" Ai u përgjigj: "Pleqëria".

Tirmidhiu, Ahmedi dhe të tjerë, transmetojnë nga Ebu Hurejra (r.a.), i cili ka thënë: I pata thënë Pejgamberit (s.a.v.s.): "O Pejgamber i Zotit! Çfarë mendon për ne që këndojmë Kuran për shërim, përdorim ilaçe për mjekim dhe ruhem nga disa gjëra që të mos sëmuremi. A e ndryshojnë këto caktimin e Zotit? Pejgamberi (s.a.v.s.), u përgjigj: "Kjo është prej caktimit të Zotit!"



## PËRGJEGJËSIA MJEKËSORE

### HYRJE

Sheriati islam, duke u mbështetur në rregullat dhe parimet e përgjithshme të tij, është në gjendje të shpjegojë çdo çështje që paraqitet tek njerëzit, ndaj me të drejtë thuhet se ky shariat është në gjendje të përballet me çdo çështje dhe problematikë të parashtruar. Me shumë të drejtë, myslimanët mund të mburren me legjislacionin e tyre hyjnor. Të gjithë juristët bashkëkohorë janë ndikuar direkt nga parimet dhe rregullat e shariatit islam, për drejtësinë që shpreh ky shariat dhe për të mirat që i sjell shoqërisë islame në veçanti dhe shoqërisë njerëzore në përgjithësi. Kjo rezulton në faktin se ky shariat, si burim të vetëm ka Ligjdhënësin Absolut, Allahun e Madhërishtëm. Në një ajet kuranor thuhet: **"Vërtet, gjykimi i përket vetëm Allahut."** Po ashtu, i Dërguari (s.a.v.s.), thotë: "Ajo që ka lejuar Allahu në Librin e Tij, është hallall dhe ajo që e ka ndaluar Allahu në Librin e Tij është haram e, atë që e ka lënë në heshtje, është për shkak të mëshirës së Tij ndaj jush."

Tematika në fjalë është shumë e rëndësishme, sepse kemi

të bëjmë me një përgjegjësi, që ka lidhje me çështjen vitale të njeriut, siç është shëndeti. Ndaj, nëse analizojmë studimin e dijetarëve klasikë dhe atyre bashkëkohorë, do të shohim se ata kanë qenë shumë të preokupuar me këtë tematikë dhe për rëndësinë e saj në jetën njerëzore. E shohim të arsyeshme të sjellim një historik të shkurtër rreth qëndrimeve që kanë pasur popujt e shumtë për rëndësinë e përgjegjësisë mjekësore.

Pjesa dërmuese e shkencëtarëve janë të mendimit se mjekësia është shkenca më e vjetër që ka njohur njeriu, që në zanafillën e jetës së tij. E shohim të arsyeshme të paraqesim disa mendime të popujve të ndryshëm, deri para shariatit islam. Sipas bindjeve të kota e të hershme, sëmundjet janë të lidhura me djallin e mallkuar dhe ai është shkaku kryesor për paraqitjen e tyre. Kur njeriu ka vdekur, është thënë se atë e ka mundur shejtani, prandaj kanë pasur bindjen se nuk duhet kërkuar kurrfarë përgjegjësie prej mjekut, ngaqë sipas tyre, çdo gjë ka qenë e varur prej falltarëve.



Mjekësia ka qenë shumë e njohur edhe tek egjiptianët e vjetër, të cilët, për shkaqet e shërimit të sëmundjeve vepronin vetëm sipas rregullave, që ishin të shkruar në një libër, i njohur si *"Es-Seferul Mukaddes"*, ndaj secili mjek e ka pasur për detyrë që të ndjekë rregullat e këtij libri gjatë mjekimit të të sëmurëve. Nëse mjeku bënte të kundërtën e asaj që përmendej në atë libër dhe i sëmuri vdiste, atëherë mjeku detyrohej të paguante gjakun e të vdekurit.

Në kohën e babilonasve ishin vendosur rregulla të prera për ushtrimin e profesionit të mjekësisë dhe kështu, mjeku merrej në përgjegjësi për gabimet e bëra, sa që ka ndodhur që i është ndaluar ushtrimi i profesionit. Në ligjin e "Hamurabit", neni 128 është shumë i ashpër në aspektin e dënimit për gabimin e mjekut. Aty thuhet: *"Kur mjeku trajton plagën e ndonjë personi, që ka statusin i lirë dhe gjatë shërimit shkakton vdekjen e tij apo i shkakton ndonjë plagë në sy, atëherë mjeku duhet t'i priten duart."*

Në epokën e grekëve, rol të rëndësishëm për shërim kanë pasur magjia dhe talismanët, derisa erdhi Hipokrati, që njihet si babai i mjekësisë, i cili ndikoi shumë në pastrimin e mjekësisë prej ndikimeve të tilla, duke u angazhuar për një mjekësi reale dhe të saktë. Është i njohur betimi i Hipokratit dhe, duke u bazuar në këtë betim, mjeku lirohet nga përgjegjësitë, nëse u përmbahet rregullave të betimit. Në atë kohë, mjeku nuk dënohej. Për këtë, Platoni thotë: *"Mjekët e marrin shpërblimin e tyre, pavarësisht nëse i shërojnë të sëmurët apo i mbysin. Ata kanë imunitet duke mos marrë kurrfarë përgjegjësie për ushtrimin e detyrës së tyre..."* Përkundër kësaj, Aleksandri i madh kishte urdhëruar që ta gozhdonin mjekun e njohur me emrin Gelokis, në Aleksandri, sepse ishte treguar neglizhent në trajtimin e një të sëmuri, i cili, për këtë shkak kishte vdekur.

Në kohën e Bizantit nuk ka pasur ligje të caktuara për ushtrimin e profesionit të mjekut, por ata e konsideronin injorancën në çështjet e mjekësisë, si pengesë për ushtrimin e këtij profesioni dhe gabimi i bërë, për shkak të mungesës së njohurive profesionale të mjekut, duhej kompensuar. Dënimi që përfshinte mjekun në këtë kohë, varej prej statusit të tij: nëse ishte me status të ulët në shoqëri, ekzekutohej, nëse i sëmuri vdiste për shkak të tij, por nëse mjeku kishte status të lartë në shoqëri, internohej në ndonjë ishull.

Në kohën e mesjetës, në Evropë ishte ligj që, nëse i sëmuri vdiste për shkak të injorancës apo të neglizhencës së mjekut, atëherë mjeku i dorëzohej familjes së të vdekurit si rob dhe familja kishte mundësi të bënte zgjedhjen: ta mbyste apo ta mbante si rob.

Në kohën e kryqëzatave, derisa ishin të krishterët në Kuds, aty nga shekulli XII dhe XIII, gjykatat kishin përcaktuar që mjeku të ishte përgjegjës për gabimet e tij. Nëse nga injoranca e tij mjeku bëhej shkak për vdekjen e të sëmurit, që kishte statusin e robit, atëherë ai obligohej t'ia paguante gjakun e tij nënës së të vdekurit dhe të braktiste qytetin. Nëse i vdekuri ishte me status të lirë dhe mjeku, nga pakujdesia apo trajtimi jo i përshtatshëm, i shkakonte sëmundje më tepër, por jo vdekjen, mjeku i këpentej dora. E, nëse ishte shkak për vdekjen e të sëmurit, atëherë ekzekutohej me varje.

Kështu ka qenë në përgjithësi gjendja e trajtimit të përgjegjësisë mjekësore para ardhjes së shariatit islam...Gjatë gjithë kohëve, para ardhjes së shariatit islam, ka mbizotëruar shërimi duke u mbështetur më së shumti në magji dhe talismane të ndryshme dhe nuk kanë ekzistuar kurrfarë ligjesh të qarta dhe të drejta, bazuar në logjikën e shëndoshë, për çështjen e përgjegjësisë së mjekimit.

Thirrja islame sjell që në fillimet e saj ligje të përcaktuara prej Allahut të Madhërishëm dhe të Dërguarit të tij, me të cilat e rregullon jetën e shoqërisë në mënyrën më të mirë të mundshme. Po në të njëjtën kohë, bën thirrje për braktisjen e magjisë dhe shërimit me talismane, duke kërkuar të silltet drejtësia dhe t'i jepet haku çdokujt. I Dërguari (s.a.v.s.), ka thënë: *"Kush shkon te parashikuesi apo falltari dhe i beson asaj që thotë ai, ka vepruar sikur të kishte mohuar atë që ka sjellë Muhamedi."* I Dërguari (s.a.v.s.), i ka vendosur rregullat dhe parimet e fesë së pastër islame, duke u bazuar në shpalljen e Allahut të Lartësuar, mbi bazat e drejtësisë dhe logjikës së shëndoshë, duke përfshirë në këto parime të gjitha çështjet fetare dhe të kësaj jete. Përveç kësaj, Allahu i Lartësuar dhe i Dërguari i Tij, na kanë urdhëruar të studiojmë dhe meditojmë sa më shumë dhe të gjykojmë në mes të njerëzve me drejtësi.

Duhet të theksojmë se metodat dhe studimet që kanë të bëjnë me mjekësinë, të përcaktuara prej islamit, kanë ndriçuar gjithë botën. Sheriati islam ka përcaktuar qysh në etapën e parë ligjet dhe parimet, që duhet respektuar dhe zbatuar për ushtrimin e detyrës së mjekut, ligje të cilat janë bazuar në drejtësi dhe logjikë të shëndoshë.

## **NORMA E MJEKIMIT NË SHERIATIN ISLAM**

Në të drejtën islame, mjekimi është obligim i prerë (farz). Andaj, që të gjithë dijetarët dhe juristët islamë janë unanimë se studimi i mjekësisë është obligim kolektiv (farzi kifaje), që do të thotë se patjetër, dikush prej shoqërisë duhet të merret me studimin e mjekësisë. Përndryshe, të gjithë janë përgjegjës para Allahut të Madhërishëm. Kjo, për shkak se mjekimi konsiderohet si nevojë e domosdoshme për shoqërinë.

Duke u nisur nga ky parim, sheriati islam e ka konsideruar studimin e mjekësisë obligim të prerë dhe me këtë veprim, u ka paraprirë shumë ligjeve njerëzore, që janë vendosur për këtë tematikë. Pa dyshim që mendimi i shariatit islam për çështjen është më i dobishëm dhe u paraprin të gjitha ligjeve bashkëkohore, sepse e ka obliguar mjekun t'i vendosë në shërbim të masës të gjitha aftësitë dhe potencialin shkencor që zotëron. Sheriati islam i ka harmonizuar më së miri çështjet e solidaritetit të ndërsjellë, duke kërkuar të vihet në shërbim çdo gjë për masën e gjerë të shoqërisë.

## **KUSHTET E PËRGJEGJËSISË SË MJEKIMIT NË SHERIATIN ISLAM**

Prej rregullave dhe parimeve të shariatit islam, që kanë të bëjnë me mjekimin, është përgjegjësia për dëmin që i shkaktohet tjetrit, për shkak të padijenisë profesionale. Për mjekun injorant i Dërguari (s.a.v.s.), ka thënë: *"Ai që e ushtron detyrën e mjekut dhe nuk ka njohuri për mjekësi, ka përgjegjësinë e kompensimit"*.

Të gjithë juristët myslimanë janë të mendimit se është obligim të pengohet mjeku injorant në ushtrimin e detyrës. Parimet e njohura në shariatit islam pengojnë tre vetë në ushtrimin e profesionit: myftiun e paedukatë, mjekun injorant dhe kokëtrashin që ka falimentuar. Për këtë çështje imam Ahmedi (r.a.), ka thënë: *“Kur një person, që nuk ka njohuri të mjaftueshme për mjekësi, e ushtron këtë detyrë, veprimi i tij është i ndaluar-haram.”*

Juristët myslimanë kanë përcaktuar rregullin që, nëse mjeku injorant e trajton të sëmurin me lejen e tij (pacienti mendon se mjeku ka njohuri), atëherë, nëse pacienti vdes apo pëson ndonjë dëmtim gjatë trajtimit, në këtë rast mjeku është i obliguar të kompensojë, duke paguar për mbytje (dijjetu-nefs<sup>1</sup>) apo duhet të bëjë kompensimin e shkaktimit të dëmit, në varësi të rrethanave. Por të gjithë dijetarët mohojnë ekzekutimin e mjekut injorant, ngaqë mjekimi është bërë me lejen e pacientit.

Mjeku që është i aftësuar në profesionin e tij, nuk merret në përgjegjësi për dëmin që mund t'i shkaktohet pacientit gjatë trajtimit, edhe nëse pacienti vdes, kur është marrë leja prej pacientit dhe mjeku të mos këtë bërë ndonjë gabim të pafalshëm.

Sipas parimeve të shariatit islam ndërhyrja e mjekut, kur kërkohet apo i jepet leje për ndërhyrjen, përbën obligim të prerë (farz) për veprim, dhe ky obligim nuk është i kushtëzuar me shpëtimin e pacientit.

Sipas konsensusit të juristëve myslimanë, mjekimi është obligim i prerë, mirëpo juristët kanë divergjencë rreth shkakut (iletit) të zbatimit të përgjegjësisë mjekësore. Ebu Hanife (r.a.), mendon se shkakun qëndron në domosdoshmërinë e shoqërisë për mjekim dhe vetë dhënia e lejes për kurim nga pacienti apo kujdestari i tij. Imam Shaf'i (r.a.) dhe Ahmedi (r.a.), janë të mendimit se shkakun është leja e pacientit për t'u mjekuar dhe se mjeku ka për synim përmirësimin dhe shërimin e të sëmurit e jo dëmtimin e tij. Imam Maliku (r.a.), është i mendimit se shkakun i kësaj, është vetë leja që jep prirësi për mjekim dhe leja prej pacientit. Kur të bashkohen këto dy kushte, atëherë mjeku nuk ka përgjegjësi, nëse ndodh ndonjë dëmtim apo pacienti vdes.

Sipas dijetarëve islamë, mjeku nuk mund të merret në përgjegjësi, po qe se i plotëson këto kushte:

- 1. Leja e prirësit, (me këtë nënkuptohet licenca zyrtare),**
- 2. Pëlqimi i të sëmurit,**
- 3. Synimi për t'u shëruar,**
- 4. Gabimi të mos jetë prej vetë mjekut.**

#### SHËNIM

Shkencëtarët dhe dijetarët bashkëkohorë, pas gjithë studimeve dhe gjurmimeve shkencore, kanë arritur në përfundimin e njëjtë të përgjegjësisë mjekësore, ashtu siç i ka përcaktuar e drejta islame. Shumë ligje njerëzore janë pothuajse identike me rregullat dhe ligjet e shariatit islam, në aspektin e përgjegjësisë mjekësore.

1. Me këtë pagesë nënkuptohet pagesa në vlerë të njëqind deveve.

#### GABIMI PËR TË CILIN MJEKU DUHET TË MERRRET NË PËRGJEGJËSI, SIPAS SHERIATIT ISLAM

Kemi përmendur më lart se njëri prej kushteve, që nuk mund të merret në përgjegjësi, është që mjeku të mos ketë gabuar dhe për shkak të gabimit të tij, pacienti të jetë dëmtuar apo të ketë vdekur. Gabimi për të cilin mjeku duhet të merret në përgjegjësi, është ai lloj gabimi, që sipas mjekësisë, mjeku nuk guxon kurrsesi ta bëjë. Sipas kësaj, mjeku nuk mund të merret në përgjegjësi për një gabim të lehtë që mund ta bëjë çdo mjek.

Ky qëndrim i dijetarëve të sotëm myslimanë nuk ndryshon nga qëndrimet e dijetarëve klasikë të para disa shekujve, rreth kësaj çështje.

**Shënim:** Sipas shariatit islam, mjek i mirë konsiderohet ai mjek, i cili gjithmonë është i angazhuar në gjurmime dhe studime, me qëllim që të jetë gjithmonë i aftë për ta ushtruar detyrën e tij. Mjeku nuk duhet të bëhet neglizhent dhe për shkak të neglizhencës, të mos jetë në gjendje t'i përshkruajë pacientit ilaçin e përshtatshëm apo të mos e trajtojë sëmundjen ashtu siç kërkohet. Nëse mjeku e dëmton të sëmurin për shkak të neglizhencës apo e trajton gabimisht, atëherë ai merret në përgjegjësi. Për këtë, juristët myslimanë kanë përcaktuar rregullin, sipas të cilit mjeku duhet të bëjë kompensimin e dëmtimit të pacientit, kur e dëmton pacientin apo vonon shërimin e tij. Të gjithë juristët janë të mendimit se, pavarësisht gabimit që mund të bëjë mjeku, qoftë edhe për shkak të injorancës së tij, nuk ndëshkohet me kisas, d.m.th. në masë të njëjtë me dëmin që ka sjellë.

Sipas shariatit islam, mjekut duhet t'i jepet liri e plotë në angazhimet dhe studimet e tij, me qëllim që të arrijë deri tek mjeti-trajtimi më i përshtatshëm për shërimin e sëmundjes. Veç kësaj, nga mjeku kërkohet që ta shkruajë përvojën e tij, me qëllim që të tjerët pas tij të përfitojnë. Nga kjo kuptohet se thirrja islame fton besimtarin që të angazhohet dhe të japë mundin maksimal për të arritur deri te e sakta dhe e vërteta, ndaj nëse gjatë studimeve dhe gjurmimeve mund edhe të gabojë, sipas së drejtës islame ka shpërblime edhe nëse gabon, por nëse ia qëllon, ka dy shpërblime.

Pra, sipas së drejtës islame, mjeku i ka dyert e hapura për të bërë studime dhe kërkime shkencore në lëmin e mjekësisë dhe nuk duhet të merret në përgjegjësi, nëse mendon ndryshe prej kolegëve të tij, me kusht që mendimin ta ketë të mbështetur në fakte të shëndosha.

Po ashtu, mjeku nuk duhet të merret në përgjegjësi nëse i thotë pacientit: unë të siguroj se kurrfarë dëmi nuk do të pësosh nga trajtimi që do të të bëj. Arsyeja është se nuk merret kurrfarë kompensimi nga mjeku në rastin e tillë, për shkak se mjeku i është përmbajtur trajtimit siç kërkohet në aspektin mjekësor, nuk ka bërë ndonjë gabim të papranueshëm dhe se suksesi nuk varet prej tij.

Nga gjithë sa u përmend më lart, na bëhet e qartë se shariatit islam i kushton rëndësi të veçantë profesionit të mjekut dhe në të njëjtën kohë, u jep guxim mjekëve që të angazhohen sa më shumë në njohjen e profesionit të tyre.



## PËRFUNDIM

Çdo mysliman duhet të ketë parasysh zbatimin e rregullit të sheriatit islam: **“Nuk ka dëm e as të dëmtuar”**:

Maliku, Ibn Maxheh dhe Darekutnij, transmetojnë nga Ebu Seid el-Hudariu (r.a.), se Pejgamberi (s.a.v.s.), ka thënë: *“Nuk ka dëm e as të dëmtuar.”*

Juristët (fukahat) dhe dijetarët e bazës metodologjike të jurisprudencës islame, (usulinjet) e konsiderojnë këtë hadith si njëri prej rregullave më të rëndësishme të sheriatit islam, me anë të së cilës janë rregulluar shumë çështje që kanë të bëjnë me ruajtjen e personit dhe shoqërisë, duke larguar dëmin ndaj njerëzve...

Mbështetur në këtë rregull, edukatorët e posaçërisht nënat, janë të obliguara t'i udhëzojnë fëmijët se si të mbrojnë shëndetin dhe mjetet me të cilat mbrohet shëndeti i fëmijës, si forcohet trupi etj. Po ashtu, prindërit dhe edukatorët e kanë për obligim të kërkojnë ndihmë nga të specializuarit për të mbrojtur trupin nga sëmundjet infektuese dhe vdekjeprurëse...

- Meqë pemët e papjekura e dëmtojnë trupin dhe shkaktojnë sëmundje, edukatorët e kanë për obligim t'i këshillojnë fëmijët e tyre që të hanë vetëm pemë të pjekura.

- Meqë ngrënia e perimeve të papastruara shkakton sëmundje, edukatorët duhet t'i udhëzojnë fëmijët që perimet dhe zarzavatet t'i konsumojnë pasi t'i pastrojnë.

- Meqë konsumimi i shumë lloje ushqimesh në të njëjtën kohë shkakton sëmundje në lukth, në organet e frymarrjes dhe në organet e tretjes, edukatorët duhet t'i këshillojnë fëmijët të marrin çdo ushqim në kohën e caktuar.

Duhet të përmendim se i Dërguari (s.a.v.s.), i ka kushtuar shumë kujdes ruajtjes dhe mbrojtjes nga sëmundjet infektuese:

Muslimi, Ibn Maxhe dhe të tjerë, transmetojnë hadithin e Xhabir bin Abdilahit (r.a.), i cili tregon se me delegacionin e Thekifit ishte një njëri i sëmurë nga lebroza. Pejgamberi (s.a.v.s.), dërgoi dikë, duke i thënë: *“Kthehu, se ne ta kemi dhënë besimin ty.”*

- Buhariu transmeton se Pejgamberi (s.a.v.s.), ka thënë: *“Ik prej atij që është i sëmurë nga lebroza, siç ikën prej luanit”.*

- Buhariu dhe Muslimi, transmetojnë nga Ebu Hurejre (r.a.), se Pejgamberi (s.a.v.s.), ka thënë: *“Kurrsesi të mos shkojë i sëmuri tek i shëndoshi.”*

## LITERATURA

- Ibn Haxher el-Askalani “Fet’hul Barij”  
En-Neveviu “Sherhu Sahihil Muslim.”  
Ibn Kajjim el-Xhevziju: Zadul-Mead vol. III.  
Dr. Abdu Selam et-Tunxhij: El-Mesulijjetu Tibijeti- Mesulijjetu Tabibi  
Fil Ksanunil Mukarin-  
Alaudi-din el-Kesaniju : Beda’iu Sanai Fi Tertibi Shera’i.  
Abdulah Nasih Ulvan: Terbijetul Evladi  
Prof.dr. Vehbete Zuhajli “El-Fikhul Islamijju ve Dediletuhu.



# XHEHENEMI

Filologët arabë ndajnë pikëpamje të ndryshme në lidhje me etimologjinë e fjalës xhehenem. Sipas disave prej tyre, kjo fjalë është me origjinë arabe dhe ka kuptimin "pus i thellë, ogurzi". Të tjerët janë të mendimit se origjina e fjalës vjen nga hebraishtja e vjetër dhe është forma e arabizuar e fjalës hebreje ge-Hinnom. Në greqishten e vjetër përdoret fjala geena, ndërsa në latinisht fjala gehenna, të cilat variojnë që të dy nga hebraishtja.

Besimi tek xhehenemi ekziston pothuajse tek çdo besim që njihet deri më sot.

Fjala xhehenem përmendet në shtatëdhjetë e shtatë ajete të Kuranit fisnik. Xhehenem quhet vendi ku do të dënohen të gjithë qafirët, mynafikët, tiranët dhe ata që nuk i janë bindur të vërtetës së shpallur nga Zoti. Në Kuran janë përdorur edhe fjalë të tjera, për të shprehur emrin e vendit ku do të vuajnë dënimin në botën tjetër ata që nuk u janë bindur urdhrave të Zotit. Pesëdhjetë e një ajete janë mekase dhe njëzet e gjashtë janë medinase, nga shtatëdhjetë e shtatë ajetet ku përmendet fjala xhehenem. Ky fakt hedh poshtë edhe pretendimin e shprehur nga disa orientalistë, sipas të cilëve profeti Muhamed nuk kishte në fillimet e shpalljeve hyjnore ndonjë ide të qartë mbi xhehenemin, por atij i paska ardhur në ndihmë diskutimi që pati me një të krishterë etiopian, në lidhje me botën tjetër.

Në literaturën islame janë përdorur për të shprehur dënimin në jetën tjetër në përgjithësi apo një pjesë të atij dënimi në veçanti, fjalë të ndryshme, që janë sinonime me konceptin e xhehenemit. Vetëm shtatë prej tyre janë më të përdorurat dhe rrjedhimisht më të njohurat në literaturën islame, mbështetur edhe në faktin se në Kuran thuhet se xhehenemi ka shtatë porta (Hixhr, XV/44). Ato janë:

**1. Xhehenem:** Kjo është shtresa më e lartë e Xhehenemit, në përkufizimin e tij me shtatë shtresa. Në këtë shtresë, dënimi i jetës tjetër është më i lehtë, krahasuar me shtresat e tjera. Sipas dijetarëve të ehli sunetit, kjo shtresë është edhe niveli ku do të vuajnë dënimin myslimanët, të cilët kanë bërë më shumë gabime sesa vepra të mira në jetën e botës kalimtare. Pra, fjala xhehenem ka një kuptim të gjerë, që është i gjithë vendi ku do të shpaguhen gabimet, me anë të dënimeve që do të jepen dhe në një kuptim të ngushtë, është shtresa më e lartë e vendit të dënimit në botën tjetër.

**2. Xhahim:** Kjo fjalë në shqip do të thotë "zjarr i fuqishëm dhe shumë përcëllues, ku temperatura sa vjen e rritet". Kjo fjalë është përdorur në njëzet e gjashtë ajete dhe në disa hadithe profetike. Në Kuran përdoret në dy kuptime, si vendi i dënimeve (xhehenem) dhe "zjarr përcëllues, që nuk di të shuhet".

**3. Havije:** Ky emër rrjedha nga fjala arabe huvije, që do të thotë "të biesh nga lart poshtë", prandaj edhe kuptimi i fjalës havije është "gropë e thellë, humnerë". Kjo fjalë përmendet vetëm në një ajet të Kuranit (Karia, 9-11.) dhe në një hadith profetik (Nesai, Xhenaiz, 9.)

**4. Hutame:** Ky emër i xhehenemit përmendet vetëm në një ajet të Kuranit (Humeze, 4-7.), në kuptimin "zjarr përcëllues, që djeg gjithçka deri në palcë".

**5. Ledha:** Kjo fjalë do të thotë "zjarr i vërtetë" dhe përmendet vetëm në një ajet të Kuranit (Mearixh, 15-16.), në kuptimin "zjarr që shkrin organet e trupit".

**6. Sair:** Kjo fjalë përmendet shtatëmbëdhjetë herë në Kuran, si në kuptimin e gjerë të fjalës xhehenem, ashtu edhe në kuptimin e ngushtë të fjalës "zjarr përcëllues". Kjo fjalë përmendet edhe në hadithet profetike.

**7. Sekar:** Kjo fjalë përmendet në katër ajete në Kuran. Mbështetur në kontekstin e ajeteve dhe në kuptimin e tij nëpër hadithe, Kurtubiu, komentatori i Kuranit, e përshkruan sekarin si zjarrin që përcëllon vetëm mishin deri tek kockat.

Në Kuran gjenden edhe shumë fjalë dhe togfjalësha që nënkuptojnë xhehenemin dhe dënimet në botën tjetër. Kështu, në pesë ajete të Kuranit përmendet fjala "adhabu'l-harik" (p.sh. Buruxh, 10.). Ky pohim, që gjendet në Kuran, argumenton se dënimi në jetën tjetër, në përgjithësi do të bëhet me hedhjen në zjarr. Por në Kuran tregohen edhe format e tjera të dënimeve, siç janë hamimi (uji përvëlur), që përmendet në njëmbëdhjetë ajete, jahmum (tymi i zi me temperaturë të lartë), që përmendet në një ajet (Vakia, 43-44.), semum (era e nxehtë që helmon çdo gjë, aty ku kalon), që përmendet në dy





ajete (p.sh. Tur, 27.). Ndër emrat e tjerë, që përmenden në lidhje me xhehenemin, janë edhe sixhin (burg, gropë e thellë), gaj (fushat dhe lumenjtë e xhehenemit), vejl (mal në xhehenem), darul-bevar (toka e shkatërrimit). Një togfjalësh i përdorur shumë në literaturën islame, i cili e ka burimin tek një ajet kuranor, është edhe "esfelus-saflin" (Tin, 5.), që ka kuptimin "vendi më i ulët". Dhe fjala ferr, që buron nga latinishtja infernus, përkthimi i bërë në tekstin e njohur Vulgate të Biblës, fjalës hebreje sheol, që gjendet në Besëlidhjen e Vjetër, ka kuptimin "shtresa më e ulët".

Gati të gjithë emrat që përmenden në Kuran në lidhje me xhehenemin, shprehin pasojat dhe format e dënimit me zjarr, i cili është edhe koncepti më i përhapur i dënimit në jetën tjetër. Këto fjalë mund të gjenden në togfjalëshin e përbërë me fjalën zjarr (nar), që përmendet në njëqind e njëzet e gjashtë ajete, prej të cilave në njëqind e një ajete, në kuptimin e zjarrit të xhehenemit. Zjarri (nar), si simbol i dënimit në jetën tjetër, është shumë më i përhapur në literaturën e hadithit. Kështu, në punimin Muxhem, në lidhje me fjalët që gjenden në librat bazë të hadithit, hadithet ku përmendet fjala zjarr (nar), zënë plot njëzet faqe të indeksit të haditheve.

Studimet e kryera në fushën e studimeve fetare të krahasuara, kanë treguar se në të gjitha besimet dhe fetë ekziston besimi, sipas së cilit, njerëzit do të jetojnë një jetë të dytë pas vdekjes, në të cilën ata do të shpërblehen për veprat e mira si dhe do të dënohen për veprat e këqija, që kanë bërë në këtë jetë. Ndjenja e drejtësisë tek njeriu dhe botëkuptimi i tij në mbështetje të drejtësisë, bën të domosdoshme ekzistencën e një jete tjetër, ku do të vendoset drejtësia absolute.

Në fenë islame ekziston një literaturë shumë e pasur, në lidhje me jetën në xhenet dhe në xhehenem, mbështetur kryesisht në dy burimet kryesore të besimit islam, Kuranin dhe hadithin. Kelamistët (apologjetët) myslimanë janë gati unanimitë në pikëpamjen se përshkrimi që gjendet në Kuran dhe në hadith, mbështetet në përvojën njerëzore gjatë rrëfimit të jetës tjetër, ndërsa përjetimi aty do të

jetë i dimensioneve krejt të ndryshme nga përjetimet e njeriut në këtë jetë. Kjo mbështetet edhe në ajetin e Kuranit, sipas së cilit "përjetimet e begative të xhenetit nuk i kupton dot asnjë njeri" (Sexhde, 17.) dhe në hadithin kudsî, sipas të cilit "në xhenet janë përgatitur për njerëzit e mirë gjëra që nuk i ka parë asnjë sy, nuk i ka dëgjuar asnjë vesh dhe nuk i ka përfytyruar dot asnjë mendje." (Buhari, Tevhid, 35; Muslim, Xhenet, 3-5.)

Ajetet e Kuranit në lidhje me xhehenemin, flasin më shumë rreth funksionimit, pra rreth formave të dënimit në të, sesa rreth strukturës së xhehenemit. Megjithatë, ka edhe ajete që flasin rreth strukturës së xhehenemit, siç janë ajetet ku thuhet se mynafikët do të jenë në shtresën më të ulët të xhehenemit (Nisa, 145.), se xhehenemi ka shtatë porta (Hixhr, 44.) dhe të tjera si këto.

Në xhehenem kanë për të hyrë të gjithë ata që meritojnë të dënohen në jetën tjetër për krimet dhe gjynahet që kanë bërë në këtë botë. Allahu, mëshira e të Cilit e kalon dënimin e Tij, do të shpërblejë sa fish që të dëshirojë Ai, çdo njeri që ka bërë punë të mira në këtë botë (Bekare, 105.), por nuk do të dënojë më shumë sesa e meriton njeriun që ka bërë punë të këqija në jetën kalimtare. Ata që do të hyjnë në xhehenem, janë ata që nuk besojnë në Zot (ateistët), ata që besojnë se janë Zoti vetë, siç ishte faraoni, ata që i bëjnë shirk Zotit, mynafikët dhe besimtarët gjynahqarë.

Të gjithë ata që mohojnë ekzistencën e Zotit apo i bëjnë shirk Atij, kanë për të qëndruar në xhehenem në përjetësi, ndërsa myslimanët që kanë punuar më shumë punë të këqija se sa kanë bërë vepra të mira në jetën kalimtare, kanë për t'u ndëshkuar në xhehenem, në varësi të gjynaheve që kanë punuar dhe më pas kanë për të hyrë në xhenet.

Njerëzit që do të dënohen me zjarrin e xhehenemit, formojnë grupe të shumta, në qoftë se do të klasifikohen në dritën e ajeteve të Kuranit dhe haditheve profetike. Në vija të trasha, ata janë njerëzit që kanë shkelur ligjet e Zotit dhe të drejtat e njerëzve.

Shkelja e ligjit të Zotit është pa dyshim prerje e marrëdhënies së sinqertë mes Krijesit dhe krijesës, e cila mund të përmblihet me fjalët braktisje e rrugës së besimit dhe shmangie drejt rrugës së mohimit të Zotit. Ky lloj dhunimi, është kritikuar ashpër në shumë ajete kuranore me të gjitha format e tij, që janë kufri, shirku, dyfytërsia (nifaku), përgënjeshtrimi i ajeteve të Kuranit dhe i haditheve të Profetit. Ata që veprojnë njëjërë prej këtyre llojeve, janë konsideruar në Kuran si "armiqtë e Zotit". Sipas Kuranit, Allahu i fal të gjitha gjynahet, me përjashtim të shirkut.

Ndërsa, si shkelësit kryesorë së të drejtave të njerëzve të tjerë, mund të numërohen tiranët, vrasësit, prepotentët, ata që torturojnë besimtarët, ata që hanë të drejtën e jetimëve, ata që nuk dëshirojnë të pranojnë të vërtetën për shkak të interesave të tyre të ngushta, megjithëse e kuptojnë shumë mirë se cila është ajo, ata që betohen rrejshëm, ata që nuk e ruajnë nderin e tyre, ata që përpiqen të vënë në siklet të tjerët, ata që përgojnë, koprracët.





## Sbfrytëzojeni rininë, para se të vijë pleqëria

Kurani Famëlartë rrëfen disa shembuj që duhet të jenë edhe synimi i të rinjve tanë. Në suren Enbija Allahu (xh. sh.), na rrëfen rastin e Ibrahimit (a.s.), i cili nuk pranoi t'i adhuronte idhujt dhe mohoi ta bënte këtë veprim edhe kur ia kërkoi babai i vet. Po kështu, Kurani na kujton edhe një shembull tjetër, atë të të riut të nënshtruar plotësisht para Zotit të vet, Ismailit (a.s.), i cili me përpikmëri zbatonte urdhrat e Tij, edhe atëherë kur ato nënkuptonin sakrificën, pra kur ishte në pyetje edhe koka e tij.

Kurani Famëlartë përshkruan edhe shembullin e të riut Jusuf (a.s.), i cili refuzoi të bënte gjynah, edhe kur nuk kishte gjë që ta pengonte dhe ekzistonin gjasa reale. Ky i ri nuk vrapoi pas femrës, e cila deshë ta mashtronte, por ajo vrapoi pas tij. Allahu (xh.sh.), thotë: "Por ajo, në shtëpinë e së cilës gjendej ai, nisi ta joshë në kundërshtim me dëshirën e tij. Ajo ia mbylli të gjitha dyert dhe tha: "Jam e gatshme për ty!" Kurse ai tha: "Allahu më ruajt! Me të vërtetë, Zoti im ka treguar kujdes për mua dhe, padyshim, keqbërësit nuk do të shpëtojnë kurrë." (Jusuf, 23.) Jusufi (a.s.), nuk iu përgjigj epshit të gruas, edhe pse ai e kishte këtë mundësi. Jusufi (a.s.), u gjet mes dy sprovave: një në fe e tjetër në këtë botë. Sprova e fesë ishte që të bënte amoralitet me atë grua dhe të bëhej gjynahqar, ndërkaq sprova e kësaj bote ishte burg dhe ai zgjodhi provën e kësaj bote. Ky pra është i riu që refuzoi gjynahun, i cili dominoi mbi pasionet dhe epshin, duke u kapur fort për litarin e Zotit. Në suren Kehf, Allahu (xh.sh.), na rrëfen edhe tregimin e banorëve të shpellës. Është një rrëfim i mrekullueshëm, ku tregohet për një grup të rinjsh, të cilët ishin arratisur nga qyteti i tyre për të ruajtur besimin. Këta shembuj që përmenden në Kuran, duhet të jenë për ne kandila ndriçues.

Koha e rinisë konsiderohet një nga kohët më të rëndësishme, e cila është koha e gjallërisë, prodhimitarisë, përparimit dhe progresit. Periudha e rinisë është periudhë e fuqisë, e cila gjendet në mes dy periudhave të dobësisë: dobësisë së fëmijërisë dhe asaj së pleqërisë, siç tregon për

këtë Kurani Famëlartë, ku Allahu (xh.sh.), thotë: "**Allahu është Ai që ju krijoi në një gjendje të dobët, pas asaj dobësie ju dha fuqi e pas fuqisë, dobësi e pleqëri.**" (Rum, 54.) Periudha e rinisë është periudhë e gjallërisë kulminante, mesi i jetës, kurse mesi i çdo gjëje është pjesa më e fortë e saj, si dielli në mesditë.

Rinia është mosha e fuqisë dhe njeriu do të pyetet në Ditën e Gjykimit për jetën e tij në përgjithësi, ndërsa për moshën e rinisë, në veçanti. Në një hadith të transmetuar nga Tirmidhiu, Pejgamberi (a.s.), ka thënë: "*Çdo njeri nesër, ditën e kijametit, do të merret në pyetje për katër gjëra, njëra nga të cilat do të jetë rinia e tij dhe mënyra si e ka kaluar atë.*"

Rinia është udhëheqja e së nesërme dhe shpresa e së ardhmes. Mbi supet e saj ngrihen qytetërimi dhe historia e lavdishme. Tek ajo varen shpresat, ëndrrat dhe zemrat.

Rinia është pasuria e një populli dhe forca e tij. Nëse doni të dini të ardhmen e një populli, mos pyetni për pasurinë që ka ai popull, por shiko të rinjtë e tij. Nëse ata kanë vlera e moral, dije se e ardhmja e atij populli premon të gjitha të mirat. Nëse rinia është e degjeneruar, pa vlera, atëherë atë popull e pret shkatërrimi.

Rinia myslimane duhet të armatohet me besim dhe shpresë, të ketë besim në vetvete dhe të shpresojë në Zotin, të ketë besim në të tashmen dhe të jetë e bindur në të ardhmen. Ajo nuk duhet rritur pesimiste dhe e dëshpëruar. Duhet të jetë e qëndrueshme, të mos e kaplojë lodhja dhe përtacia, e bindur se e nesërme do të jetë më e mirë se e sotmja, se e tashmja e tyre është më e mirë se e kaluara.

Rinia jonë duhet të veprojë e bashkuar. Nuk mjafton të punosh vetëm si individ, sepse ujku e ha delen që ndahet nga kopeja. Pejgamberi (a.s.), ka thënë: "*Besimtari për besimtarin është si pjesët e një ndërtese, të cilat e mbajnë fort njëra-tjetrën.*" Islami legjitimoi xhematin dhe e bëri na-



mazin me xhemat 27 herë më të vlefshëm se namazin në vetmi, me qëllim që të mbjellë te besimtarët myslimanë shpirtin e veprimtarisë së organizuar, ndjenjat shoqërore dhe të menduarit e organizuar. Në një hadith të transmetuar nga Hakimi, Pejgamberi (a.s.), ka thënë: *“Shfrytëzoni pesë gjëra, para pesë të tjerave: rininë para se të vijë pleqëria, shëndetin para se të vijë sëmundja, pasurinë para se të vijë varfëria, kohën e lirë para se të zihesh me punë, jetën para se të vijë vdekja.”*

Ne kemi nevojë për të rinj, si Usame Ibn Zejdi, i cili e udhëhoqi ushtrinë islame në moshën 18- vjeçare, edhe pse në atë ushtri ishin prezentë disa sahabë të mëdhenj. Pejgamberi (a.s.), e caktoi përsëri atë komandant, duke dashur t’u tregonte myslimanëve me këtë veprim se rinia ka aftësi dhe mundësi edhe për punë të mëdha. Të rinjtë duhet të marrin obligime dhe të mos e humbin rininë e tyre në lojë e dëfrime. Ne, për fat të keq, vuajmë nga mungesa e diturisë dhe zbrazëtia e zemrave të devotshme, nga zhveshja prej aspiratave të larta dhe shpërdorimi i kohës pa punuar dhe prodhuar ndonjë gjë.

Rinia duhet ta dijë se grupi i besimtarëve, i cili u vendos në shtëpinë e Erkamit dhe ata që realizuan fitoren e Islamit, ishin rinia. Kur filloi t’i vinte shpallja, Muhamedi (a.s.), ishte në moshën 40 vjeçare, Ebu Bekri ishte 37 vjeç, Omeri ishte 27 vjeç, Othmani ishte më i ri se Pejgamberi e Aliu ishte më i ri se të gjithë. Po ashtu, Abdullah ibn Mesudi, Abdurrahman ibn Afi, Seid bin Zejdi, Musab ibn Umejr, Amar ibn Jasir dhe qindra të tjerë. Të gjithë këta ishin të rinj. Ilishin ata, të cilët e bartën mbi supet e tyre përgjegjësinë e thirrjes në Islam.

Pejgamberi (a.s.), ka thënë: *“Një prej shtatë personave, që do të qëndrojnë nën hijen e Allahut, në atë ditë, kur nuk do ketë hije tjetër përveç hijes së Tij, është edhe “i riu, i cili e kalon një pjesë të kohës së tij duke adhuruar Allahun.”* (Buhari, Muslim) E lusim Allahun e Madhëruar që ta ruajë rininë tonë, t’i udhëzojë ata në rrugën e drejtë, sepse ata janë e ardhmja e vendit tonë.

*“Shfrytëzoni pesë gjëra,  
para pesë të tjerave:  
rininë para se të vijë pleqëria,  
shëndetin para se të vijë sëmundja,  
pasurinë para se të vijë varfëria,  
kohën e lirë para se të zihesh me punë,  
jetën para se të vijë vdekja.”*





## 10 zakonet që dëmtojnë trurin

Kjo është lista me 10 zakonet më të shpeshta por tepër të rrezikshme për shëndetin mendor:

### 1. Mosngrënia e mëngjesit

Njerëzit të cilët nuk hanë mëngjes, kanë nivele të ulëta sheqeri në gjak. Kjo çon në furnizimin e pamjaftueshëm të trurit me ushqyes.

### 2. Tejnngopja

Tejnngopja shkakton forcimin e arterieve të trurit, duke ulur në këtë mënyrë fuqinë mendore.

### 3. Pirja e duhanit

Shkakton tkurrje të shumëfishtë të trurit dhe gjithashtu mund të jetë shkak për sëmundjen Alzheimer.

### 4. Konsumi i lartë i sheqerit

Shumë sheqer ndërpret thithjen e proteinave dhe ushqyesve të tjerë dhe mund të ndërhyjë në zhvillimin jonormal të trurit.

### 5. Ndotja e ajrit

Truri është konsumatori më i madh i oksigjenit në trupin tonë. Thithja e ajrit të ndotur zvogëlon furnizimin e trurit me oksigjen, duke sjellë rënie të efikasitetit.

### 6. Pagjumësia

Gjumi lejon trurin tonë të pushojë. Privimi afatgjatë i gjumit

përshejton vdekjen e qelizave të trurit.

### 7. Mbulimi i kokës gjatë gjumit

Fjetja me kokën mbuluar rrit përqendrimin e dioksidit të karbonit dhe ul përqendrimin e oksigjenit, çka mund të shkaktojë dëmtime të trurit.

### 8. Sforcimi i trurit gjatë sëmundjeve


Puna e rëndë dhe studimi gjatë sëmundjeve të ndryshme mund të shkaktojë rënie të efektshmërisë së trurit dhe ta dëmtojë atë.

### 9. Mungesa e mendimeve stimuluese

Të menduarit është mënyra më e mirë për të stërvitur trurin tonë. Mungesa e mendimeve shkakton tkurrjen e trurit.

### 10. Mungesa e dialogut

Bisedat intelektuale promovojnë efikasitetin e trurit.



## Mungesa e vitaminës D te fëmijët, "Shokuese"



Rreth 70% e fëmijëve në botë kanë nivele të ulëta të Vitaminës D, e cila i vë ata në rrezik të lartë për sëmundjet e kockave dhe të zemrës.

*"Ne kemi pritur që studimi të tregojë se mangësia e Vitaminës D nuk do të jetë shqetësuese, por përmasat e problemit janë shokuese,"* tha Dr. Juhi Kumar i "Children's Hospital" në "Montefiore Medical Center".

Rastet e sëmundjeve të kockave te foshnjat, për shkak të mungesës së Vitaminës D, kanë qenë gjithashtu në rritje, tregon studimi. Kjo gjetje nga një studim mbarëkombëtar, tregon se, si fëmijët, ashtu edhe të rriturit kanë mungesë të theksuar vitamine.

*"Disa studime të vogla kishin gjetur se ka nivele të ulëta Vitamine D, në popullsi dhe sidomos te fëmijët, por asnjë nuk e kishte ekzaminuar këtë çështje në mbarë botën,"* tha Dr. Michal L. Melamed nga "Albert Einstein College" për Mjekësi në Universitetin Yeshiva.

### Shkaku?

Dietë e keqe dhe mungesa e rrezeve të diellit, përfundojnë mjekët në revistën online të Peditrisë.

Sipas studimit, me miliona fëmijë kanë rezultuar me nivele të ulëta të Vitaminës D, por më tepër kanë qenë kryesisht te vajzat Afrikano-Amerikane dhe Meksikane, te fëmijët e shëndoshë dhe ata të cilët pinë qumësht më pak se një herë në javë. Gjithashtu

edhe fëmijët, të cilët shpenzojnë më shumë se katër orë në ditë duke parë televizor apo duke luajtur video-lojëra. Ngjyra e hapur e lëkurës është më e efektshme në prodhimin e Vitaminës D, ndërkohë që njerëzit me ngjyrë të errët të lëkurës, prodhojnë më pak Vitaminë D gjatë ekspozimit në diell.

*"Sot fëmijët shpenzojnë më shumë kohë ulur dhe në shtëpi, sesa duke luajtur jashtë,"* tha një studiues tjetër. *"Përdorimi i gjerë i tendave dhe perdeve, të cilat bllokojnë rrezet UV-B, vetëm sa e ka përkeqësuar më shumë problemin."*

Trupi përdor rrezet e diellit UV-B, për të shndërruar një formë të kolesterolit që ndodhet në lëkurë në Vitaminë D.

### Çfarë duhet bërë?

Shkencëtarët rekomandojnë se fëmijët duhet të konsumojnë më shumë ushqime të pasura me Vitaminë D, si qumështi dhe peshku. *"Por është shumë e vështirë për të marrë Vitaminë D vetëm prej ushqimeve,"* thanë ata.

Vitamina shtesë me anë të pilulave, mund të ndihmojnë shumë. Sipas studimit, fëmijët që kanë marrë Vitaminë D shtesë (400 IU /Ditë), kishin më pak të ngjarë të kishin mangësi të kësaj vitamine. Megjithatë, përqindja e fëmijëve që përdorin vitamina shtesë është shumë e ulët.

### Çfarë tjetër mund të bëjnë prindërit?

*"Do të ishte mirë për ta që të fiknin televizorin dhe t'i dërgonin fëmijët për të luajtur jashtë,"* tha një peditër. Rreth 20-30 minuta në ditë janë të mjaftueshme dhe, nëse ata digjen shpejt, mos u vendosni krem kundër djegies, të paktën gjatë 10 minutave të para të ekspozimit në diell, në mënyrë që ata të marrin rreze, por edhe të mos digjen njëkohësisht.



## Prodhoet domatja e zezë

Hortikultura në Izrael ka krijuar një domate gotike me emrin *Galaktika e zezë*. Domatja e çuditshme ka formën e perimes së njohur, është e zezë nga jashtë dhe e kuqe nga brenda. Për të krijuar këtë lloj domateje, shkencëtarët kryqëzuan një sërë variantesh të kësaj perimeje, duke arritur ngjyrën e ngjashme me manaferrat.


Pigmenti është shumë i ndjeshëm ndaj rrezeve të diellit, madje, sa më shumë që domatja të ekspozohet në diell, aq më shumë sterrohet ngjyra.

Kompania që prodhoi këtë varietet të ri quhet Technological Seeds, e specializuar në prodhimin e perimeve hibride. "Përveç ngjyrës, këto domate kanë dhe avantazhe në anti-oksidantët", thotë njëri prej fermerëve që prodhon këtë lloj të ri të domates.

Në fakt, prodhuesit theksojnë se domatja është shu-

më e shijshme, sepse përmban kaloritë e duhura, e përqendruar tek antioksidantët dhe ka vitaminë C, që njihet për mbrojtjen e sistemit imun.

Mendohet se domatja do të fitojë terren të madh në shitje, menjëherë sapo të futet në tregjet lokale brenda vitit. Kjo kompani do të prodhojë gjithashtu limona pa fara, një lloj të ri të luleshtrydhes, limona të kuq, si dhe karrota me ngjyrat e ylberit. Le të imagjinojmë në tregjet tona edhe karrota me ngjyrat rozë, lejla apo të verdha.



Teknologjia mund të sjellë mundësinë e përzgjedhjes së ilaçeve për një sëmundje të caktuar, direkt nga shtëpia e pacientit.

Studiuesit në Universitetin e Glasgow, kanë përdorur një lloj printeri 3D, për të krijuar molekulat e ilaçeve. Një teknologji e tillë, në të ardhmen mund të bëjë të mundur diagnostikimin dhe prodhimin e një kure të caktuar për sëmundjen, nga shtë-

## Metoda për të "printuar" ilaçet

pia e pacientit. "Ne mund të përdorim printerët 3D për të revolucionarizuar qasjen në kujdesin mjekësor në një botë që po zhvillohet me shpejtësi, duke lejuar që diagnostikimi dhe mjekimi të jenë më efikase dhe më ekonomike se sa është momentalisht e mundur", tha Profesor Lee Cronin, i cili kryesoi ekipin studimor.

Studiuesit në Universitetin e Glasgow kanë zhvilluar një proces të ri, që sipas tyre, mund të printojë ilaçet. Ata po përdorin teknologjinë e printerëve 3D, e cila në teori mund t'u japë njerëzve mundësinë për të pasur "farmacinë personale" në shtëpitë e tyre.

## Lëshohet GOOGLE DRIVE

Google po shpreson të ndërtojë kabinetin më të madh digital të të dhënave.

Ndërmarrja Google paraqiti shërbimin e ri Google Drive, një produkt ky, i cili i ruan dokumentet, fotografitë, videot dhe një mori të llojeve të tjera në kompjuterët e Google.

Duke i mbajtur skedarët në qendra të mëdha të të dhënave, përdoruesit do të jenë në gjendje t'i përdorin të dhënat në smartphone, tablet, lap-top dhe në çdo pajisje tjetër që lidhet me internet. Përmbajtja mund të shpërndahet lehtësisht tek të tjerët, duke iu dërguar lidhje (link), në vend të ngarkesave të mëdha me e-mail.

Google Drive është duke ofruar pesë gigabajtë e parë

pa pagesë. Çmimet për ngarkesa shtesë shkojnë nga 2.49 dollarë për muaj për 25 gigabajtë, deri në 49.99 dollarë për muaj për një terabajt, që është i barabartë me pesë lap-topë me disqe prej 200 gigabajtë.

Shërbimi fillimisht është i mundshëm të instalohet në kompjuterët Windows, Mac, lap-topët, që e kanë sistemin operativ Chrome të Google dhe smartphone-ët, që e kanë sistemin operativ Android.



## Brunei Darus-Salam njohu pavarësinë e Kosovës

Ministri i Punëve të Jashtme dhe i Tregtisë i Brunei Darussalam, Mohamed Bolkiah, përmes një letre dërguar Ministrisë të Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës, Enver Hoxhaj, ka konfirmuar njohjen zyrtare të Republikës së Kosovës nga ky shtet.

Sot, ministri Hoxhaj ka zhvilluar një bisedë telefonike

me Ambasadorin e këtij shteti në Organizatën e Kombeve të Bashkuara në New York, Latif Tuha, i cili ka përcjellë përhëndetje të përzemërta të ministrit të jashtëm dhe i ka konfirmuar ministrit Hoxhaj njohjen zyrtare nga Brunei Darussalam. Me këtë rast, Ministri Hoxhaj është ftuar në një vizitë zyrtare në këtë shtet.

## Risitë e abetares kombëtare

Simbolet kombëtare bashkojnë fëmijët e Shqipërisë dhe Kosovës.

Elementi kombëtar bashkon fëmijët e Shqipërisë dhe Kosovës, përmes abetares së përbashkët. Flamujt e të dy vendeve, simboli i 100 vjetorit të pavarësisë së shtetit shqiptar, figura, si Skënderbeu e Nënë Tereza, apo emrat e përzgjedhur, janë disa nga detajet që një nga autorët e tekstit, që do t'u mësojë të shkruajnë dhe të lexojnë fëmijëve të dy vendeve, Mimoza Gjokutaj, zbulon për ABC-në. Gjuhëtarja Gjokutaj thekson se, me gjithë konceptin e globalizmit, jeta dhe shpirti i kombit janë përfshirë në këtë libër.

Një kujdes të veçantë katër autorët nga Shqipëria dhe

Kosova kanë treguar edhe për gjuhën. Ata, megjithëse u thonë nxënësve që gjuha e shkruar është shqipja standarde, u mësojnë gjithashtu edhe dialektin.

Teksti është ndërtuar mbi tre personazhe kryesore: Ani, Ola dhe qenushi Umi. Janë ato që do t'u mësojnë çdo germë nxënësve, nëpërmjet ilustrimeve në një mjedis të hapur dhe jo atë të ngurtin, vetëm brenda në klasë apo në shtëpi.

Abetarja e përbashkët Kosovë-Shqipëri, megjithëse është ripunuar në 70% të saj, nga ana metodike ka të njëjtin trung me variantin që nisi në vitin 2000 dhe që ka kaluar një sërë testesh.

## Ankaraja zyrtare reagoi ashpër ndaj deklaratës së Obamës

Ministria e Jashtme turke bëri të ditur që mesazhi i Presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Barak Obama, i publikuar në lidhje me ngjarjet e vitit 1915, paraqet një qasje të pabazuar që pasqyron pikëpamjet armene.

Në deklaratë u tha kështu: "Me mesazhin e publikuar më 24 prill 2012, Presidenti Barak Obama edhe këtë vit ka vënë në pah një qasje të pabazuar, me anë të së cilës pasqyrohen pikëpamjet armene për mosmarrëveshjet mes turqve dhe armenëve, në lidhje me historinë e dhimbshme të përbashkët. Këtë deklaratë, që shtrembëron të vërtetën historike, e shohim si shumë problematike nga çdo aspekt dhe e dënojmë me keqardhje".

Në deklaratë thuhet gjithashtu se dhimbjet e jetuara gjatë Luftës së Parë Botërore janë të përbashkëta dhe kujtimet në lidhje me atë kohë nga pikëpamja e popullit turk, janë të ndjeshme, po aq sa ato armene dhe se krahas të gjitha ndërhyrjeve me paragjykim, do të vazhdojnë përpjekjet për qasje të barabartë në kujtesë.

"Ajo që i takon një aleati tonë të rëndësishëm, siç janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nuk është thellimi i mëtejshëm i këtij problemi me qasje të tilla që dëmtojnë ma-

rëdhëniet mes dy vendeve, por shfaqja e një qëndrimi konstruktiv në drejtim të zgjidhjes së këtij problemi dhe në këtë kontekst, të inkurajohet Armenia, e cila i shmanget studimit të historisë së përbashkët, që të jetë më realiste dhe pajtuese", thuhet në vijim të deklaratës.

Ndërkaq, Turqia reagoi edhe ndaj Sarkozy dhe Holland, të cilët garojnë në zgjedhjet presidenciale në Francë.

Në këtë deklaratë thuhet: "Deklaratat e Presidentit të Francës, Nikola Sarkozy dhe kandidatit për president në zgjedhjet presidenciale, liderit të Partisë Socialiste, Fransua Holland, në lidhje me pretendimet armene për ngjarjet e vitit 1915, janë një shembull i ri i keqpërdorimit të çështjeve të diskutueshme historike për llogaritë e tyre politike".

